

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 84-të i botimit
Maj 2016/ Nr. 5



**Gjenerallejtënant
Rrahman Rama në Tiranë**
Gjeneralmajor Jeronim Bazo:
Mbështetja e FA-së për
FSK-në e sigurtë dhe konkrete

Vizita në Kroaci
**Kodheli-Buljeviç: Bashkëpunim
në emër të stabilitetit dhe sigurisë**

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 84-të i botimit
Nr. 5/2016

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfuturi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes, Muzeut
dhe Shtëpive të Pushimit.

Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:
[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)



Përmbajtja

Numri 5

"RESOLUTE SUPPORT"

10 Trupat shqiptare dhe ato turke përkrah njëri-tjetrit

BAZO- ÇOLAK

11 Turqia, vendi i parë që ofroi mbështetje për FA

FORCA DETARE

37 Zhvillohet stërvitja e përbashkët "Vlora SAREX 16"

KOSOVE

38 "West Point" hap dyert për dy kosovarë

KUJTESË HISTORIKE

42 Evropa në retrospektive

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA
Albert ZHOLI
Saimir ALIJA

Redaktore korrektore:
Anila DODA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ



4 KËSHILLI I ATLANTIKUT

NATO-Forcë e madhe për të mirën e të gjithëve

Pak javë më parë shënuam 25-vjetorin e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Shteteve...



6 VIZITA

Ministrja Mimi Kodheli pret gjenerallejtnant Rrahman Rama

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës-FSK, gjenerallejtnant Rrahman Rama, me ftesë të Shefit të Shtabit...



16 7 VJET NË NATO

Shqipëria dhe NATO kanë nevojë për njëra-tjetrën

Ditën e hënë, në 4 prill 2016, u përkujtua në një ceremoni festive në sheshin "Nënë Tereza" në Tiranë...



18 65-VJETORI I AVIACIONIT USHTARAK SHQIPTAR

Memorial për Dëshmorët e Forcës Ajrore

Në kuadër të 65-vjetorit të krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar në Komandën e Forcës Ajrore, Rinas, u inaugurua më 22 prill 2016, Memoriali i Dëshmorëve të Forcës...

Kryeministri Edi Rama në Këshillin e Atlantikut

NATO-Forcë e madhe për të mirën e të gjithëve

Gjatë qëndrimit në SHBA, kryeministri Rama më 13 Prill 2016, mbajti një fjalë në Këshillin Atlantik lidhur me disa nga sfidat më komplekse dhe më urgjente të kohës sonë

Shqipëria mbetet një mbështetëse e fortë e zgjerimit të NATO-s në Ballkanin Perëndimor, ku NATO duhet të institucionalizojë marrëdhëniet e saj me Kosovën, në një të ardhme të afërt. Shqipëria do të vazhdojë të mbështesë politikën e dyerve të hapura të NATO-s.

Pak javë më parë shënuam 25-vjetorin e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara. 25 vjet marrëdhëniesh të spikatura, gjatë së cilëve asistenca e Shteteve të Bashkuara ka qenë shumë e rëndësishme jo vetëm për Shqipërinë, por mund të them edhe për të gjithë rajonin. Nëse vendet e Europës Adriatike janë sot në paqe dhe punojnë bashkë për të përballuar sfidat e mëdha të kohës, me krizën e refugjatëve gjithashtu, duke mbështetur njëri-tjetrin në rrugën drejt integritetit europian, duke transformuar peizazhin ekonomik dhe politik, kjo i detyrohet jo në masë të vogël, për të thënë më të paktën, angazhimit të Shteteve

të Bashkuara dhe është një histori e madhe sukcesi e politikës së jashtme të Shteteve të Bashkuara”, deklaroi kryeministri Edi Rama, në Këshillin e Atlantikut, ku ishin të pranishëm ambasadorë të SHBA-së në Shqipëri dhe që kanë luajtur rol të jashtëzakonshëm në forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve dhe në vendosjen e demokracisë në Shqipëri si: Marisa Lino, Aleksandër Arvizu e Donald Lu.

Kryeministri Edi Rama ka vlerësuar Deklaratën e Partneritetit Strategjik me Shtetet e Bashkuara, firmosur vitin që kaloi duke thënë se: “Vitin e kaluar firmosëm një Deklaratë Partneriteti Strategjik me Shtetet e Bashkuara, me fokus në sigurinë rajonale, energjinë, sundimin e ligjit dhe mirëqeverisjen,



veçanërisht tek ekonomia. Dhe arsyeja e vizitës sime në DC këtë javë nuk është vetëm për të vijuar me angazhimet e përbashkëta që morëm vitin e kaluar, por edhe për të diskutuar progresin që Shqipëria ka bërë gjatë muajve të fundit, në lidhje me rrugën tonë drejt Bashkimit Europian dhe për të shkëmbyer pikëpamjet rreth interesit që Shtetet e Bashkuara dhe Shqipëria ndajnë si vende aleate të NATO-s në një mjedis sfidues përsa i përket sigurisë europiane”.

Lidhur me angazhimin e Qeverisë Shqiptare për zbatimin e rekomandimeve të Samitit të Uells-it, kryeministri Edi Rama deklaroi se “Në Samitin e NATO-s në Uells, Shqipëria ka ndërmarrë hapa për të ndaluar rënien në shpenzimet e mbrojtjes dhe për të kthyer trendin. Buxheti ynë i mbrojtjes për vitin 2015 tregon një rritje prej 12%, krahasuar me vitin e kaluar. Buxheti i mbrojtjes i caktuar për investimet është ngritur nga 11% në 20%, për të siguruar aftësinë tonë për të realizuar plane afatgjata dhe kontrata shumëvjeçare. Por, ne jemi po ashtu të vetëdijshëm se disa gjëra nuk mund të merren si të mirëqena”.

“Progresi i një vendi të Ballkanit Perëndimor është shumë fort i lidhur me stabilitetin dhe sigurinë në rajon. Ndaj, Shqipëria mbetet një mbështetëse e fortë e zgjerimit të NATO-s në Ballkanin Perëndimor, ku NATO duhet të institucionalizojë marrëdhëniet e saj me Kosovën, në një të ardhme të afërt. Shqipëria do të vazhdojë të mbështesë politikën e dyerve të hapura të NATO-s dhe ashtu sikurse e ka thënë dhe Sekretari Kerry, të udhëheqë vendet e Ballkanit që aspirojnë të anëtarësohen në NATO. Në kontekstin aktual gjeostrategjik dhe ndërsa përgatitemi për Samitin e ardhshëm në Varshavë, Shqipëria është e angazhuar të jetë pjesë e përpjekjeve të Aleancës për një shpërndarje të drejtë të barrës dhe detyrimeve të përbashkëta afatgjata. Ky proces është thelbësor për besueshmërinë e Aleancës dhe qëndrueshmërisë së instrumenteve tona të mbrojtjes së përbashkët”, deklaroi kryeministri Edi Rama.



KRYEMINISTRI RAMA:

“NATO është e përbërë nga kombe që kanë zbuluar rrugën drejt komunitetit, pavarësisht dallimeve. Vetë historia i ka besuar komunitetin Transatlantik detyra të përbashkëta. 25 vjet më parë, këto detyra personifikuan nevojën për të bashkuar mburojat kundër tiranive dhe për të siguruar mirëqenien e popujve tanë në këtë anë të Atlantikut dhe matanë tij.”

“Faktikisht, NATO është e përbërë nga kombe që kanë zbuluar rrugën drejt komunitetit, pavarësisht dallimeve. Vetë historia i ka besuar komunitetin Transatlantik detyra të përbashkëta. 25 vjet më parë, këto detyra personifikuan nevojën për të bashkuar mburojat kundër tiranive dhe për të siguruar mirëqenien e popujve tanë në këtë anë të Atlantikut dhe matanë tij. Sot e kësaj dite, komuniteti Transatlantik bashkëndan akoma të njëjtat nevoja, edhe pse fytyra e tiranisë mund të ketë ndryshuar dhe mirëqenia ka marrë një kuptim më të gjerë sesa ai ekonomik. Anëtarësimi në NATO e ka kthyer Shqipërinë në një shtyllë stabiliteti në Europën Adriatike, një vend që investon për siguri dhe begati në rajon, duke marrë, ashtu sikurse e tha dhe Sekretari Kerry, rolin e udhëheqësit për vendet e Ballkanit që aspirojnë të integrohen në Aleancën Euro-Atlantike”, tha ndër të tjera ai.

Në përgjigje të interesit të pran-

ishmëve, lidhur me rolin e Shqipërinë si një forcë në stabilitetin rajonal, por edhe përparësitë për samitin e NATO-s në Varshavë, kryeministri Rama tha se: “Ne jemi anëtarë krenarë të NATO-s. Jemi gjithmonë të gatshëm për t’ju bashkuar çdo vendimi dhe nisme me forcat tona modeste, por në të njëjtën kohë, ne gjithmonë e kemi bërë dhe do të vazhdojmë ta bëjmë me të gjithë zemrën dhe mendjen tonë, pasi besojmë që NATO është një forcë e madhe për të mirën e të gjithëve. Ne jemi shumë të kënaqur për ftesën që iu bë Malit të Zi. Është diçka e rëndësishme, pasi do të bëjë rajonin më të fortë dhe më të sigurt, pasi nuk duhet të harrojmë se për herë të parë, gjatë viteve të fundit, në rajon ne duhet të përballemi edhe me aktorë të tretë që nuk ishin në rajon pesë vjet më parë. Aktorë si ISIS dhe islami radikal nga njëra anë dhe Rusia nga ana tjetër. Janë aktorë të tretë shumë të interesuar, të cilët e shohin rajonin si shumë strategjik”.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama në Tiranë

Ministrja Mimi Kodheli pret gjenerallejtënant Rrahman Rama

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës-FSK, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të Shefit të Shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, general major Jeronim Bazo, u prit më 29 prill 2016, me nderime të larta ushtarake shtetërore në Ministrinë e Mbrojtjes, në Tiranë. Fillimisht, gjeneral Rama i shoqëruar edhe nga gjeneralët Bashkim Jashari dhe Zymer Halimi, Atasheu ushtarak i Kosovës në Tiranë, nënkolonel Enver Dugolli, u pritën në Ministri nga Ministrja e Mbrojtjes, zonja Mimi Kodheli. Në takim u bisedua për bashkëpunimin ndersjellë ndërmjet ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë. Nga të dyja palët u shpreh gatishmeria e plotë për bashkëpunim në fushën e sigurisë në të ardhmen. Ky takim



ishte pjesë e takimeve zyrtare në nivele të larta midis dy vendeve. Më 1 dhjetor 2015, Ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli zhvilloi një vizitë në Kosovë ku u prit nga Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zoti Haki

Demolli, Kurse më parë dhe konkretisht më 27 janar 2015, Ministri Demolli u prit në Tiranë nga Ministrja e Mbrojtjes, zonja Mimi Kodheli ku u firmos "Plani për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes".

Gjenerallejtënant Rama te Komandot e Forcave Speciale



Komandanti i Forcës së Sigurisë, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe delegacioni i Ministrisë për Forcën e Sigurisë i shoqëruar edhe nga komandanti i Forcave Tokësore shqiptare, gjeneral brigade Nazmi Cahani vazhdoi vizitën në garnizonin e njësisë Komando dhe atë të Batalionit të Forcave Speciale të Ushtrisë shqiptare, në Zall-herr. Fillimisht, në Zall-herr, delegacioni i MFSK-së i kryesuar nga gjeneral Rrahman Rama zhvilluan një takim të përbashkët me gjeneralin Cahani, ku u njoftuan me misionin, detyrat dhe aktivitetet e Njësië speciale si dhe më pastaj patën mundësi të ndjekin një demonstrim profesional me armë në poligonin për gjuajtje në garnizonin e Zall-herr-it.

Mbështetja e FA-së për FSK-në e singertë dhe konkrete

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës-FSK, gjenerallejtënant Rrahman Rama, u takua me Ministren e Mbrojtjes Mimi Kodheli, Shefin e Shtabit të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe zhvilloi vizitë në njësinë Komando dhe Batalionin e Forcave Speciale.

Pas takimit me Ministren Mimi Kodheli, Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama me bashkëpunëtorë, zhvilloi takim kokë më kokë me Shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura shqiptare, gjeneral major Jeronim Bazo.

Gjatë takimit u diskutua rreth bashkëpunimit ushtarak midis FAR-SH dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe çështjeve të sigurisë.

Gjeneral Rama me këtë rast, e njoftoj gjeneralin Bazo mbi procesin që po kalon ministria për FSK dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, procesin e bashkëpunimit regjional si dhe procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura. Nga ana e tij general Rama tha se pikërisht në këtë proces është shumë e nevojshme përvoja e Ushtisë shqiptare e cila pothuajse ka kaluar sfida të ngjashme, në rrugën e zhvillimit të saj.

Gjeneral Bazo vlerësoi me nota pozitive bashkëpunimin ushtarak mes dy forcave në fushën e trajnimit dhe arsimit si një nga fushat më të rëndësishme për zhvillimin profesional të FSK-së. "Dua tju përgëzoj për maturinë e treguar në reformat e ndërmarra, duke dëshmuar se jeni faktor paqeje, sigurie dhe stabiliteti në rajon dhe jo vetëm.

Bashkëpunimi ushtarak ndërmjet forcave tona, është i fokusuar jo vetëm në trajnim dhe arsimit por gjithashtu në zhvillimin e konceptit për strukturën e ardhshme të FSK, në hartimin e dokumentave të niveleve strategjik, doktrinar, taktik



dhe stërvitor si dhe në fushën e logistikës dhe emergjencave civile", u shpreh ndër të tjera gjeneral Bazo. Më tej gjatë takimit Gjeneral Bazo, duke vlerësuar përpjekjet e FSK për të kaluar cdo pengesave politike e ligjore për kalimin në Forcë të Armatosur si dhe e ka falënderuar për përgjigjur pozitivisht ftesës së Forcave tona të Armatosura për t'u bërë pjesë aktive e stërvitjes "Joint Effort -16", që është edhe aktiviteti më i rëndësishëm në këtë nivel për vitin 2016. Nga ana e tij gjenerallejtënant Rama, duke e falënderuar për pritjen e ngrohtë dhe vëllazërore e njohu gjeneralmajor Bazon me zhvillimet më të fundit në FSK dhe me disa nga drejtimet e punës për të ardhmen e afërt. "Bashkëpunimi ushtarak midis vendeve tona ka qenë gjithëpërfshirës, sidoqoftë sfidat e sigurisë globale, që vendet tona dhe Aleanca janë duke u përballur, do të kërkojnë më shumë nga ne. Gjithashtu, bashkëpunimi ynë i ndërsjellët do të jetë pikë kyçe për paqe e stabilitet

në rajon dhe më tej".

Të dy shefat, gjeneral Rama dhe gjeneral Bazo ishin të mendimit se bashkëpunimi rajonal është në interes të të gjitha vendeve të rajonit dhe se ndërtimi i një klime të mirë të bashkëpunimit, lehtëson edhe integrimin e tyre më të shpejtë, si dhe anëtarësimin me të shpejtë në këtë rast të Kosovës, në iniciativa rajonale dhe më gjerë.

Të dy bashkëbiseduesit gjatë takimit u ndalën dhe në shtimin e emigrantëve në Europe duke vënë theksin në rrezikshmërinë që mund të paraqesin për Shqipërinë dhe Kosovën personat e kthyer nga Siria apo Iraku, të cilët kanë luftuar për shtetin islamik dhe që konsiderohen si elementë potencialë terroristë, dhe vunë theksin në angazhimin e strukturave të sigurisë të të dy vendeve me të gjithë forcën e tyre institucionale për të qenë në lartësinë e duhur në ndërveprimin e përbashkët me strukturat e sigurisë dhe të inteligjencës së vendeve partnere.

VIZITA NË KROACI

Kodheli-Buljeviç: Bashkëpunim në emër të stabilitetit dhe sigurisë

*Dy ministrat
ranë dakord për
hapjen e zyrave
të përfaqësuesve
ushtarakë
në Tiranë e
Zagreb.*

Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli zhvilloi më 13-14 prill 2016 një vizitë dyditore në Kroaci, me ftesë të homologut të saj z. Josip Buljeviç. Në takimet që ministrja Kodheli zhvilloi me kryetarin e Parlamentit z. Željko Reiner, zëvendëskryeministrin e parë z. Tomislav Karamarko, ministrin e Jashtëm dhe Çështjeve Evropiane z. Miro Kovač dhe ministrin e Mbrojtjes të Kroacisë z. Josip Buljeviç, u konfirmuan marrëdhëniet e shkëlqyera dhe bashkëpunimi i mirë dypalësh mes Shqipërisë dhe Kroacisë.

Në takimin me homologun e saj kroat, ministrja Kodheli shprehu përkushtimin e Shqipërisë për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe si dhe në kuadër të iniciativave rajonale. Ajo gjithashtu shprehu gatishmërinë e Shqipërisë në përpjekjet e përbashkëta në zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në emër të

stabilitetit dhe sigurisë. Ministrja Kodheli theksoi rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit në kuadër të iniciativave rajonale si Southeast Europe Defense Ministerial (SEDM) dhe Kartën e Adriatikut e njohur si A-5, dhe shprehu besimin që vendi ynë ka të Kroacia, si kryesuese e A-5 për vitin 2016. Ministrja Kodheli theksoi gjithashtu rëndësinë e anëtarësimit me të drejta të plota në Kartën e Adriatikut, të të gjithë vendeve të rajonit, ndërkohë që bashkërisht shprehën gatishmërinë për të punuar së bashku në operacionet dhe misionet e NATO.

Çështja e fenomenit të luftëtarëve të huaj, të cilët ministrja Kodheli i cilësoi si "një sfidë dhe kërcënim të vërtetë për shoqërinë tonë", ishte një tjetër temë e bisedës mes ministrave Kodheli dhe Buljeviç. "Shumë prej tyre vijnë nga rajoni ynë dhe akoma më shumë kalojnë përmes rajonit tonë." - tha ajo, duke e njohur homologun kroat me propozimin e Shqipërisë për të





ngritur në vendin tonë një Qendër Ekselence të NATO për trajtimin e këtij fenomeni. "Shumë shpejt do të nisim shkëmbimin e pikëpamjeve në Komitetin Ushtarak të NATO në Bruksel, për ta ngritur këtë qendër në Shqipëri. Mbështetja e Kroacisë në këtë nismë të vendit tim, është shumë e rëndësishme dhe do të ishte e mirëpritur nga ana jonë." - tha znj. Kodheli.

Gjithashtu, dy ministrat ranë dakord edhe për hapjen e zyrave të përfaqësuesve ushtarakë në Tiranë e Zagreb. Ministria Kodheli përsëriti vendosmërinë e Shqipërisë si një aleate e fortë e "politikës së dyerve të hapura" të NATO, deri në integrimin sa më të shpejtë të Ballkanit Perëndimor në Aleancë.

Më pas ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli u prit në një takim nga ministri i Jashtëm dhe Çështjeve Evropiane z. Miro Kovač, me të cilin konfirmuan marrëdhëniet e shkëlqyera me dy vendeve. Znj. Kodheli e falënderoi z. Kovač për mbështetjen e çmuar dhe të vazhdueshme të Kroacisë për axhendën eurointegruese të Shqipërisë. "Ky vit do të jetë vendimtar në përparimin tonë drejt hapjes së negociatave për anëtarësim dhe ne kërkojmë mbështetjen e përpjekjeve dhe hapave tanë drejt hapjes së negociatave për anëtarësim në BE." - tha ajo. Ministria Kodheli e siguroi ministrin e Jashtëm kroat se reforma në drejtësi do të hapë një kapitull të ri si në konsolidimin e shtetit të

Kodheli te Forcat Speciale të FA të Kroacisë

Gjatë vizitës zyrtare dy ditore në Kroaci, ministrja Mimi Kodheli ka bërë një vizitë edhe në Forcat Speciale, pjesë e Forcave të Armatosura të Kroacisë. "Në vizitën te Forcat Speciale të FA të Kroacisë, me kënaqësi konstatova se jemi në rrugën e duhur drejt profesionalizmit dhe modernizimit. E angazhuar maksimalisht për përmbushjen e këtij prioriteti të FA", shkruan Kodheli në Facebook.



së drejtës në Shqipëri, ashtu edhe në procesin e integritetit të vendit tonë në BE. "Miratimi i legjislacionit kyç për reformën në drejtësi duhet të çojë në hapjen e negociatave për anëtarësim në BE." - tha ajo.

Nismën e Shqipërisë për ngritjen e një qendre ekselence për trajtimin e luftëtarëve të huaj dhe mbështetjen që nevojitet për këtë, ministrja e Mbrojtjes e preku edhe në takimin që pati me ministrin e Jashtëm kroat. Kryefjala e takimeve

të ministres Kodheli me kryetarin e Parlamentit të Kroacisë z. Željko Reiner dhe zëvendëskryeministrin z. Tomislav Karamarko ishin marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe mes vendeve tona dhe mbështetja e Kroacisë në axhendën eurointegruese të Shqipërisë. Në takimet që ministrja Kodheli pati me zyrtarët e lartë kroatë, u theksua nevoja për projekte të përbashkëta rajonale, si mënyra më e mirë për të rritur bashkëpunimin dhe zhvillimin më të mirë të vendeve tona.



MISIONI "RESOLUTE SUPPORT" NË AFGANISTAN

Trupat shqiptare dhe ato turke përkrah njëri-tjetrit

Ministrja e
Mbrotjtjes znj.
Mimi Kodheli
priti komandan-
tin e Forcës
Tokësore të
Turqisë, gjeneral
Salih Zeki Çolak.

Ministrja e Mbrotjtjes znj. Mimi Kodheli ka pritur më 5 prill 2016, në një takim komandantin e Forcës Tokësore të Turqisë, gjeneral Salih Zeki Çolak, i cili shoqërohej nga ambasadori i Turqisë në vendin tonë z. Hidayet Bayraktar dhe atasheu ushtarak, kolonel Bayram Tasci. Dy personalitetet vlerësuan nivelin e lartë të bashkëpunimit mes Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe atyre turke sidomos në fushën e stërvitjes. Ministrja Kodheli falenderoi gjeneral Çolak për ndihmën që qeveria turke ka dhënë për modernizimin e FA shqiptare sa i përket mbështetjes logjistike, armatimit të ri dhe mjeteve të transportit. Pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse në kuadër të NATO, ishte një tjetër temë e diskutuar në takim. Trupat shqiptare dhe ato turke shërbejnë përkrah njëri-tjetrit

në misionin "Resolute Support" në Afganistan. Duke folur për çështjet aktuale të sigurisë, ministrja Kodheli shprehu ngushëllimet për humbjen e jetëve të pafajshme në sulmet terroriste që kanë goditur kohët e fundit disa qytete të Turqisë, duke i dënua ashpër këto akte. Më herët komandanti i Forcës Tokësore të Turqisë, gjeneral Salih Zeki Çolak, u prit në një takim edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo.

Gjeneral Salih Zeki Çolak ka lindur në Akçaabat në vitin 1954 dhe është diplomuar në Akademinë Ushtarake, turke. Përpara se të bëhej Komandant i Forcave Tokësore me Dekretin e datës 5 Gusht 2015, ai shërbeu si Komandant i Ushtrisë së I-rë (1st Army) (2014-2015). Gjeneral Salih Zeki Çolak mban medaljen e Shërbimeve të Shquara. Ai është i martuar me zonjën Melek Çolak, dhe ka dy fëmijë. Flet rrjedhshëm Anglisht dhe Frëngjisht.

Turqia, vendi i parë që ofroi mbështetje për FA

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo, priti komandantin e Forcës Tokësore të Turqisë, gjeneral Salih Zeki Çolak.

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh Shqipëri - Turqi, një delegacion i Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, i kryesuar nga gjeneral Salih Zeki Çolak, komandant i Forcës Tokësore ka kryer një vizitë zyrtare në vendin tonë. Gjatë kësaj vizite, delegacioni turk ka pasur takime me titullarë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA si dhe takime në Komandën e Forcës Tokësore.

Gjatë takimit në Shtabin e Përgjithshëm të FA, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo vlerësoi nivelin shumë të mirë të bashkëpunimit midis Forcave të Armatosura të dyja vendeve, sidomos në fushën e arsimimit, stërvitjeve, mbështetjes logjistike si dhe kujdesit shëndetësor për personelin ushtarak shqiptar dhe familjarët e tyre. "Tregues i një niveli të lartë dhe të suksesshëm të bashkëpunimit

është edhe bashkëveprimi në operacionet paqeruajtëse në kuadër të NATO, siç është edhe misioni aktual RSM në Afganistan, ku trupat shqiptare dhe ato turke shërbejnë përkrah njëri - tjetrit jo vetëm si aleatë, por edhe si miq dhe vëllezër", u shpreh ndër të tjera gjeneral Bazo gjatë takimit.

Nga ana e tij, komandanti i Forcës Tokësore turke, duke vlerësuar nivelin shumë të mirë të marrëdhënieve midis dy vendeve dhe dy ushtrive mike, veçoi dhe vlerësoi maksimalisht performancën shumë të mirë të studentëve shqiptarë, që studiojnë në akademitë ushtarake turke. "Jam i gatshëm për të rritur akoma më shumë mbështetjen në fushën e arsimimit dhe trajnimit, duke shtuar edhe më tepër numrin e bursave për studentët ushtarakë shqiptarë" - u shpreh gjeneral Çolak.

Tema e bisedimeve, përfshiu gjithashtu edhe ngjarjet më të fundit që kanë tronditur botën siç janë sulmet terroriste. Lidhur me këtë, gjeneralmajor Bazo në emër të burrave dhe grave nën uniformë, i shprehu ngushëllimet e tij më të sinqerta, komandantit të Forcës Tokësore turke, gjeneral Çolak për viktimat e sulmeve terroriste në Turqi, duke e siguruar që Forcat e Armatosura dhe populli shqiptar i dënojnë me ashpërsinë më të madhe këto sulme dhe se do të jetë gjithmonë në krah të popullit vëlla turk.

Marrëdhëniet ushtarake dypalëshe me Turqinë, vlerësohen të suksesshme dhe përfshijnë të gjitha fushat e mbrojtjes. Pas ndryshimeve demokratike në vendin tonë, Turqia ishte vendi i parë që i ofroi mbështetje ushtrisë shqiptare (filimet datojnë në vitin 1992).



Salih Zeki Çolak

Më shumë bursa për studentët ushtarakë shqiptarë

Kapiten ERVIN HODO

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh Shqipëri-Turqi, Komanda e Forcës Tokësore u vizitua me 4 prill 2016 nga komandanti i Forcave Tokësore turke, gjeneral Salih Zeki Çolak. Pas pritjes më truprojë nderi nga ana e komandantit të Forcës Tokësore, gjeneral brigade Nazmi Cahani, vizita vazhdoi me një takim pune midis dy gjeneralëve. Në takim u vlerësua niveli shumë i mirë i bashkëpunimit të deritanishëm në fushën e stërvitjes, në të cilën janë të angazhuar edhe dy specialistë turq të atashuar pranë batalionit "Komando" si dhe në fushën e mbështetjes logjistike, me armatimin e ri dhe mjetet e transportit të ardhura nga Turqia.

Gjeneral Cahani, gjeti rastin të falënderonte dhe të shprehte mirënjohjen për mbështetjen e pakursyer që Forca Tokësore, ka gjetur gjithmonë te Forcat e Armatosura turke. Sipas tij, përkrahja që ushtria turke i ka dhënë dhe vazhdon t'i japë ushtrisë shqiptare dhe Forcës Tokësore në veçanti mbetet e patjetërsueshme. Treguesi i nivelit të lartë dhe të suksesshëm të bashkëpunimit është edhe bashkëveprimi në operacionet paqeruajtëse në kuadër të NATO, siç është edhe misioni aktual RSM në Afganistan, ku trupat shqiptare dhe ato turke shërbejnë përkrah njëri - tjetrit jo vetëm si aleatë, por edhe si miq dhe vëllezër.

Nga ana e tij, komandanti i Forcës Tokësore turke, duke shprehur kënaqësinë e veçantë për këtë vizitë në ambientet e KFT, falënderoi për mikpritjen e ngrohtë dhe vëllazërore që iu rezervua nga gjeneral Cahani. Duke vlerësuar nivelin shumë të mirë të marrëdhënieve midis dy vendeve dhe dy ushtrive mike, gjeneral Çolak nënvizoi edhe performancën shumë të mirë të studentëve shqiptarë, që

studiojnë në Akademitë Ushtarake turke. Nisur nga kjo, ai u shpreh i gatshëm për të rritur akoma më shumë mbështetjen në fushën e arsimit dhe trajnimit, duke shtuar edhe më tepër numrin e bursave për studentët ushtarakë shqiptarë.

Tema e bisedimeve, përfshiu gjithashtu edhe ngjarjet më të fundit që kanë tronditur botën siç janë sulmet terroriste. Lidhur me këtë,

gjeneral Cahani në emër të efektiveve të Forcës Tokësore i shprehu ngushëllimet e tij më të sinqerta, Komandantit të Forcës Tokësore turke, gjeneral Çolak për viktimat e sulmeve terroriste në Turqi, duke e siguruar që Forcat e Armatosura dhe populli shqiptar i dënojnë me ashpërsinë më të madhe këto sulme dhe se do të jetë gjithmonë në krah të popullit vëlla turk.



Të dy gjeneralët, ranë dakord se lufta kundër terrorizmit, nuk është një luftë që i takon një shteti të vetëm, pasi është një luftë kundër vlerave të civilizimit dhe si e tillë kërkon një përgjigje globale. Në përfundim të takimit homologët drejtues të Forcave Tokësore përkatëse, gjeneral Cahani dhe gjeneral Çolak, shprehën mendimin se bashkëpunimin shumë të mirë që ekziston deri tani, ta forcojnë akoma më shumë në të ardhmen.

Më pas axhenda e gjeneral Salih Zeki Çolak, vazhdoi me një vizitë në ambientet e batalionit "Komando", repart ky, që prej kohësh asistohet nga përfaqësues ushtarakë turq. Për nder të vizitës së gjeneral Çolak, efektivat e batalionit "Komando" kryen demonstrime me tema taktike si hedhje nga kulla e alpinizmit, goditje objekti, çlirim pengu, qitje precizioni me snajper, luftim trup me trup etj. Në përfundim të demonstrimit komandanti i Forcës Tokësore turke, përgëzoi efektivat për veprimet e sakta dhe tepër profesionale. Vizita u mbyll me shkëmbimin e dhuratave simbolike, midis dy gjeneralëve, si dhe me realizimin e një fotoje të përbashkët, me efektivat e batalionit "Komando".



Gjeneral Salih Zeki Çolak dhe karriera e tij

General Salih Zeki Çolak ka lindur në Akçaabat, Trabzon Turqi në vitin 1954. Ai u diplomua në Akademinë Ushtarake, turke në vitin 1974 dhe në vitin 1975 në shkollën e Artilerisë dhe Raketave. Në periudhën 1975-1977 ai shërbeu në Adana, si komandant baterie në Regjimentin e Artilerisë së Korpusit të Gjashtë; komandant i togës së 22 batalionit IV-rt të Regjimentit të Kadetëve në Akademinë Ushtarake turke, (1977-1980); komandant baterie në Regjimentin e Artilerisë së Divizionit të 12-të të Këmbëorisë (Ağrı/Patnos, 1980-1983), instruktor në bordin e Taktikës në shkollën e Artilerisë dhe Raketave (Polatlı, 1983-1986). Gjatë kësaj periudhe ai kreu Kursin e Trajnimit special Ranger (Eğirdir, 1976) dhe Kursin e Avancuar të gjuhës Angleze (Ankara, 1978). Në vitin 1986 ai u përzgjedh për të ndjekur Kolegjin e Luftës të cilin e përfundoi në 1988, duke vazhduar më pas Kolegjin e Forcave të Armatosura.

Si Oficer Shtabi ai shërbeu në pozicionin e Shefit të Degës së Operacioneve dhe Stërvitjes në Divizionin e IV-rt të Këmbëorisë së Mekanizuar (Edirne/Keşan, 1988-1990); Komandant Batalioni në Regjimentin e 49-të Këmbëorisë të Forcave Paqerutëse të Qipros Turke (1990-1992); Oficer i Projekteve të Industrisë së Mbrojtjes në Drejtorinë e Planeve dhe Politikave të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Turqisë (1992-1995), Përfaqësues



ushtarak i Delegacionit Ushtarak Turk të Bashkimit European Perëndimor në NATO (Bruksel/Belgjikë, 1995-1998); Komandant i Regjimentit të 108 të Artilerisë (Muş/Malazgirt, 1998-2000), Shef i Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, Departamenti i Marëdhënieve me Publikun i Shtabit të Përgjithshëm (2000-2001). Në vitin 2001 ai gradohet gjeneral brigade dhe emërohet në Komandën e Forcave Tokësore ku shërbeu si Shef i Departamentit të Emërimeve në Komandën e Forcave Tokësore Turke (2001-2003). Më vonë ai drejtoi Brigadën e 19-të të Këmbëorisë (Balıkesir/Edremit, 2003-2005). Në vitin 2005, ai gradohet Gjeneral Major dhe emërohet Shef i Departamentit të Personelit në Komandën e Forcës Tokësore. Më vonë ai shërbeu si Sekretar i Përgjithshëm i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Turke, (2006-2008) dhe si Komandant i Shkollës së Mjeteve të Blinduara dhe Divizionit të Stërvitjes (2008-2009). Në vitin 2009, ai u gradua Gjeneral Lejtnant dhe shërbeu si Komandant i Korpusit të 7-të (2009-2011) dhe si Shef Shtabi i Forcave Tokësore Turke (2011-2013). Në vitin 2013, ai u gradua Gjeneral. Pas kësaj emërohet Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes së Forcave Tokësore, ku shërbeu deri në vitin 2014.



Kodheli uron ambasadorin Austriak Johann Saltler

Ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli ka uruar ambasadorin Austriak në vëndin tonë z. Johann Saltler me marrjen e detyrës së re. "Urime dhe suksese z. Johann Saltler, ambasadorit të ri të Austrisë, një vendi historikisht mik dhe partner i shqiptarëve", shkruan Kodheli në Facebook.

Dr. Johann Sattler emërohet në prill 2016 Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotfuqishëm i Ambasadës Austriake në Tiranë. Për vite ka drejtuar Departamentin për Ballkanin Perëndimor pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme Austriake. Nga viti 2008 deri në vitin 2013 Dr. Sattler ka qenë drejtues/publikues i grupit mediatik "WAZ" si dhe "Axel Springer" në Moskë. Më parë ai ka mbajtur poste të ndryshme pranë Ministrisë Punëve të Jashtme Austriake si p.sh. zëvendës drejtor i Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, këshilltar për Çështjet politike pranë Ambasadës Austriake në Washington si dhe anëtar kabineti i të dërguarit të posaçëm të BE-së për Europën

Juglindore (për Paktin e Stabilitetit) në Bruksel.

Dr. Johann Sattler studioi Shkenca Politike dhe Gjuhë Sllave në Universitetet e Insbrukut/ Pragës dhe Moskës. Nga viti 1994 deri në vitin

1996 kreu Akademinë Diplomatike të Vjenës. Në vitin 1996 u bë pjesë e Shërbimit Diplomatik të Republikës së Austrisë. Në vitin 2008 mori titullin Doktor pranë Universitetit të Vjenës.



Ian Mortimer, gjenerali britanik, në Komandën e Forcës Tokësore

Komandanti i Forcës Tokësore, Gjeneral brigade Nazmi Cahani priti më 7 prill 2016, në një vizitë zyrtare, gjeneral brigade Ian Mortimer, Komandant i Brigadës së 20 të Këmbësorisë së Mekanizuar të Ushtrisë Britanike dhe Komponentit Tokësor të Task Forcës së Bashkuar të Gatishmërisë Shumë të Lartë 17 (VJTF-17). Gjeneral Mortimer, shoqërohej në këtë vizitë nga nënkolonel Alexander McKay si dhe nga atasheu ushtarak britanik nënkolonel Richard Perry. Në takimin e zhvilluar me këtë rast, në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore, gjeneral Cahani dhe gjeneral Mortimer, diskutuan në lidhje me bashkëpunimin e ndërsjellë dhe përmbushjen e detyrave të përbashkëta në kuadër të NATO dhe veçanërisht mbi kontributet e Forcës Tokësore për VJTF-17. Pas takimit me gjeneral Cahanin, vizita e gjeneral Mortimer vazhdoi me lëvizjen për në ambientet e b2k, ku nëpërmjet një brifingu të organizuar me këtë rast, gjeneral Mortimer u njoh më nga afër me detyrat struk-



turën, pajisjet, armatimin modern në përdorim si dhe me aktivitetin e b2k. Fokusi kryesor i prezantimit dhe diskutimeve me shtabin e b2k ishin kapacitetet operacionale të k2b2k e cila vitin tjetër do të jetë pjesë e batalionit anglez të VJTF-17. Për nder të gjeneral Mortimer,

efektivat e b2k kryen një demonstrim stërvitor me temë nga taktikat e këmbësorisë, që ky batalion prioritar i Forcës Tokësore, zhvillon gjatë stërvitjes së tij të përditshme. Në përfundim të demonstrimit, gjeneral Mortimer falënderoi trupat e b2k për performancën e treguar.

Mbretëria e Bashkuar, zyrë për atasheun ushtarak në Tiranë

Sekretari i Shtetit për Mbrojtjen si Mbretërisë së Bashkuar, z. Michael Fallon, nëpërmjet një letre dërguar ministres së Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, ka konfirmuar hapjen e zyrës së atasheut ushtarak britanik në Tiranë. Zyra e atasheut ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, e cila pritet të hapet në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm, do të mbulojë edhe Malin e Zi, i cili pritet të anëtarësohet së shpejti në NATO.

Në letrën e tij, sekretari Fallon vlerëson rëndësinë e rritjes së marrëdhënieve mes Mbretërisë së Bashkuar dhe Shqipërisë si një aleat i palëkundur i NATO-s dhe angazhimin e vendit tonë si kontribues në Task Forcën e Përbashkët të Gatishmërisë Shumë të Lartë Very High Readiness Joint Task Force (VJTF), e cila udhëhiqet nga Mbretëria e Bashkuar.

Sekretari Fallon e konsideron Shqipërinë si një partner të rëndë-

sishëm sa i përket edhe stërvitjeve të përbashkëta, të cilat ai i cilëson si të klasit të parë.

“Jam i bindur se atasheu ushtarak do të përforcojë marrëdhënien e ngushtë që ne kemi në fushën e mbrojtjes, do të rrisë qëllimin për të punuar së bashku në çështje të interesit të përbashkët dhe do të forcojë bashkëpunimin e mëtejshëm mes forcave tona të armatosura”, – e mbyll letrën e tij sekretari Fallon.



7-të vjetori i anëtarësimit në NATO

Ditën e hënë, në 4 prill 2016, u përkujtua në një ceremoni festive në sheshin "Nënë Tereza" në Tiranë, 7-të vjetori i anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Ndryshe nga herët e tjera, këtë vit Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura menduan ta ndanin këtë festë me qytetarët. Mjetet, armatimet dhe pajisjet e reja të Forcave të Armatosura u ekspozuan për të kënaqur kuriozitetin e qytetarëve. Ministri i Punëve të Jashtme z. Ditmir Bushati, ministria e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, ministri i Punëve të Brendshme z. Saimir Tahiri, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi dhe Ildir Peçi, ambasadori i SHBA në Tiranë z. Donald Lu, Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, pjesëmarrës në këtë aktivitet, panë nga afër këto mjete e armatime dhe u informuan mbi funksionet e tyre. Pershendetën Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj, ministri i Punëve të Jashtme z. Ditmir Bushati, kurse fjalën e rastit e mbajti, ministria e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli.



MIMI KODHELI
Ministre e Mbrojtjes

Përvjetori i shtatë i anëtarësimit të Shqipërisë në NATO na jep mundësinë për të kuptuar e reflektuar rrugën e bërë nga Shqipëria si anëtare e Aleancës në këto vite si dhe sa e rëndësishme është NATO për sigurinë tonë të përbashkët. Që në hapat e para të demokracisë, Shqipëria vendosi të ndiqte një rrugë të qartë drejt anëtarësimit në organizatat e familjes euroatlantike, ku ne, një nga popujt më të vjetër të këtij kontinenti, nuk mund të mungonim.

Sot, po festojmë një nga arritjet më të mëdha për sigurinë e vendit dhe integrimin e plotë në komunitetin euroatlantik, si pjesë e një grupi demokracish moderne të destinuara të adresojnë sfidat e shekullit XXI, bazuar në vlerat e përbashkëta të lirive personale, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe shtetit ligjor. Rruga që Shqipëria mori për t'iu bashkuar Aleancës së Atlantikut të Veriut ishte e qartë dhe reflektoi që në ditët e para dëshirën e të gjithë shtresave të shoqërisë shqiptare për të vendosur interesat kombëtare mbi ato personale. Mbështetja masive që populli shqiptar i ka dhënë anëtarësimit në NATO tregon themelin mbi të cilin ne kemi ngritur të gjithë përpjekjen tonë politike, e vetmja e përfshirë në axhendat e çdo force politike në vend.

Gjatë këtyre viteve, së bashku me të 27 aleatët e tjerë, kemi adresuar shumë kërcënime për sigurinë tonë të përbashkët, fillimisht si vend partner e, që prej shtatë vitesh, si anëtarë me të drejta të plota. Ushtarakët tanë kanë luftuar në Kabul, Herat, Kandahar, Mazar-e-Sharif, si pjesë e misionit ISAF dhe tani si pjesë e misionit Resolute Support. Jemi të pranishëm atje, që nga viti 2002, duke iu bashkuar që në fillim koalicionit ndërkombëtar në luftë kundër terrorizmit. Midis heronjve pjesë e këtyre misionëve, ne patëm edhe një humbje kapiten Voglin, Dëshmor i Atdheut. Akti i tij heroik na kujton çdo ditë sakrificën tuaj të nderuar ushtarakë, sakrificë që e bën çdo shqiptar të përkulet me respekt para jush.

Ushtarakët tanë janë në Kosovë si pjesë e misionit NATO - KFOR. Po punojmë së bashku për stabilitetin në rajon si dhe për t'i sjellë sa më shpejt kosovarët në gjirin e familjes së tyre natyrale, atë euroatlantike. Tashmë operacionet në mbështetje të paqes, janë pjesë e traditës së angazhimeve ndërkombëtare të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Që kur ush-

Shqipëria dhe NATO kanë nevojë për njëra-tjetrën

tarakët e parë shqiptarë u nisën drejt Bosnje Hercegovinës 20 vjet më parë, kemi qenë të pranishëm në gjithë sfidat e mëdha botërore, përveç Afganistanit, në Irak, Kosovë e Çad. Dhe kemi treguar, përmes më shumë se 6500 ushtarakëve, se jemi në gjendje të tregojmë vlerat më të mira të një force ushtarake profesioniste e profesionale, njerëzish të zotë e trima.

Sot, shqiptarë dhe shqiptare në uniformë shërbejnë me dinjitet dhe përkushtim në shtabet dhe komandat e Aleancës në Belgjikë, Bullgari, Britani, Francë, Greqi, Itali, Holandë, Rumani, Turqi e në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shqipëria gjeneron paqe, siguri dhe stabilitet në të gjithë ambientin e sigurisë në të cilin po jetojmë.

Teksa shohim me krenari arritjet tona gjatë rrugëtimit tonë konstant përkrah aleatëve tanë natyralë, gjejmë edhe një moment për të reflektuar ndaj sfidave aktuale të sigurisë. Sulmet e përgjakshme

terroriste brenda kufijve NATO si në Paris, Ankara dhe Bruksel, apo edhe jashtë kufijve të saj, si ato të ditëve të fundit në Pakistan, kanë treguar se na duhet të adresojmë sa më parë atë që po ndodh në kufijtë jugorë të Aleancës. Rajoni në të cilin jetojmë është krejtësisht i përfshirë në vorbullat e pasigurisë që po krijohen në Lindje e në Jug. Valët e refugjatëve që po vijnë drejt Europës forcojnë nevojën për të gjetur një zgjidhje që prek rrënjët e problemit, e jo vetëm pasojat e tij. Shqipëria ka marrë një rol primar me donacionet ushtarake që Forcat tona të Armatosura kanë bërë gjatë dy viteve të fundit, ku kemi kontribuar, qenësishëm, në betejën që bota e civilizuar po bën kundër të keqes që po përploqet të zërë rrënjë në Lindjen e Mesme.

Nga ana tjetër, Shqipëria ka treguar se është e aftë të luajë një rol të rëndësishëm në gjirin e familjes euroatlantike edhe falë një tolerance të admirueshme fetare, bashkëjetesës shekullore mes mysli-

manëve, ortodoksëve dhe katolikëve. Ne modestish kemi ditur si të kontribuojmë në këto ditë të çoroditura të njerëzimit.

Edhe ngjarjet në Ukrainë edhe rreziqet në kufijtë e Polonisë dhe aleatëve tanë në brigjet e Detit Baltik, për fat të keq, po na tregojnë se jetojmë në një botë të cilën nuk e kishim imagjinuar të tillë në fillim të shekullit XXI. Na duhet të përqendrohemi në forcimin e Aleancës dhe të sigurohemi se jemi të gatshëm për rreziqet që na presin. Një arsye më shumë që ne të mbështesim dhe mirëpresim çdo anëtar të ri që kërkon t'i bashkohet Aleancës tonë. Përpjekjet e Malit të Zi u finalizuan suksesshëm dhe ai po i bashkohet familjes tonë. Shpresojmë që rruga drejt anëtarësimit të jetë sa më e shpejtë për të gjithë vendet e tjera të rajonit që e dëshirojnë atë.

Qeveria shqiptare ka ndërmarrë shumë reforma të rëndësishme për të modernizuar Forcat tona të Armatosura. E në këtë rrugëtim dua të falënderoj në mënyrë të veçantë qeveritë e Shteteve të Bashkuara, Italisë, Turqisë, Greqisë, Gjermanisë e Britanisë së Madhe për kontributin e tyre të posaçëm në edukim, trajnim, stërvitje, pajisje dhe modernizim. Dua ta mbyll këtë fjalë, me një falënderim të singertë për të gjithë ata që bënë të mundur anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. I përulëm me respekt të gjithë popullit shqiptar dhe falënderoj Forcat e Armatosura, administratën shqiptare, shoqërinë civile dhe çdo aktor të politikës pa dallim, që bënë të mundur realizimin e detyrimeve që më pas sollën anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Shqipëria dhe NATO kanë nevojë për njëra - tjetrën: për të mbrojtur vlerat tona; për të ruajtur sigurinë e vendeve tona; për të siguruar paqen në Europë dhe në botë; për të mbrojtur të ardhmen tonë.





Ministri Bushati: NATO-përmbushje e aspiratave tona kombëtare

I pranishëm në ceremoninë festive në sheshin "Nënë Tereza" në Tiranë, në 7-të vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, Ministri i Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati u shpreh krenar për ecurinë e vendit tonë. Sipas kryediplomatit shqiptar, anëtarësimi me të drejta të plota i vendit tonë në NATO është plotësimi

i një boshllëku 60-vjeçar në këtë aleancë. "NATO është bashkësi e vlerave dhe standardeve më të mira qytetare. Kur Shqipëria u bë anëtare me të drejta të plota në NATO, shumë kush në vendin tonë u ndje krenar, teksa jashtë territorit tonë pati skepticizëm, pasi vlerësonin se si ka mundësi një vend kaq i vogël arrin të

jetë pjesë e një aleance kaq të madhe, por ne treguan se kemi mbështetur këtë aleancë me të gjitha kapacitetet tona", tha Ministri i Jashtëm. Ai shtoi se anëtarësimi i Shqipërisë në NATO është përmbushje e aspiratave tona kombëtare, jo vetëm në fushën e sigurisë, por projektit euroatlantik që ka vendi ynë.

Veliaj: NATO konfirmoi orientimin tonë perëndimor

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Kerion Veliaj në përshëndetjen e aktivitetit festiv me rastin e 7 vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, tha se anëtarësimi i Shqipërisë në NATO është një nga ngjarjet ku të gjithë shqiptarët janë të bashkuar, pavarësisht dallimeve që kanë për zhvillimet e përditshme të tyre. "Kjo arritje kaq e rëndësishme", theksoi kryetari i Bashkisë, "jep një mesazh të fortë për gjithë shqiptarët se sa mund të arrijnë kur fokusohen tek objektivat që kanë realisht rëndësi për vendin". Ai shtoi se anëtarësimi i vendit tonë në këtë organizatë, më shumë se një angazhim ushtarak, ishte njëkohësisht edhe një konfirmim i orientimit dhe aspiratës së shqiptarëve për të qenë anëtarë të familjes së madhe evropiane.

"Për anëtarësimin në NATO besoj se është shumë e vështirë të gjesh kundërshtarë. Kjo është me të vërtetë një datë shumë e rëndësishme në historinë e shqiptarëve. Ne bashkohemi kur vjen puna tek aspiratat euro-atlantike të vendit tonë. Për ne shqiptarët anëtarësimi në NATO është shumë më tepër sesa thjesht pjesëmarrje në një klub



sigurie apo në një tryezë të rëndësishme vendimmarrjeje. Është një konfirmim i orientimit tonë perëndimor dhe evropian. Njohje e faktit se ne jemi pjesë e kësaj familje. Kjo arritje kaq e rëndësishme na jep të gjithëve një mesazh të shumë të fortë bashkimi. Na bën të kuptojmë sesa shumë mund të arrijmë kur fokusohemi tek objektivat që kanë realisht rëndësi për vendin tonë. Sot që gjysma e ëndrrës sonë Euro-Atlantike është plotësuar, na mbetet të punojmë shumë për të arritur edhe objektivin tonë tjetër madhor

strategjik: anëtarësimin në BE", tha Veliaj. "Sot, vazhdoi ai, bëhen 7 vjet nga hyrja në NATO. Është e vështirë të shpjegosh sot se me çfarë padurimi u prit kjo arritje për 25 vjet më përpara, sa shumë u punua për të. Por, është më e vështirë akoma të shpjegosh sesa shumë ka ndryshuar Shqipëria për tu bërë anëtare e NATO-s. Sot po rriten breza që as nuk mund ta imagjinojnë se për shumë e shumë vite me radhë Tirana, qyteti ynë, ishte epiqendra e një paranoje anti-NATO. Vetë ky bulevard i qytetit tonë ishte arena ku Shqipëria i skërmiste dhëmbët dhe i vringëllinte armët NATO-s. Unë kam qenë fëmijë, por i mbaj mend parakalimet në këtë bulevard që donin t'i çonin NATO-s mesazhin, mos u ngatërro me Shqipërinë". Në mbydhje Veliaj nënvizoi se: "Së shpejti do të mblidhet në Tiranë Asambleja Parlamentare e NATO-s. Një lajm i mirë dhe një vlerësim për Shqipërinë, por edhe një lajm i mirë dhe një mundësi e artë për promovimin e qytetit tonë të Tiranës".

Memorial për Dëshmorët e Forcës Ajrore

Aviatorët, më të sakrifikuarit në kohë paqe

Aviacioni Ushtarak, si arma e cila për shkak të natyrës së rrezikut, ka më shumë dëshmorë se të gjitha armët e tjera të ushtrisë në kohë paqe

Në kuadër të 65-vjetorit të krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar në Komandën e Forcës Ajrore, Rinas, u inaugurua më 22 prill 2016, Memoriali i Dëshmorëve të Forcës Ajrore. Në këtë aktivitet morën pjesë zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koci, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Përgjithshëm, gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Vladimir Avdiaj, komandantë të forcave, familjarë të Dëshmorëve të Aviacionit, përfaqësues të shoqatës të "Aviatorëve të Shqipërisë", vetëranë dhe ushtarakë.

Në fjalën e mirëseardhjes, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Vladimir Avdiaj, pasi falënderoi pjesëmarrësit në këtë aktivitet, bëri një përmbledhje të shkurtër të historisë 65 vjeçare të krijimit të Aviacionit Ushtarak shqiptar: "Jemi në prag të 65 - vjetorit të Aviacionit Ushtarak, dhe historia e kësaj arme,

nuk u shkrua vetëm me mund dhe sakrificë, por edhe me gjakun e dëshmorëve të shumtë, të cilët dhanë jetën e tyre në krye të detyrës. Aviacioni Ushtarak, si arma e cila për shkak të natyrës së rrezikut, ka më shumë dëshmorë se të gjitha armët e tjera të ushtrisë në kohë paqe. Vetëm pak ditë më parë ne ishim dëshmitarë të ngjarjes së dhimbshme, të vetmohimit dhe sakrificës të dy dëshmorëve më të rinj të aviacionit kaptën Florian Delia dhe toger Donald Hoxha, të cilët ranë në krye të detyrës, gjatë stërvitjes ajrore. Vepra e tyre i bashkohet asaj të armës sonë. Në nderim të dëshmorëve të Forcës Ajrore, kemi ngritur këtë memorial që përurojmë sot. Shkëmbin e kemi marrë nga Mali i Skënderbeut, kryeheroit të shqiptarëve dhe besojmë që kujtimi i dëshmorëve tanë do të jetojë po aq gjatë sa kujtimi i Skënderbeut. Të paharruar dëshmorët tanë, i paharruar qoftë kujtimi i tyre!", - theksoi gjeneral Avdiaj në përfundim të fjalës së tij.





Në inaugurimin e Memorialit të Dëshmorëve të Forcës Ajrore një përshëndetje e veçantë iu bë të pranishmëve në këtë aktivitet nga zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koci. "Kjo është një ceremoni që na bashkon nëpërmjet respektit, përluljes për dëshmorët e Forcës Ajrore. Sot është Dita Ndërkombëtare e Tokës, por ne jemi mbledhur këtu për të respektuar dëshmorët hyjnorë që janë pjesë e panteonit të madh të Dëshmorëve të Atdheut. Ata janë njëkohësisht dëshmorë të tokës por edhe të qiellit dhe kjo i bën ata të veçantë. Përulemi nga dëshmori i parë i aviacionit Ibush Vokshi dhe deri tek të fundit Floran Delia dhe Donald Hoxha."

Në emër të shoqatës "Familjet e Dëshmorëve të Aviacionit", përshëndeti kryetari i kësaj shoqate z. Kujtim Serani. Në emër të shoqatës së "Aviatorëve të Shqipërisë," përshëndeti kryetari i kësaj shoqate, gjeneral brigade (R) Astrit Jaupi. Në vazhdim të aktivitetit zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koci dhe kryetari i shoqatës "Familjet e Dëshmorëve të Aviacionit" z. Kujtim Serani zbuluan memorialin kushtuar dëshmorëve të Forcës Ajrore. Pranë memorialit u vendosën kurora dhe buqeta me lule, si dhe u bënë homazhe nga të pranishmit në këtë aktivitet. Aktiviteti u përmbyll me dhurimin e albumit "65 vjet Aviacion Ushtarak shqiptar", familjeve të dëshmorëve të pranishmëve në këtë aktivitet.



“Mirënjohja e Tiranës” për 13 aviatorë

Në kuadër të 65-vjetorit të krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar, me propozim të shoqatës "Familjet e Dëshmorëve të Aviacionit", Bashkia e Tiranës dekoroi me medaljen "Mirënjohja e Tiranës", dëshmorët e aviacionit: Refit Jazo, Muarrem Hida, Bego Hoxha, Armando Gjoka, Ndue Logu, Agron Galanxhi, Enver Haka, Pandeli Zhupa, Tafil Agaj, Vangjel Postoli, Veledin Resuli, Donald Hoxha, Floran Dalia. Në këtë ceremoni merrnin pjesë zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Vladimir Avdiaj, kryetari i Bashkisë së Tiranës z. Erion Veliq, pjesëtare të shoqatës së "Aviatorëve të Shqipërisë", shoqatës "Familjet e Dëshmorëve të Aviacionit", deputeti i kuvendit z. Piro Lutaj dhe të ftuar.



Nderojmë lavdinë e tyre

U përkujtua më 25 prill 2016, në mjediset e Bazës Ajrore të Kuçovës 65-vjetori i krijimit të Forcës Ajrore shqiptare. Të pranishëm në aktivitet ishin ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, ministrja e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, znj. Ermonela Felaj, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, deputetë të Kuvendit, komandantët e forcave, përfaqësuesit më të lartë të pushtetit vendor, veteranë të aviacionit ushtarak, familjarë të dëshmorë dhe shumë të ftuar. Pas fjalëve të rastit, komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Vladimir Av-



diaj, dorëzoi certifikata falënderimi për disa nga veteranët e kësaj force. Familjarëve të dëshmorëve më të fundit të atdheut, kapiten Florian Delia dhe toger Donald Hoxha, iu dorëzua nga një maket i helikopterit EC 145,

në përkujtim të pasionit të tyre. Në përfundim të ceremonisë, ministrja Kodheli falënderoi përfaqësuesit e federatave të aeronautikës të Shqipërisë dhe Kosovës, të cilët me ishin në mbështetje të këtij aktiviteti.

65-vjet histori sukcesi e shkruar në tokë dhe në ajër Kodheli: Aviatorët tanë qëndrojnë në të njëjtin nivel me ata të Aleancës

Fjala e Ministres së Mbrojtjes Mimi Kodheli, në 65 vjetorin e krijimit të Forcës Ajrore

Dikujt i qëllon të jetë në vendin e duhur në momentin e duhur. Unë kam fatin të gjendem sot këtu për të festuar së bashku 65-vjetorin e Forcës sonë Ajrore. E filloj me urimin gëzuar 65 - vjetorin të nderuar ushtarakë, ish - ushtarakë dhe civilë që keni shërbyer në Aviacionin Luftarak, Mbrojtjen Kundërajrore dhe që vijoni të shërbeni në Forcën tonë Ajrore!

Ky përvjetor i Forcës Ajrore vjen vetëm pak ditë pas aksidentit ku gjatë një fluturimi stërvitor me rrezikshmëri të lartë, ashtu siç janë të gjitha fluturimet, ranë në krye të detyrës dy pilotë, shokë dhe bashkëpunëtorë të shtrenjtë. Në fakt, ndërkohë që po bëhet kjo



ceremoni, ju dëgjoni Alket Islamin të fluturojë. Për të gjithë ata që nuk kanë mundësi ta shikojnë, ai mban një flamur modest me dy emra të dashur për ne; Floran Delia dhe Donald Hoxha. Dy emra të cilët i bashkohen listës së pilotëve të tjerë që janë të pranishëm këtu, pavarësisht se mungojnë ata që derdhën, jo vetë djersën, por që dhanë dhe jetën për aviacionin luftarak shqiptar, në krye të detyrave dhe misionëve të ngarkuara.

Këta pilotë, mbi 40 të tillë janë shpallur dëshmorë, por në fakt ju të gjithë pilotët në shërbim të atdheut jeni heronj të tillë. Shkruani histori trimërie çdo ditë në qiejt e hapësirës ajrore shqiptarë me guxim dhe një personalitet më shumë se të spikatur.

Sot jemi mbledhur të nderojmë aktin historik kur në 24 prillin e vitit 1951, në përmbushje të një prej aspiratave dhe ëndrrave më të mëdha të popullit shqiptar, atij të të pasurit të një aviacioni luftarak. Historia nisi ashtu siç edhe u tha me fluturimin e parë të një avioni ushtarak të njësisë së parë të aviacionit shqiptar në Laprakë, për të kulmuar pak vite më pas, me njësinë e parë të Aviacionit Reaktiv të krijuar pikërisht këtu në Kuçovë. Ky është materializimi i përpjekjeve të të gjitha qeverive, të nisura në fakt që në vitin 1914, por që u pengua në fakt nga barra ekonomike, hallet e vendit, të cilin ende pa u konsoliduar si shtet, e bënë shtetin shqiptar një shtet të dobët që i duhej fillimisht të përballej me Luftën e Parë Botërore, dhe më pas me të dytën duke mos mundur krijimin që herët të kësaj force.

Forcat Ajrore dhe të gjithë ne, sot, hedhim me krenari vështrimin në historinë 65 - vjeçare të suksesit, të shkruar në tokë dhe në ajër, me ngjarje, sakrificë, përkushtim, në mbrojtje të atdheut tonë të shtrenjtë.

Forca Ajrore, apo aviacioni i dikurshëm, kanë pasur metamorfozat e saj. Ka ardhur duke u rritur, duke u pasuruar me avionë të ndryshëm

gjuajtës dhe transporti, me helikopterë. Është takuar e ndarë disa herë me mbrojtjen kundërajrore dhe duke u pasuruar edhe me armatime e raketa kundërajrore apo shërbimet mbështetëse.

Në fakt anëtarësimi në NATO, sikurse për gjithë Forcat e Armatosura të RSH edhe për Forcën Ajrore shtroi nevojën e reformimit, ristrukturimit, zvogëlimit të saj,

por modernizimit. Sfida të reja u shfaqën në horizontin e integritimit në Aleancë. Ndërveprueshmëria kërkonte formim, procedura dhe teknologji të reja ndërsa mundësitë ishin të kufizuara për modernizim, u kërkuan dhe u zbatuan plane racionale, maturi dhe prioritete të qarta.

Transformimi kërkonte ndryshime në struktura, duke rritur



Maket i helikopterit EC 145, iu dorëzua familjarëve të dëshmorëve të atdheut, kapiten Floran Delia dhe toger Donald Hoxha, në përkujtim të pasionit të tyre.



Historiku i Forcës Ajrore në këto 65 vite është shkruar sa me djersë, aq dhe me sakrificë. Mirënjohja për gjithë këtë mund dhe sakrificë do të përcillet me respekt në gjeneratat e ardhshme. Unë jam sot këtu për t'ju garantuar këtë në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe në emër të qeverisë shqiptare. Dhe besoj dhe shpresoj që kështu do të jetë dhe në dekadat që do vijnë...

profesionalizmin dhe gatishmërinë për t'i bërë ushtarakët çdo ditë dhe më të barabartë me kolegët e vendeve të NATO-s. Dhe ja ku gjendemi sot, ku përveç arsimit, trajnimit dhe stërvitjes së njëjtë me ta, ju keni dëshmuar se edhe në aftësitë e zotësitë tuaja qendroni në të njëjtin nivel me atë të Aleancës.

Aktualisht Forca Ajrore, zotëron kapacitete, mjete dhe teknologji bashkëkohore së cilës pilotët dhe ushtarakët ia kanë vënë në shërbim të atdheut dhe popullsisë, me përkushtim dhe profesionalizëm, në kryerje të misionëve e detyrave të vështira, madje shumë të vështira

të situatave komplekse emergjente apo fatkeqësish, ditën dhe natën brenda dhe jashtë kufijve të hapësirës qiellore të Shqipërisë.

Standardet e NATO-s për fluturimin tashmë janë objektiva të realizuara dhe personeli është i aftë të ndërveprojë me homologët e vendeve aleate si në zhvillimin e stërvitjeve ashtu edhe në operacionet e përbashkëta.

Historiku i Forcës Ajrore në këto 65 vite është shkruar sa me djersë, aq dhe me sakrificë. Mirënjohja për gjithë këtë mund dhe sakrificë do të përcillet me respekt në gjeneratat e ardhshme. Unë jam sot këtu për t'ju garantuar këtë në emër

të Ministrisë së Mbrojtjes dhe në emër të qeverisë shqiptare. Dhe besoj dhe shpresoj që kështu do të jetë dhe në dekadat që do vijnë, duke shprehur njëkohësisht nderimin tim për të gjithë ata që dhanë edhe jetën për lartësuar emrin e Forcës Ajrore, shpreh mirënjohje për brezat e ushtarakëve që kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë me përkushtim, sakrificë dhe vetëmohim në përmbushje të misionit për garantimin e sovranitetit dhe integritetit të atdheut tonë të dashur.

Me këtë rast dua të falënderoj veteranët dhe të gjithë ish-ushtarakët dhe civilët, të cilët kanë shërbyer në aviacion, mbrojtjen kundërajrore dhe Forcën Ajrore, kanë dhënë gjithçka që nga themelimi, rritja dhe sukcesi i kësaj force në përmbushjen e misionit të saj fisnik. Puna, përpjekjet dhe përkushtimi i juaj, thjesht dhe vetëm na bën të përkulemi me respekt para jush. Në mënyrë të veçantë falënderoj ish-komandantët e kësaj force për vizionin dhe lidhësin e tyre në përmbushje të misionit të Forcës Ajrore.

Një falenderim i veçantë i shkon vendeve aleate, veçanërisht Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Italisë, Francës dhe Mbretërisë së Bashkuar për mbështetjen që i kanë dhënë kësaj force, në trajnimin dhe stërvitjen e pilotëve në mënyrë të veçantë.

Jam e sigurt se Forca Ajrore do të vijojë të jetë e gatshme për operacione në ruajtje të hapësirës sonë qiellore, sikurse edhe për të mbështetur popullsinë dhe autoritetet civile në rastet e emergjencave dhe fatkeqësive natyrore.

Me këtë rast rikonfirmoj se Ministria e Mbrojtjes do vijojë të mbështesë me të gjitha mundësitë Forcën Ajrore sikurse edhe forcat e tjera. Pas përmirësimit të trajtimit të pilotëve, synojmë rritjen e orëve të fluturimit për përmirësimin e aftësive fluturorese, zhvillimin e kapaciteteve, si dhe pa harruar rritjen e cilësisë së mirëmbajtjes dhe gatishmërisë teknike të mjeteve.

Me ju rreshtohemi me dinjitet përkrah ushtrive të NATO-s

*Komandanti i Forcës Ajrore Gjeneralbrigade Vladimir Avdiaj,
duke folur në 65 vjetorin e Armës së Aviacionit*

U takuam edhe këtë 24 prill të përkujtojmë datën kur hodhi fillesat e saj Arma e Aviacionit Shqiptar, armë e cila ndër vite ka demonstruar profesionalizem, trimeri, kurajo vetemohim dhe sakrifice të larte. Historia e aviacionit ushtarak për 65 vite me radhë, nuk u shkrua vetem me mund e sakrifica por edhe me gjakun e deshmoreve të shumte, të cilët dhane jeten e tyre, në krye të detyrës, në moshën me të bukur. Në aviacion, përkushtimi ndaj detyrës nuk merr parasysh as sakrificën me sublime.

Vetem pak dite më parë ne ishim deshmitarë të sakrificës sublime të dy deshmoreve me të rinj të aviacionit Kapiten Floran Delia dhe toger Donald Hoxha të cilët ranë në krye të detyrës, gjatë stervitjes ajrore. Vepra e tyre i bashkohet asaj të deshmoreve të tjere të armës sone. Çdo 24 prill, kujtojmë dhe nderojmë me respekt aktin heroik dhe të paharruar të kolegeve tane, "Dëshmorëve të Aviacionit", të cilët janë dhe do të jenë krenaria me të madhe, nderi dhe lavdia e kësaj arme.

Aviatorët, inxhinierët, teknikët dhe specialistët, gjithë personeli ushtarak dhe civil që shërbeu dhe shërben në armen e bukur të aviacionit shqiptar, kanë të drejtën legjitime të krenohen me punën dhe sakrificat e tyre, me përgatitjen dhe gadishmerinë e tyre të perherëshme për realizimin e misionëve të ngarkuara.

Nga 24 prilli i vitit 1951, kur u hodhën themelet e Aviacionit e deri sot, kemi përshtuar një rrugë të

gjatë e cila shpesh ka qenë e mundimshme, plot sakrifica, përpjekje dhe realizime në zotërimin e teknikes se fuqishme luftarake të aviacionit reaktiv dhe atij me helike. Gjej rastin të shpreh mirënjohjen dhe respektin me të madh për aviatorët dhe personelin inxhiniero-teknik që drejtoi dhe shfrytëzoi në vite aviacionin reaktiv, eksperiencën e të cileve e lënë pas, mbetet një vlerë e çmuar, sidomos për ndjenjën e lartë të përgjegjësisë dhe korrektesën e tyre shembullore në zbatimin e detyrave. Një mirënjohje e vecante shkon për komandantët dhe drej-





tuesite armes se aviacionit në vite të cilët me kontributin e dhënë për krijimin dhe konsolidimin e saj janë do të mbeten figura të shquara në radhët e Forcave të Armatosura Shqiptare.

Është e drejta juaj që, të ndjeheni krenarë për zhurmen e turbinave reaktive dhe gjithë kontributin e dhënë gjatë shërbimit tuaj në këtë armë. Është kjo një krenari legjitime që na detyron ne që jemi ne detyre që të rrisim kërkesat ndaj vetes për të ecur përpara. Janë themelet dhe bazat e forta që hodhët Ju, që na japin forca dhe vendosmeri të rreshtohemi me dinjitetet përkrah ushtrive të NATO-s, aleancës më të madhe të sigurisë, paqes, lirisë dhe demokracisë. Në 65-vjetorin e krijimit të Aviacionit dhe në shtatë vjetorin e

anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, Forca Ajrore e gjen veten të kualifikuar dhe të trajnuar sipas standardeve të aleancës, e aftë të kryejë se bashku me të misionin e mbrojtjes së sovranitetit të hapësirës ajrore të RSH.

Vitet e fundit, fale mbeshtetjes së shtetit shqiptar dhe Ministrisë së Mbrojtjes, Forca Ajrore është pajisur me helikoptere të gjenerates së katert të një teknologjiete avancuar perëndimore. Furnizimi me helikopterët COUGAR dhe EC-145 të cilët tashmë janë pjesë e Flotës sonë Ajrore, e bën efektivin tonë të operojë me të njëjtat standarde dhe manuale si Forcat e tjera Ajrore anëtare të NATO-s. Trajnimi i shume pilotëve, teknikëve dhe specialisteve tane është bere në shkollat me të mira, ne vende aleate si Itali, Turqi, France, Angli, Gjermani. Të gjitha keto kanë bërë që imazhi dhe vizioni i kësaj force të përmiresohet me tej. Synimi jone është krijimi i një force tërësisht moderne, kudo të spikate standardizimi me NATO-n dhe profesionalizmi i gjithanshëm. Profesionalizmi që tregohet çdo ditë nga personeli i Forcës Ajrore si në stërvitjet brenda vendit me forcat e tjera ashtu edhe ne ato të perbashketa me vendet aleate dhe partnere, profesionalizmi gjatë misioneve humanitare në ndihmë të popullsisë, në rast përmytjesh, bllokimet nga dëbora, operacionet e kërkim-shpëtimit SAR, etj, janë treguesi real i asaj ç'ka Forca Ajrore është me të vërtetë. Duke vlerësuar dhe nderuar punën e paraardhësve të Aviacionit, në të ardhmen na mbetet ne si detyrë të ecim e të çojmë më tej arritjet e deritanishme, të ndjekim me rigorozitet e të zbatojmë me cilësi detyrat e përcaktuara për transformimin e modernizimin e Forcës Ajrore sipas standardeve dhe detyrave që burojnë nga anëtarësimi në NATO.

Rënë në krye të detyrës

1. Ibush Ibrahim **Vokshi**
2. Qemal Sadedin **Mërtiri**
3. Fuat Halim **Sulaj**
4. Vasil Nikolla **Trash**
5. Islam Myrteza **Xhani**
6. Hektor Eftim **Lako**
7. Sokrat Gori **Basha**
8. Niko Selman **Hoxha**
9. Stilian Vani **Tanku**
10. Jovan Llazi **Kaçorri**
11. Muharrem Murat **Hida**
12. Refit Asllan **Jazo**
13. Kaso Salo **Petoshati**
14. Shyqyri Azbi **Balla**
15. Azbi Ramadan **Serani**
16. Islam Sinan **Mani**
17. Bego Isa **Hoxha**
18. Dhimitër Spiro **Robo**
19. Veiz Halil **Kovaçi**
20. Sefedin Hasan **Tomçini**
21. Vasil Thoma **Noni**
22. Shpëtim Selman **Sula**
23. Armando Liman **Gjoka**
24. Sabri Shefki **Toçi**
25. Luto Refat **Sadikaj**
26. Ndue Mëhill **Logu**
27. Haki Abaz **Skuqi**
28. Jorgji Li azi **Fane**
29. Agron Hasaf **Galanxhi**
30. Enver Osman **Haka**
31. Pandeli Jorgo **Zhupa**
32. Tafil Njazi **Agai**
33. Vangjel Vangjel **Postoli**
34. Veleidin Delo **Resuli**
35. Eduart Qirjako **Kostëdhima**
36. Fluturim Qani **Molla**
37. Idriz Ibrahim **Hoxha**
38. Jani Prokop **Tarifa**
39. Muhamet Bisho **Hasmuja**
40. Arben Tajar **Hoxha**
41. Albert Xhelo **Lelaj**
42. Bardhyl Selami **Këlliçi**
43. Vangjel Kiço **Çondi** pilot i pare
44. Qemal Bilal **Koni** inxhinier fluturimi
45. Demush Hajdar **Heba**
46. Florian Jahja **Delia**
47. Donald Visar **Hoxha**



Fluturimi është “atdheu” i çudirave...!

..mall dhe respekt për ju të ajrit, për thinjat tuaja të arta.

Çdo ngritje për Fluturim është fillimi i një beteje, që konsiderohet “Luftë” ...ndaj kërkesat për një fluturues janë përtej çdo profesioni, qoftë ai në fushën ushtarake apo shkencore. Për pilotin dhe teknikun aftësia për të fluturuar dhe përballuar problemet që vijnë nga teknologjia moderne janë evidente.



ZAIM KUÇI
Ish-pilot i Forcave të Armatosura

Tuhet shpesh se hapësira ajrore është e pafund dhe nuk ka pengesa. Në ajër nuk ka njerëz që të ngatërojnë rrugën edhe pa trotuare, as semaforë e kufizues të tjerë, e, për rrjedhojë mund të lëvizësh si e nga të duash. Por realisht nuk është kështu, ajri ka barriera më të forta për t'u zbatuar, aty aplikohen ligjet më të ashpra, më moderne, më të rrezikshme; aty vlerësohet sekondi dhe minuti nuk ka vlerë. Aty rreziku është pasagjeri më i frekuentuar, i ulur fare pranë sediljes të fluturimit, të pranuar dhe miratuar nga vet ti, për më tepër t'i e bën rrezikun me shumë pasion - profesion të jetës. Të fluturuarit nuk është një fushë e gjërë e aplikueshme nga të gjithë. Ai kërkon të tjera

sjellje, ndryshe kthehet në një rrezik për atë që e bën dhe për të tjerët që ndodhen në rrezen e veprimit të tij. Fluturimi është një mori sjelljesh të kujdesshme ku përqëndrimi dhe shpërndarja e vëmendjes janë së bashku. Ai është një enigmë dhe kapriçioz si i tillë ai nuk mund të jetë objekt njohje i të gjithëve, aq më keq të trajtohet dhe të sillet i zgjidhur nga të gjithë. Ai i përket specialistëve dhe vetëm atyre. Mbi këto të fshehta që të afron fluturimi, me/pa dashje ne gabojmë duke nxituar. Aq më e papranueshme është kur kërkohen situata për përftime interesi apo politike. Ndaj shpesh në raste aksidenti kur nuk njihet “Fenomeni” shpesh sillet për të vlerësuar “Misteri”, kjo është e dëmshme për të shkuar tek ndodhia.

Specialistët e ajrit vlerësojnë se, çdo ngritje për Fluturim është fillimi i një beteje, që konsiderohet “Luftë” ...ndaj kërkesat për një fluturues janë përtej çdo profesioni, qoftë ai në fushën ushtarake apo shkencore. Për pilotin dhe teknikun aftësia për të fluturuar dhe përballuar problemet që vijnë nga teknologjia moderne janë evidente. Asnjehere nuk mund të themi se teknologjia e mjeteve për fluturim, edhe pse është zhvilluar me ritme të mëdha, mund të sigurojë garanci absolute të mjetit fluturues. Duhet të pranojmë se, së bashku me perfeksionin teknologjik lindin dhe fenomene që çbalancojnë punën normale të pilotit në ajër duke sjell të papritura në mjetin ajror. Zotësia për të përballuar këtë teknologji varet nga një mori faktorësh, kështu nuk mendohet se rrisi në fluturim është “0” sidomos në avionet luftarake. Teknologjia moderne kërkon shërbime speciale në tokë dhe përdorim në ajër perfekt, në të kundërt ajo kthehet prag aksidenti.

Fluturimi kryhet në trusni gjithformash, ndaj është vlerësuar, “fluturim = ndreqje gabimesh”. Misioni për forcat ajrore është kryerja e fluturimeve në terrene të vështira dhe në lartësi të vogla, kjo është detyrë e kohës, piloti përgatitet për luftë. Ngritja nga toka dhe kthimi drejt saj, sado rutinë qoftë, mbetet një detyrë për ta konsideruar të vështirë. Avionin në fluturim konsiderojeni si një fëmijë i sapo lindur, thuhej shpesh



nga instruktori P. Naze; kohë kur ne filluam të merrnim rrugët e qiellit. në të kundërt ai është aksident. Duke anashkaluar përgatitjen e fluturuesit, të cilat janë procedura strike, rrishtu vleresohet dhe parashikohet në çdo element të fluturimit. Piloti përgatitet për ta parandaluar atë por avioni ndodhet i ekspozuar në ajër dhe nga fenomene të krijuara të natyrës si, turbullenca, përshtjellime dhe ndryshime të vullshme të rrymave ajrore. Të pranueshme dhe rrezik janë në fluturim dhe rënia në iluzion e pilotit, fobia dhe vetmia që të krijon hapësira ajrore. Kështu, fluturimi është një lojë ku përzihen të gjitha këto, një fushëbeteje në hapësirën e pafund qiellore; një dyel me lojtarë: rreziku dhe jeta! Në botën e fluturimit luftarak, në fluturime akrobatike, natën, në re, në lartësi të vogla dhe terrene të vështira ka patur shume aksidentë të shkaktuar nga gjendja e pilotit, teknologjia dhe faktorë të tjerë, ai nuk u beson instrumentave të pilotimit, fenomeni i pranuar si "pjesë" e profesionit.

Vendimtare për të siguruar fluturimin është përgatitja e teknikës për fluturim. Mjeti fluturues, sa më i sofistikuar qoftë ai, po aq kapriçios bëhet për mirëmbajtje dhe shërbime. Mjeti fluturues kërkon një respektim dhe regjim të fort në furnizimin me karburant, vajra etj. Neglizhimi dhe abuzimi mbi to për afatet dhe parametrat limit të tyre, përbën aksident ajror. Avioni (reaktive/supersonik) aq sa i zhurmëshëm dhe përbindësh duket po dhe aq delikat është. Piloti sillet me kulturë dhe delikatesë me të; do të thoja si një pianist në kërkim të melodisë së tij, ai luan po aq lehtësisht me gishtat e tij në tastierën e kabinës së instrumentave, të zbuluar me butona të kuq me nënshkrimin "rrezik".

Rrishtu i kryerjes së fluturimeve konsiderohet maksimal, ndaj normat ndërkombëtare të fluturimit kërkojnë trajtimin e fluturuesve duke u bazuar në standardin "Dëmshtëri të Shëndetit", «Risk i Menjehershem», Rrezik maksimal i pranuar. Ky standard aplikohet në vendet anëtare të Nato-s. Aksidentet ajrore në avionët e forcave të armatosura janë prezente gjatë stërvitjeve, qofshin

dhe ata më moderne të kohës, të pilotuar nga pilotat «as» të botës. Informacioni si më lartë është shkollues (fluturimi në avionët luftarak) dhe nuk sjell diçka të re për ata që i shërbejnë mjetit fluturues por nisur nga interpretimet mediatike të gabuara e solla si një kujtesë për fluturuesit, por dhe për të treguar se sa gabojmë kur marrim rolin e specialistit.

Fluturimi ka të papriturat e tij, aq sa shkencat moderne duket si e pafuqishme. Në Gjadër, mars 1982 u vra në ngritje nga një pulë bardhë, me Mig 21 piloti më i talentuar i regjimentit. Shume fikje motorrash kanë ndodhur në botë nga ky fenomen. Në një aerodrom në Angli u rrëzuan disa avionë që detyruan



anglezët që të mbyllnin aerodromin. Nuk mund të besohet që hunda e këtij avioni të kompanisë Turkish Airlines është deformuar nga një grup zogjsh, pa le si do të shkruante media jonë...

Atij i shtohet si fenomen dhe disiplina e pilotit në ajër. Adrenalina që të afron fluturimi shpesh ka sjellë aksident ajror, rastet nuk kanë munguar. Edhe njeriu "gjigand" i viteve 60-te i botes, Y. Gagarin, ka qene pilot ne avionin Mig-15. Edhe pse ai çuditi boten me fluturimin e tij jashte planetit toke, ai u kthye pas ketij misioni per te fluturuar me avionin reaktiv Mig 15. Do te ishte ky avion që i mori jetën atij qe kaloi tro/stratosferen mars 1968 në një fluturim rutine për forcat ajrore Ruse. Gjatë pilotimit avioni

ra ne tyrjele vertikale dhe mori flake. Avioni u dogj dhe piloti nuk mundi te shpetonte edhe pse pilotohej nga ai, kozmanauti qe perloti boten me suksesin e tij. Sjell si kuriozitet se për t'u diplomuar pilotë, studentët shqiptarë kanë bërë më shumë se 500 fluturime po në këtë tip avioni Mig 15 duke bërë akrobaci ajrore nga më të vështira por aksidente ajrore me marrje jete nuk kemi patur....

Historisë së aviacionit nuk i kanë munguar dhe raste krenarie të bujshme si kalimi në harkun e monumentit «Arc de Triomphe» që ndodhet në Champs Elysées të Parisit me datë 7 Gusht 1919. Ishte ora 7-30 kur piloti francez Charles Godefroy do të bënte aventurën më të papritur të kohës duke pilotuar

avionin «Nieuport» në brendësi të monumentit. Kalimi i avionit ishte një shënjë pakënaqësie duke protestuar për mos marrjen pjesë të aviacionit në paradën e festës Kombëtare të Francës që u zhvillua më 14 Korrik 1919. Ky fluturim spektakolare i këtij piloti u fotografua dhe u filmua nga ata që e organizuan këtë fluturim, ose dhe nga ata që u ndodhen në këtë shesh, por fotot dhe vidio u ndaluan të shikohen për shumë vite. Ndodh dhe kështu, si ulja në "sheshin e kuq" Moske, e shumë të tjera si kjo aventurë të sajuar a të stiruar. Ato bëhen pjesë të profesionit për një situatë të sjelle.... enigmë!

Edhe terroristët kanë gjetur mjetin më efikas "fluturimin" si target sulmi për të terrorizuar botën,

si show për të treguar forcën dhe për të mbjellë panik. Ata detyruan njerëzimin që para se të ngrihen në ajër të "falen" para portave të kontrollit si kujtesë, ne jemi pranë jush në fluturim. "Zoqtë e ajrit" goditën fortesën e sigurisë, Pentagonin dhe bënë të shkërmoqen kullat Binjake të mbrojtura nga flota ajrore më e fuqishme e botës. Ngjarje shkaktoi jo aq në ushtri, sesa në politikën e sigurisë të vendit dhe rajonale një «avion Piper» në Divjakë apo një «drone» në Beograd. Moria e problemeve që lindin nga "fluturimi" tregojnë se sa shumë liberal dhe i ndërlikuar është sistemi i rregullave të fluturimeve. Ndaj sjell informacionin tashmë i përforcuar në të gjitha rrethet e instituteve "think tank" se e ardhmja e zhvillimeve, qofshin këto krize (emergjence) apo luftarake, parashikon angazhimin rreth 80% me mjete fluturuese dhe vetëm 20 % me mjete tokësore e detare.

Përtej çfarë analizuar si të mundshme dhe ndodhi, të bujshme në fluturim, nevoja për mjetin fluturues për njerëzimin është madhore. Ashtu siç pranojmë që fluturimi është "atdheu" i çudirave, statistikisht fluturimi është "atdheu" i sigurisë. Propabiliteti i sigurisë në ajër (avionët pasagjerë) është disa herë më i madh se ai tokësore. Aksidentet ajrore kanë gjerësi të bujshme mediatike, ndaj, në dukje ato sjellin panik për fluturimin.

*Përsa i përket Helikopterit EC 145 është një nga më modern helikopter të kohës. Kompania Eurocopter me kooperim shumë shtetesh si Franca, Gjermania, Anglia etj. ka prodhuar mjete fluturuese konkurruese, luftarak dhe civil të besueshme për pilotim. Testet në ajër kryhen nga instruktorët pilotë kolaudator të uzinës. Në rastin tone ka vijuar përgatitja e pilotave në territorin tonë po me instruktore francezë. Ajo që duhet patur në vëmendje është fakti se ky helikopter modern kërkon mirembajtje dhe teknike pilotimi –perfekt, preçis. Ne i kemi kapacitetet për ta pilotuar dhe mirëmbajtur atë.

Duke mos marrë përsipër të analizojë se çfarë është thënë në



lidhje me aksidentin, pasi asgjë nuk mund të thuhet kur nuk ka prova dhe fakte për të, do doja thjesht të komentoja debatin mbi aftësinë e pilotave, trajnimin e tyre për t'u përshtatur me teknikën e re dhe fluturimi në hapësirën ujore (liqen). Sipas meje, çdo pilot që çertifikohet si i tillë, lehtësisht ambientohet me tabelën e instrumentave. Piloti është një nxënës i përhershëm. Të ambientohesh me kabinën e avionit dhe të fluturosh mbi liqen, këto janë elementë fill-estare, pa vlerë diskutimi. Zbatimi rigoroz i instruksionit të fluturimit mbetet madhor. Pilotët nuk veçohen i mirë apo jo i mirë siç ndodh me profesionet e tjera, të gjithë ata që janë lidhur në sediljen e avionit me rrypat e parashutës ata janë të barabartë dhe të gjithë janë heronj në raste aksidentesh. Pilotët shqiptarë kanë fluturuar ne avione supersonik të përgatitur nga pilotët shqiptarë me 10-20 ore fluturimi në vit duke kryer detyra shumë here me të vështira se sa misione në avionët civile dhe helikoptere. Nuk kemi patur fatin të trajnohemi as me instruktore amerikane, franceze dhe gjermane por me ata shqiptarë. Ne kemi instruktorë të mirë pilot, ata janë konkurrenca edhe me homologët e tyre.

Zgjidhje deri diku e sukseshme për botën aeronautike, në konfuz-

itetin që të sjell fluturimi, është kutia e zeze si një "spiune" për punën e motorrit, pozicionin e mjetit ajror në ajër (komandat drejtuese për pilotim) dhe komunikimin pilot-pilot dhe pilot- toke. Kamera vëzhguese në kabinën e helikopterit nuk mund të zëvendësojë kutinë e zezë.

Për aksidentin në proces vlerësimi, le të presim fjalën e ekspertizës. Në se do të ishin në bordin e helikopterit oficerë: nga nentoger deri në general këmbësor/marinar si dhe fizikantë, matematicienë apo inxhinierë, as njeri prej tyre nuk mund të jap informacionin e duhur se çfarë ka ndodhur realisht por një informacion rutinë. Ndaj shpesh thuhet: në aksidentet ajrore, edhe në shtetet me aviacion elitare ku pilotët kanë humbur jetën, ka vlerësime apo konkluzione edhe relative, "gabim njerëzor". Shpresoj që ekspertiza të nxjerrë të vërtetën.

Në këtë përvjetor të aviacionit, përshëndes shokët e mi, ata të cilët morën rrugën drejt qiellit, të detyruar nga varfëria e asaj kohe, të kryenin detyrat po në atë standard me homologët e botës së "F-ve, dhe Mirage-ve" me 10-20 orë fluturimi në vit. Të huajt janë befashuar me përkushtimin e pilotave tanë duke i vlerësuar këto fluturime "fluturim-arkivol". Ky është fluturimi... mall dhe respekt për ju të ajrit, për thinjat tuaja të arta.

Ngjarje dhe data të Aviacionit Ushtarak Shqiptar

Pilotët e parë shqiptarë i ngjanin Ikarit, që u ngjitën në qiell përmes krahëve të rremë të ngjitura me dyll. Historia mitologjike e Ikarit dhe babait të tij Dedalit është një histori përlotëse, kur ata mbritën me fluturim në Kretë.

Nënkolonel FIGALI GOLEMI
Dega e BCU-së
Komanda e Forcës Ajrore

Shtëpia e pilotëve ushtarakë ka qenë në qiell, në hapësirën qiellore shqiptare. Ata jetonin midis qiellit dhe tokës dhe shkruan një epike sukcesi në gjashtë dekada e gjysëm. Ata e "pushtuan" qiellin 65 vjet më parë. Pilotët e parë shqiptarë i ngjanin Ikarit, që u ngjitën në qiell përmes krahëve të rremë të ngjitura me dyll. Historia mitologjike e Ikarit dhe babait të tij Dedalit është një histori përlotëse, kur ata mbritën me fluturim në Kretë. Për të shpëtuar nga mbreti dinak kretas Minosi. Ata ndërtuan me pendë shqiponje dy palë krahë, për vete dhe për të birin. At e bir fluturonin si shqiponja qiellit. Por Ikari harroi këshillën e babait ju afrua diellit dhe krahët e ngjitur prej dylli shkrijnë dhe bien në det. Hidhërimi i Dedalit ishte i papërshtueshëm, derdhja e lotëve nuk arriti t'i shëronte plagën e humbjes së djalit të vetëm, edhe pse vazhdoi të ndërtonte godina të mrekullueshme zemrën e kishte

te pushtuar nga dhembja. "Makinat" e ajrit të pilotëve ushtarakë kanë qenë krenaria shqiptare e armës së dashur të aviacionit luftarak shqiptar.

Fluturimi në qiellin shqiptar nuk ishte një ëndërr, por një realitet, nuk ishte as aventurë, as çmenduri, as e pamundur. Ajo ishte sfida e shekullit e pilotëve ushtarakë rojtarë të qiellit shqiptarë, që e kthyen fluturimin mbi tokën arbërore një mision gjithmonë të mundur. Pistat e avionëve, bazat e fluturimit, Rinasi, Kuçova, Gjadri, Vlora, Farka u kthyen për pilotë dhe teknikë shtëpia e njerëzve me zemra e mendje tek hapësira qiellore shqiptare. "Përbindshat" e ajrit "zgonin" Shqipërinë në dimër dhe në verë, në të gjitha stinët e vitit, përshëndesnin me mënyrën e vet qytete dhe fshatra të atdheut në misionin qiellor të përjetësisë. Gjurmet ushtarake në kaltërsi u "shkruan" nga pilotët tanë të talentuar që "çanë" qiejt e kaltër shqiptar fillimisht me një avion me helikë AN-2, dhe më tej me 160 supersonikë shqiptarë "MIG-15, MIG-17PF, MIG-19, MIG-21", nga rreth 240 avionë e helikopterë luftarakë që dispononte Shqipëria, që 65 vite të historisë së suksesit të saj. Avionë





rusë nga uzinat ruse Mikoyan-Gurevic, në kuadër të Traktatit të Varshavës si dhe më vonë avionë kinezë të prodhuar nga Uzina kineze "Shenyang", të pilotuar nga pilotët ushtarakë shqiptarë "pushtuan" qiellin shqiptar. Djersë dhe krenari, gjak dhe dinjitet, sakrificë dhe fisnikëri si dhe kontribut të jashtëzakonshëm në të katër anët e Atdheut janë vetë jeta e pilotëve ushtarakë shqiptarë. Për gjashtë dekada e gjysëm, që nga viti 1948, njësitë kundërajrore shqiptare dhe aviacioni ushtarak ajror kanë arritur nëntë triumfe me fitore kundër avionëve të huaj mbi hapësirën shqiptare pa pësuar humbje. Ky fakt flet për aftësitë operacionale dhe gatishmërinë e lartë të pilotëve të FASH. Korpusi ajror i fluturimit në gjashtë dekada e gjysëm përbëhej nga rreth 1300 pilotë e teknikë si dhe rreth 2000 ushtarakë e civilë staf mbështetës. Në tetor 2005, para 11 vitesh urdhëri i Ministrit të Mbrojtjes, i "burgosi" përfundimisht avionët luftarakë, MIG. Shqipëria u bë vend i parë i rajonit, i cili deklaroi heqjen e avionëve luftarakë reaktivë nga përdorimi. Rojtarët e hapësirës ajrore shqiptare sakrifikan në dekada 47 dëshmorë, të cilët ranë për atdheun, për misionin dhe detyrën, për ruajtjen e hapësirës ajrore shqiptare, për dinjitetin krenarinë dhe sovranitetin tonë kombëtar.

KRONOLOGJI E FAKTEVE HISTORIKE NGA ARMA E AVIACIONIT

- **28.5.1945.** Dy javë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, nga Shqipëria dërgohet grupi i parë të oficerëve me 24 veta në Jugosllavi që të studionim për pilot: Babaçe Faiku, Vasil Trasha, Peço Polena, Thanas Gjijnuri, Herakli Gazhdani, Masar Aga, Edip Ohri etj. Fillimisht u përzgjedhën për pilotim, 95 vetë për të vazhduar shkollën, por u seleksionuan për arsye, shëndetësore dhe politike.
- **13.11.1945.** Një kontingjent prej dhjetë ushtarakësh, dërgohen për të vazhduar studimet në ish-Bashkimin Sovjetik.
- **14.02.1947.** Krijohet kompania e VAIN-it për

vrojtimin e Hapësirës Ajrore dhe informimin për objektet e zbuluara në hapësirën shqiptare.

- **Korrik 1947.** Humb jetën në një katastrofë ajrore ndërsa po jepte provimin praktik për pilot Ibush Vokshi në afërsi të Lubjanës në Slloveni. Eshtrat e tij janë në Slloveni.

- **Viti 1947.** Grupi i kursantëve që studionte për pilot në qytetin Pançevo, të Beogradit në ish-Jugosllavi, pas prishjes së marrëdhënieve të Shqipërisë me Jugosllavinë u tërhoqën gjithë kursantët dhe i dërguan për studime në Bashkimin Sovjetik në qytetin Engels, për bombardues strategjik tip "Turbolev". Por meqenëse Shqipërisë nuk i duheshin avionë të tillë, i ndër-

pre në studimet dhe i çuan në qytetin Çakallov për avionë gjuajtës dhe më vonë për avionë gjuajtës-kapës të distancave të largëta e kështu na çuan në qytetin Tollmaçov në Siberi, në Shkollën e pilotëve "Flamuri i kuq i punëtorëve të Stalingradit".

- **Gusht 1948** njësitë Kundërajrore të Republikës së Shqipërisë nga Regjimenti kundërajror "Ali Demi", goditën dhe rrëzuan një avion grek të tipit "Spitfire" që kishte shkelur hapësirën ajrore Shqiptare për mision spiunazhi. Avioni Grek u shkatërrua dhe piloti u gjet i vdekur.

- **Gusht 1949.** Njësitë KA të Regjimentit kundërajror goditën dhe rrëzuan një avion tjetër Grek gjatë Provokacioneve të gushtit. Avioni grek, i dëmtuar nga zjarri Kundërajror, u detyrua të ulej në fushë ku u kap nga njësitë luftarake shqiptare. Piloti grek u kap dhe u burgos si rob lufte dhe më vonë u lirua; ndërsa njësitë fluturuese të Forcave Ajrore patën aksionin e parë luftarak të tyre në vitin 1957.

- **Viti 1950.** Me pilotët shqiptarë, në Harkov të Ukrainës, pranë një Divizioni Ajror Sovjetik të Aviacionit Gjuajtës u formua një skuadrilje provizore shqiptare me komandantë katërshe Areteo Ikononi, Peço Polena, Fahri Bubësi.

- **24.4.1951.** Kryhet fluturimi i parë me avion shqiptar nga Petraç Polena. Në bazën ajrore të Laprakës kishte 12 avionë gjuajtës rus tip "JAK-9P" të Luftës II Botërore.

- **1.5.1951.** Shtatë ditë pasi ishte krijuar reparti i avionëve të Laprakës, 5 avionë lufte me helikë të këtij reparti kaluan mbi bulevardin "Dëshmorët e Kombit" për të bërë paradë përpara popullit, ndërkohë që në Tiranë nuk kishte asnjë taksì. Pilotët që fluturuan bashkë mbi Tiranë: Babaçe Faiku, Peço Polena, Masar Aga, Vasil Trasha dhe Thanas Gjijnuri.

- **12.10.1951.** Piloti Qemal Mërtiri 22-vjeçar nga Tragjasi i Vlorës humb jetën në një aksident ajror në Novosibirsk të ish-Bashkimit Sovjetik. Pas 3 vjet studimesh në shkollën e Aviacionit në periferi të No-

vosimbirskut, më 12 tetor 1951 avioni i tij kaloi në një pozicion të vështirë, ra në turjelë apo shtogër, që është një figurë në fluturim, ku avioni bëhet i pakomandueshëm, dhe pësoi katastrofë ajrore në periferi të Novosimbirskut.

- **Korrik 1954.** Edhe në Shqipëri vjen "era" e aviacionit reaktiv, ku pilotët me perspektivë u dërguan në aerodromin e Groznit, në Bashkimin Sovjetik, për të përvetësuar avionin luftarak, MIG-15 BIS, i cili ishte i pajisur me një motor reaktiv. Po dilte në skenë një teknikë e re ajrore, aeroplanë me një teknologji më të avancuar. Në Grozni u dërguan 11 pilotë për studime, për kualifikimin për të pilotuar avionët reaktivë MIG-15 si: Niko Hoxha, Edip Ohri, Fari Bubësi, Peço Polena, Haki Jupasi, Vasil Trasha, Masar Aga etj. Ata studiuin dhe fluturuan, plot 9 muaj në aerodromin e Groznit (BS), deri sa përvetësuan tipin e ri të avionit, Mig-15 BIS. Kontingjenti i parë i avionëve të këtij tipi erdhi në vendin tonë, në muajin shkurt të vitit 1955, me anijen sovjetike "Obi". Avionët u montuan në Laprakë.

- **15.05.1955.** Riorganizohet për herë të parë reparti i mirëfilltë i aviacionit ushtarak me avionë reaktive MIG-15, të cilët janë shpikur në vitin 1945 pas Luftës së Dytë Botërore, pra, 10 vjet pasi ishin shpikur këta avionë, në vendin tonë u krijuar një repart avionësh ushtarakë shqiptar shumë të përparuar për kohën. Rinasi i vitit 1955 e ka Kodin Ndërkombëtar: TIA/LATI. Këtu e kishte pikënisjen e madhe Regjimenti i Parë i Aviacionit Reaktiv Shqiptar me ardhjen avionëve sulmues-bombardues të prodhimit rus, MIG-15, dhe jo krejt rastësisht po kjo ditë shënoi krijimin e regjimentit të parë të Aviacionit Luftarak të Kuçovës me avionët me numër indeksi "4" dhe i pagëzuar fillimisht me emrin Regjimenti "23 Peza". Ky aeroport ushtarak me përmasat 2840 x 67 m, ndodhej 64 kilometra në jug të Tiranës, duke u njohur me kodin ndërkombëtar LAKV. I pari që fluturoi me avionin MIG-15 do të ishte piloti Niko Hoxha, busti i së cilit ndodhet edhe sot në Bazën Ajrore të Rinasit. Ai do të zgjidhej edhe komandanti i parë i kësaj baze ushtarake ajrore. Në pak kohë do të sillej një skuadrilje MIG-17 dhe dy skuadrilje MIG-19, tepër moderne për atë kohë në misionin e tyre, "Për ruajtjen e sovranitetit ajror të Republikës së Shqipërisë". Me kalimin e kohës, Regjimenti i Rinasit u kompletua edhe me një avion bombardues të tipit IL-28, i cili gjendet sot i mbuluar me mushama në hambarin e hapur, pranë tri avionëve AN-2 "Colt" me helikë. Rinasi u kompletua më pas me tre skuadrilje MIG-19 dhe katër avionë luftarako-mësimorë.

- **Viti 1955.** Krijohet aviacioni i transportit brenda strukturës së aviacionit ushtarak me një repart i quajtur "Skuadrilja", ndërkohë që Shqipëria nuk kishte aviacioni civil të emërtuar si të tillë, por kishte reparte,

të cilat ishin në shërbim të aeroportit civil. Në këtë repart kishte 12 avionë transporti 10 vendësh. Ata shërbenin për operacione luftarake, për transport desantësh, ndërsa një pjesë ishin përshtatur për punët e Ministrisë së Bujqësisë në spërkatjen e ullishtave, të agrumeve të Rivierës etj. Gjithashtu 4 avionë transporti dy motorësh, njëzet vendësh, njëri prej të cilëve quhej "Qeveritari", ishte për udhëheqjen e lartë të shtetit, ndërsa të tjerët shërbyen gjerësisht për realizimin e fotografimit ajror të gjithë vendit dhe përpunimin shkencor të tij. Arma e aviacionit kishte fillimisht 23 avionë MIG-15 "Fagot". Avioni MIG-15, i quajtur ndryshe "Traktorët e MIG"-ëve, ishin të parat tipa sulmues-bombardues që hynë në shërbim të Forcave Ajrore Shqiptare në vitet '60. Avionët "MIG-15UTI", "Midget" do të trajnonin pilotët shqiptarë të Shkollës së Aviacionit, me dy versionet, 11 copë "Shenyard FT-2 "Fagot/Midget" si dhe 13 copë stërvitorë "Shenyard F-2/MIG-15bis "Fagot". Avioni luftarak "MIG-15" ishte një prej avionëve, i cili provoi mundësinë e hapësirës së luftimit në mënyrë eficiente



në Luftën e Koresë. Këto tipa avionësh janë ulur në fushën e Pish-Poros në Vlorë në një pistë prej dheu me kushte të papërshtatshme.

- **Korrik 1956.** U dërguan në ish-Bashkimin Sovjetik pilotë për t'u trajnuar si pilotë helikopteri.

- **Viti 1956.** Fillon përgatitja luftarake mbi bazën e një planizimi të rregullt si dhe krijohet ofiqina e mirëmbajtjes me komandant Daut Gurabardhi. Gjithë zhvillimet ushtarake ajrore shqiptare për kohën bazoheshin tek eksperiencia e shkollës për avionë reaktivë në Volsk, qarku Saratov në Vollgë, që në fakt ishte shkolla e parë e aviacionit që ishte hapur në Bashkimin Sovjetik që në vitin 1932.

- **23.5.1957.** Studenti për pilot Fuat Alim Sulajnga fshati Brataj Vlorë, në shkollën e Aviacionit "Shkallov", vdiq në stërvitje të trupës studentore të Shkollës së Aviacionit rus. Ai është përcillë në varrezat e qytetit

të Borisoglebskut me ceremonial ushtarak dhe me pjesëmarrje të gjerë të gjithë shkollës së aviacionit në ish-Bashkimin Sovjetik si dhe shumë qytetarë të Borisoglebskut. Është në proces të shpalljes "Dëshmor i Atdheut". Eshtrat e tij janë akoma në ish-Bashkimin Sovjetik.

- **Viti 1957.** Në aerodromin e Rinasit u ul për herë të parë avioni bombardues IL-28 dhe një avion transporti anglez "Skaimaster". Bombarduesi i parë IL-28 erdhi nga Shau Lai, një Bazë e Aviacionit të Marinës, pranë Rigës në Letoni. Ai erdhi në Shqipëri me pilotë dhe ekuipazh të plotë rus, me pilot Ivan Bobiçei, një pilot me famë jo vetën në Bashkimin Sovjetik, por në gjithë vendet e lindjes, anëtare të Traktatit të Varshavës. Navigator ishte Viktor Kanfman dhe teknik-specialist Viktor Lubjeznov. Në Shqipëri drejtimi i Bombarduesit IL-28 ju besua pilotit të talentuari Bajram Hitaj nga Kuçi i Vlorës, që e drejtoi për 10 vite këtë avion luftarak, derisa erdhi nga Republika e Kinës një bombardues luftarak tjetër.

- **Viti 1957.** -IL-28H-5 ishte një bombardues i vetëm shqiptar harbin, një avion i mesëm me ekuipazh prej tre vetash, një pilot, navigator/ bombardues/mitralier, dhe mitralieri i seksionit fundor. IL-28 fluturonte me shpejtësi maksimale 900 km/orë, distancë maksimale fluturimi 2180km, lartësi maksimale operative 12400m dhe ishte i aftë të dërgonte 3000 kg peshë luftarake sëbashku me dy çifte topash Nudelman NR-23 (hunde dhe bisht). Shërbeu 30 vjet deri në vitin 1997 për stërvitjen e reparteve të Mbrojtjes Kundër Ajrore. Avioni luante rolin e sulmuesit armik i cili vinte nga cdo anë e horizontit. Nga prapa tërhiqte një "kon" aerodinamik të varur në një kavo çeliku, 250 m nga bishti. Avioni kryente sulme të rreme duke u futur në pikën imagjinare të zjarrit kundërajror. Bateritë kundërajrore të të gjitha kalibrave reagonin me shpejtësi duke u përpjekur të asgjësojnë objektin armik (konin).

- **Viti 1957.** Erdhën helikopterët e parë që u montuan në Shqipëri dhe përsëri Petraq Polena kreu fluturimin e parë me helikopter në itinerarin Tiranë-Shkodër-Tiranë.

- **23.12.1957.** Një avion luftarak amerikan i tipit "T-33" shkeli hapësirën ajrore Shqiptare. Dy avionë të tipit MiG-15 u ngritën nga baza ajrore e Kuçovës, të pilotuar nga Anastas Ngjela dhe Mahmut Hysa. Avioni u rrethua dhe u detyrua të ulet në pistën e pambaruar të aeroportit të Rinasit. Avioni u sekuestrua dhe piloti u kap rob dhe më 11.01.1958 u la i lirë, ndërsa avioni u vendos në muzeun e historik kombëtar të armëve në hyrje të kështjellës së Gjirokastrës.

- **31.12.1957.** Radaret roje dhe postat e vrojtimit pamor, zbuluan një avion transporti i tipit "DC-7" i "Independent Air Travel" që po fluturonte nga Gjermania drejt Singaporit, që kishte shkelur hapsirën tonë ajrore. Menjehere u ngrit në ajër çifti i avionëve roje MiG-15. Në sherbim luftarak roje ishte Kosta Dede dhe Mahmud Hysa. Pilotët tanë iu afruan shkelësit ajror, e futën në mes, iu afruan kabinës së tij dhe i bënë thirrje të ulej në aerodromin



Piloti Hazbi Serani, një nga 47 herojt e Aviacionit Shqiptar, rënë në krye të detyrës

e Kuçovës. Piloti i avionit anglez nuk u bind, vazhdoi fluturimin drejte jugut. Piloti Kosta Dede, hapi zjarr paralajmëruar me dy breshëri drejtë avionit shkelës. Pas kësaj, pilotet e avionit anglez të frikësuar morën kursin drejtë Kuçovës të shoqëruar nga dy avionet tanë dhe u ulën në aerodrom. Pilotët deklaruan se ishin nisur për në Indonezi, për të tërhequr qytetarët anglez, pasi atje kishin nisur trazirat. Ekuipazhi prej 6 vetesh dhe avioni u lanë të lirë për në destinacion në Indonezi, më 4.1.1958 mbasi u vendos që ishte vetëm një gabim navigacioni.

- **14.07.1958.** Studenti për pilot Islam Myrteza Xhani nga Kajca, Përmet, ndërkohë që ishte në shkollën e Aviacionit "Shkallov", vdiq në një demonstrim studentor pranë lumit Verona të Shkollës së Aviacionit dhe përcillet me ceremonial ushtarak dhe vijon të prehet në varrezat e qytetit të Borisoglebskut. Është në proces të shpalljes "Dëshmor i Atdheut".

- **31.12.1958.** Avion i huaj "C-54D "Skymaster"" u kap nga avionët reaktivë të bazës së Kuçovës. Ishte një avion që përdorej nga CIA për të transportuar armë në Indonezi. Avioni u detyrua të ulej në bazën e Kuçovës, dhe më pas pilotët dhe avioni u liruan për t'u kthyer në Angli.

- **Viti 1959.** Sapo kishte dalë në përdorim avioni supersonik MIG-19, një avion modern për kohën dhe Bashkimi Sovjetik donte t'ia jepte Evropës Lindore, pilotët shqiptarë nga testimi i zhvilluar vërtetuan se ishin në gjendje ta meritonin marrjen e tij në Shqipëri, ashtu si dhe pilotët e vendeve të tjera lindore. Shq-

ipëria ishte e dyta nga demokracitë lindore që u pajis me këtë avion, në bazë të aftësive të pilotit.

- **Korrik 1959.** Erdhi një skuadrilje me avionë të tipit superpersonike MIG-19 PM, në Shqipëri. MIG do të thotë dy germat të para të konstruktorit rus, Migojan Gregioviç. Nga Avionët MIG janë avionët MIG -15, me të cilët fillon seria e prodhimit dhe përdorimit të MIG-ëve. Nisen pilotë dhe specialistë të tjerë për në ish-Bashkimin Sovjetik për avionët e tipave superpersonikë, MIG-19 PM, një avion interceptues për kapjen e objekteve ajrore në të gjitha kushtet meteorologjike, ndërsa do të kryenin qitje luftarake në poligonet ushtarake të Turmenistanit dhe Astrohan në qarkun e Stalingradit. Në dispozicion të Forcave ajrore shqiptare vjen edhe një skuadrilje me avionë MIG-17.

- **Viti 1961.** Uzina e Kuçovës prodhoi për herë të parë vajgur special "TS1", ndërsa në mesin e shkurtit 1962 do të vinin në pistën e Rinasit e njohur me kodin LATI me përmasat 2750 x 45 m, regjimenti i tretë i avionëve gjuajtës-bombardues.

- **11.5.1962.** doli Dekreti nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, ku u vendos hapja zyrtare e Shkollës së Lartë Ushtarake të Aviacionit, ku filloi përgatitja e pilotëve dhe teknikëve të avionëve, si dhe teknikë për radio, armatim e paisje elektrike të aviacionit. Fillimisht, përgatitja bëhej me program dy vjeçar dhe pas vitit 1972 programet e shkollës u bënë tre vjeçare, për t'ju përgjigjur më mirë kërkesave në rritje të armës së aviacionit. Shkolla e Aviacionit në Vlorë, me numër avion-indeksi "5", duke u dislokuar avionët reaktivë MIG-15, UTI MIG (avioni MIG-15 dyvendësh që shërbente për trajnim) si dhe dy skuadrilje me avionë me helikë JAK-18, të cilat do të shërbenin për përgatitjen e pilotëve në vitin e parë të kualifikimit. Avioni me helikë "Jakovlev", apo "Jak-18", u përdor për trajnimin fillestar të pilotëve shqiptarë. U prodhua nga uzinat ruse në 1945. Kishte një gjatësi trupore prej 8 metra e 530 cm dhe lartësi 3 metra e 350 cm. Hapja e krahëve të tij ishte 10 metra e 60 cm, ndërsa kishte një peshë prej 1316 kg. Shpejtësia e tyre mund të shkonte deri në 260 km/orë.

- **Në vitet 60,** dy avionë të Forcave Ajrore Italiane të tipit F-84 "Thunderjet" u ulën në bazën ajrore të Rinasit në rrethana të panjohura dhe pas bisedimesh me autoritetet në rrugë diplomatike u lanë të lirë.

- **21.03.1963.** Bie në krye të detyrës piloti Sokrat Gori Basha pilot reaktiv i përgatitur në ish-Bashkimin Sovjetik. Kryente detyrën e komandantit të ekuipazhit në Regjimentin e Rinasit. Ra në krye të detyrës më ndërsa kryente fluturime natën në rajonin Prezë-Krujë gjatë përgatitjes për të marrë një klasë më të lartë fluturimi. Me vendimin të Këshillit të Ministrave Nr.

258, datë 22.04.1996 është shpallur "Dëshmor i Atdheut". Prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Lushnjë.

- **29.11.1964.** Parada më e madhe e aviacionit, ku parakaloi tërë parku i aeroplanëve shqiptarë duke kaluar në të njëjtën kohë nëpër qiellin mbi sheshin "Skënderbej", fluturuan bombarduesi i vetëm që kishte Shqipëria, IL-28 e pilotit të shquar Bajram Hida, e shoqëronin 12 avionë MIG-15 të ardhur nga Kuçova, 12 avionë MIG-19, të Rinasit të drejtuar nga piloti Lulo Musai dhe 11 avionë MIG-17 të drejtuar në ajër nga Niko Hoxha.

- **Viti 1964.** Krijohet batalioni i shërbimit të aerodromit, Grupi i Radio-Dritës.

- **20.11.1965.** në aerodromin ushtarak të Rinasit, në një stërvitje luftarake, me aeroplan reaktiv MIG-17 F, përpara efektivëve të regjimentit dhe disa kadrove ushtarakë akademistë ra në krye të detyrës koloneli i aviacionit Niko Hoxha, ai edhe komandant i Regjimentit të Rinasit.



Në shkollën sovjetike në qytetin e Borisoglebsit ish Bashkimi Sovjetik. Këtu mori krahë endrra e tyre e shkëlqyer me talentin e tyre si pilotë profesionistë

- **Viti 1966.** Filluan punimet për ndërtimin e Uzinës së Riparimit të Avionëve në Kuçovë dhe Baza ushtarake ajrore e Kuçovës ose Regjimenti "Peza" me Kod Ndërkombëtar "LAKC" pajiset me një skuadrilje MIG-17.

- **Viti 1967.** Ngrihet struktura e Regjimentit të Helikopterëve të Farkës me 36 helikopterë të rinj tip "MI-4" të marra nga Republika e Kinës, të cilët kanë bërë rreth 50 mijë operacione në ndihmë të popullsisë nga ana e këtij regjimenti, në ndihmë të popullsisë në bllokimet nga dëbora, në dëmet e shkaktuara nga tërmetet, emergjencat etj.

- **Viti 1967.** Pilotit të ri Bilal Sina në lartësi 6000 m i fiket motori, por në sajë të veprimeve të sakta arrin të ulë avionin. Presidiumi i Kuvendit Popullor e dekoroi me urdhrin e "Flamurit" të klasit të parë. U

eksperimentua ulja në aerodromin e Cërrikut nga pilotët Viktor Vangjeli, Qirjako Dhima e Azbi Serani.

• **21.07.1967.** Një incident i rëndë ndodhi mbi hapësirën ajrore shqiptare, ku një avion jugosllav i tipit F-84 "Thunderjet", i armatosur me rraketa të padërtuara dhe bomba, shkeli hapësirën ajrore të Shqipërisë në afërsi të Dibrës duke fluturuar në drejtimin Peshkopi-Martanesh-Tiranë. Avioni jugosllav me numër regjistrimi 17 ishte i dislokuar në aerodromin ushtarak të Zemunit, rreth 15-20 km në veri-perëndim



Nga e majta në të djathtë: Azis Alola, Delo Isufi, Isa Arapi, Flamur Pupa, Petrit Bebeci. Poshte: Dhimitraq Vasho dhe Vangjel Koroveshi, student në Akademinë e Aviacionit Vlorë-foto e vitit 1964

të Beogradit. Avioni pilotohej nga Boidar Vojevic dhe detyra e tij ishte të fluturonte për në aerodromin ushtarak të Kumanovës, Maqedoni, ku do të merrte pjesë në stërvitje. Shërbimet e radarit nuk arritën të diktonin shkeljen e hapësirës ajrore të Shqipërisë për shkak se avioni jugosllav fluturonte ulët duke ndjekur relievin. Avioni u diktua vetëm kur ai iu afrua bazës së Forcave Ajrore në Rinas. Pilotë të gatshëm ishin Koço Biku dhe Roland Sofroni. Tre avionë reaktivë të tipit MiG-19, të komanduar nga pilotët Koço Biku, Mahmut Hysa dhe Gëzdar Veipi, u ngriten nga baza ajrore e Rinasit për të interceptuar avioni jugosllav. Avioni Jugosllav u rrethua dhe u detyrua të ulej në aerodromin e Rinasit. Mbas uljes piloti jugosllav deklaroi dhe ai kishte humbur orientimin gjatë fluturimit. Avioni dhe piloti u kthyen në Jugosllavi mbas një marrëveshjeje mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

• **Viti 1968.** Piloti Qirjako Dhima kreu kontrollin teknik të avionit MIG-15 pas riparimit kapital nga uzina. Ulen në Korçë avionët MIG-17 nga Azbi Serjani, Qirjako Dhima, Hamza Koçi e Harilla Rebi.

• **Viti 1968.** Në Kucovë për mirembajtjen e avionëve ndërtohet uzina e Riparimit të Avioneve, e cila u be edhe shtylla kryesore e shërbimit të avioneve. Uzina arriti të prodhojë me sukses pjesë këmbimi sikundër edhe të bënte riparime të avionëve luftarakë të tipave:

Mig 15, Mig 17, Mig 19, Mig 21.

• **Shtator 1968.** 12 pilotë shqiptarë që pilotonin avionët supersonic MIG-19, u përzgjedhën për të shkuar në Kinë, që të bënim kalimin në avionin MiG-21. 12 pilotët që kaluam në tipin e ri ishin: A. Ngjela, M. Hysa, G. Veipi, B. Josa, S. Shegani, S. Toli, Dh. Zhezha, A. Daci, K. Biku, P. Bebeci, V. Koroveshi, B. Lubonja. B. Hita, K. Selmani ishin pilotë të IL-28.

• **Viti 1969.** Erdhën 12 avionët kinezë supersonikë "MIG-21/F-7A "Fishbed" me një motor, që ishte dhe krenaria e aviacionit shqiptarë. "MIG-21/F-7A "Fishbed", ishin pjesë e 11.000 copëve të prodhuara gjithsej, ishte i tipit "gjuajtës-kapës të shpejtësive dhe lartësive të mëdha". Ai ishte avion që e kalon dy herë shpejtësinë e zërit dhe udhëton me 2250 km në orë, udhëton në lartësi në 20 - 21 mijë metra është i shquar, për faktin se është kapës i lartësive të mëdha, ka në armatim dy raketa të drejtuara shumë efikase. Kostua ishte 18 milionë dollarë. Forcat Ajrore Shqiptare kanë në "konservim" vetëm 11 copë MIG-21, të këtij avioni që u njoh ndryshe si Krahu i Hekurtit i Luftës së Ftohtë, dhe që shërbeu për shumë vite në ish-"Soviet Air Force". Licenca e prodhimit nga uzina Mikoyan-Gurevic u kopjua nga kinezët që e sollën në vendin tonë në vitin 1970 duke i vënë prapashtesën "Shenyang F-7A".

• **Viti 1969.** U nis për në Republikën Popullore të Kinës një grup pilotësh e teknikësh shqiptarë, të cilët do të përgatiteshin për avionin MIG-21. Deri në vitin 1976 vazhdoi përgatitja e shumë grupeve të tjera për avionët MIG-19 në Republikën Popullore të Kinës. Pas këtij viti përgatitja e pilotëve për avionin MIG-19 bëhej në reparte, pasi Akademia Forcave Ajrore, nxirrte pilotë vetëm për avionët MIG-15.

• **Viti 1969.** Eksperimentohet intensiteti maksimal i një katërsheje në një ditë fluturimi.

• **Në vitet 70.** Një avion i vogël civil Grek u kap mbi Vlorë nga një MiG-15. Ai u detyrua të ulej në pistën ajrore të Vlorës, ku piloti shtetas grek, u arrestua dhe më pas u la i lirë.

• **Viti 1971.** Shkolla e Aviacionit u emërtua "Shkolla e Lartë e Aviacionit" me vendimin e Këshillit të Mbrotjtjes.

• **31.1.1971 deri 9.2.1971.** Alen Shepard një kozmonaut me origjinë shqiptare i lindur në SHBA nga një emigrant shqiptar, fluturoi nga Amerika në Hënë me "Apollo 14", dhe me lejen e autoriteteve amerikane vendosur një flamur shqiptar në hënë.

• **Viti 1971.** Një avion Bombardues i lehtë Rus IL-28, u ndërrua në 1971 me një version të njëjtë Kinez bombardues "Harbin H-5".

• **Vitet 1971-1976.** Avioni MIG-21 fluturoi nga Rinas, ndërsa duke filluar nga 18-19 maj 1976 u

ribazua në Bazën Ajrore të Gjadrit ku fluturoi deri në fillim të viteve 2000.

- **29.11.1974.** Janë 27 avionë reaktivë luftarakë, që kanë fluturuar mbi bulevardin "Dëshmorët e Kombit".

- **27.02.1974.** U krijua Baza Ajrore e Gjadrit me numër indeksi "8", tërësisht e tunelizuar. Kalimi i specialistëve nga njëra bazë tek tjetra u bë shkallë-shkallë, kurse tre skuadriljet e MIG-ëve u sistemuan në shtëpinë e tyre të re në vitin 1976 nëpërmjet transferimit nga ajri, ku bënë pjesë 12-të avionët MIG-21, 24 copë MIG-19 si dhe 10 avionë të tjerë mësimorë. Në këtë mënyrë, Baza Ajrore e Gjadrit do të numëronte gjithsej 46 avionë luftarakë reaktivë të armatosura me predha mitralozësh, topash 30 dhe 37 mm, predha raketore të padrejtuara 57 mm si dhe raketa të vetëdrejtuara me rreze infra të kuqe apo bomba të peshave 50, 100 dhe 250 kilogramëshe, çka përbënin një forcë tejet të konsiderueshme të kohës.

- **15.03.1974.** Hapet zyrtarisht Baza e Gjadrit, pranë fshatit Zadrimë me Kod Ndërkombëtar LAGJ. Avioni i parë ishte ulur këtu më 10.7.1973. Kjo bazë ishte "shtëpia" e avionëve MIG-21 dhe MiG-19, e Regjimentit të ri 5646 të Gjuatesve ku kishte fillimisht një skuadrilje me gjuajtesin F-6/MiG-19S; dhe në Maj 1976, në bazë arritje gjashtë trainues të avancuar FT-5 (një version kinez dyvendesh i ardhur nga MiG-17) dhe pak kohë më vonë një Skuadrilje F-7A/MiG-21F-13. Baza kishte një tuneli rreth 600 metra në formë 'U' që strehonte afër 50 avionë sëbashku me personelin. Më 16.10.1976 një skuadrilje F-6 mbërriti në Gjadër e ardhur nga Kuçova.

- **Viti 1975.** Piloti Vangjel Llazari eksperimenton qitje natën me raketa.

- **Shtator 1976.** Zhvillohen qitje me raketa e topa natën.

- **1976.** Plani ishte që Shqipëria të pajisej me tre avionë IL-28 por deri në prishjen e marrëdhënieve me Kinën vetëm një prej avionëve ishte lëvruar. Dy të tjerët mbërritën deri në portin e Durrësit por nuk u dorëzuan në duart e Ministrisë së Mbrojtjes Shqiptare sepse u prishën marrëdhëniet me Kinën dhe avionët bombardues IL-28 u kthyen mbrapsht.

- **Viti 1977.** Eksperimentohet bombardimi nga fluturimi horizontal në lartësi të vogël. Për herë të parë organizohen kapje në agim. Në procesin e uljes me avionin MIG-19 piloti Skënder Demollari, avionit nuk i hapet rrota e majtë, por piloti me gjakftohtësi e guxim kryen uljen në brezin jeshil.

- **Viti 1980.** U prodhua banko-prova për kontrollin e topave 30 m/m si dhe pajisja për kontrollin e frenimit automatik të rrotave.

- **Viti 1981.** Kinostudio "Shqipëria e Re" xhiroi filmin artistic "Gjurmë në kaltërsi", kushtuar armës së Aviacionit, ku kontribuan edhe pilotët Harilla Rebi, Viktor Vangjeli, Agim Balili, Gjergji Spaho etj, duke kryer një sasi të madhe fluturimesh në funksion të filmit, si dhe duke organizuar e ndihmuar edhe në punët e tjera.

- **Viti 1982.** Avioni ushtarak shqiptar i tipit MiG-21,

F-13 gabimisht shkeli hapësirën ajrore Jugosllave gjatë një stërvitjeje. Avioni Shqiptar, i pilotuar nga Luto Sadikaj, u kap nga 2 avionë Jugosllavë të tipit MiG-21; u rrethua dhe u detyrua të ulej në një aerodrom në Kosovë. Por piloti Shqiptar, në momentin kur avioni bëri kontakt me pistën e aerodromit, e futi në forsazh avionin dhe u ngrit përsëri, duke lënë prapa dy avionët Jugosllavë që tashmë kishin hapur parashutat e frenimit. Luto Sadikaj iu drejtua Shqipërisë me shpejtësi të madhe dhe u kthye në atdhe. Fatkeqësisht, Luto Sadikaj u shua në një aksident me po të njëjtin avion në vitin 1982.

- **Viti 1983.** U eksperimentua ngritja nga pista urgjente nga Harilla Rebi e Gjergji Spaho.

- **Viti 1985.** Nga pilotët Epaminonda Tupa dhe Koço Biku u krye prova e motorit të parë të avionit MIG-15 të riparuar në Shqipëri. Një pilot vjen me rrota të mbyllura në ulje, prek lehtë pistën dhe ngrihet përsëri. Reparti dekorohet me urdhrin "Për shërbime të shquara në fushën e mbrojtjes".

- **1989.** Pilotit Syrja Gjoka gjatë fluturimit me Mig-19, i fiken motorët në ajër, bën rilëshimin e tyre dhe ulet me sukses në tokë duke shmangur me gjakftohtësi rrezikun.

- **Viti 1989.** Pilotit Idajet Veleshta gjatë fluturimit me avion MIG-19 i bien xhirot e një motori, e konstaton atë në kohë dhe ulet me sukses në tokë. Pilotët dekorohen nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.

- **22.11.1989.** Ka ndodhur tragjedia ajrore e rrezimit të dy helikopterëve Mi-4, në Vuno dhe në Llogora, ku humbën jetën 23 vetë, një tragjedi që Tirana e përcolli me dhembje të madhe. Ishte një thirrje e dashurisë për jetën më shumë se një aventurë e etur për heroizma, ku pilotë ishin komandanti Vangjel Postoli, piloti Tafil Agaj, tekniku Pandeli Xhumba, dhe helikopteri tjetër drejtuar nga komandanti Agron Galanxhi, piloti Veledin Resuli dhe tekniku, Enver Haka. Në bordin e tyre kishin edhe ekipin e mjekëve të spitalit nr. 2 në Tiranë: Agim Garri, Kujtim Hysi, Dionis Makuçi, Zana Floqi dhe ndihmësmjekja Dhurata Leka. Sot, të gjithë helikopterët janë prodhime perëndimorë, të dhuruara dhe të blea nga shtetet mike aleate në NATO.

- **Viti 1990.** Shqipëria kishte 200 avionë dhe 40 helikopterë, si dhe 14 avionë transportues IL14. Shtatë avionë MIG u shkatërruan gjatë vitit 1997, ndërkohë, që avionët e Luftës së Ftohtë "MIG", quheshin makina luftarake ajrore.

- **1992 e në vijim.** Studentët për pilot u dërguan jashtë vendit në Akademitë e Italisë, Turqisë, Greqisë, SHBA-së, Gjermanisë, Francës dhe Anglisë.

- **Viti 1992.** Shkolla e Lartë e Aviacionit u emërtua "Akademia e Forcave Ajrore".

- **Vitet 1990 – 1994.** Baza ajrore ka dy skuadrilje me Komandant Petrit Dashi dhe Ylli Bullari, ndërsa grupi inxhinero – teknik komandohej nga Ylber Harshova.

- **Viti 1996.** Një grup teknikësh shkojnë për specializime në Turqi dhe disa pilotë shkojnë në Itali. U zhvilluan qitjet bombardimet e rezultatet ishin shumë të mira.

- **Viti 1998.** Pas shkatërrimeve të vitit 1997, u



Në vitin 1971 në Kuçovë: Agim Balili, Kristaq Burda, Azis Alla, Pëllumb Bebri, Zenel Shini, grupi që vitin 1971 ka shkuar në Kinë për specializim

ringritën Bazat ushtarake ajrore.

- **Viti 2001.** Në strukturën e re organizative të Forcave Ajrore realizohet kalimi në Akademinë e Forcave Ajrore, duke pasur në vartësi dhe Fakultetin Teoriko-Mësimor Vlorë.

- **Vitet 2002-2005.** Vazhdojnë punimet nga pala turke në Aerodromin e Kuçovës. Misioni kryesor në këto vite: ruajtja e aftësive profesionale për t'iu përgjigjur situatave të veçanta në operacione ushtarake, humanitare e të kërkim- shpëtimit dhe mbështetja. Ja ata që komanduan Regjimentin e Kuçovës në këto 50 vite Niko Hoxha, Fahri Bubësi, Bardhyl Taçi, Vasil Andoni, Harilla Rebi, Agim Balili, Fatmir Meçe, Agim Matraku, Gëzim Ismaili, Epaminonda Tupa, Andon Todri.

- **Viti 1999.** Shënon rikthim në normalitet të plotët të të gjitha bazave ushtarake ajrore të vendit.

- **Viti 2001.** me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, në strukturën e re organizative të Forcave Ajrore, ky Baza e Kuçovës kalon në Akademia e Forcave Ajrore, duke pasur në vartësi dhe Fakultetin Teoriko-Mësimor Vlorë.

- **Prill 2001.** Vijnë në Shqipëri helikopterët e parë të tipit AB-206.

- **Viti 2003.** Vazhduan punimet nga pala turke në aerodromin e Kuçovës, të cilat përfunduan në kohë sipas planit. Në vitet në vazhdim si detyrë kryesore ka qenë modernizimi i infrastrukturës për plotësimin e standardeve dhe kushteve të aerodromit të Kuçovës si Host Nation Support Komandant i Bazës Ajrore Kuçovë është nënkolonel Balil Hyseni.

- 26.11.2003. U kompletua në Bazën e Farkës një skuadrilje me helikopterë tip: "AB-206".

- **24.04.2004.** Vjen në Bazën ushtarake Ajrore Farkë helikopteri i parë AB-205.

- **Viti 2004.** Bie në krye të detyrës dëshmor i Forcës Ajrore piloti Jani Tarifa me "MIG-19".

- **Viti 2005.** Me urdhër të posaçëm të Ministrit të Mbrojtjes Pandeli Majko hiqen nga përdorimi avionët e tipit "MIG" reaktiv, që shënon kthimin e Forcave

ajrore vetëm me helikopterë.

- **Viti 2005.** Akademia e Forcave Ajrore mori emrin Shkolla e Trupës së Forcave Ajrore.

- **16.07.2006.** Ora 02.17. Bien në krye të detyrës në Detin Adriatik me Helikopterin "Bell 222", Vangjel Kiço Çondi, Qemal Koni dhe Demush Heba.

- **1.2.2007.** Vjen në Shqipëri helikopteri për transport VIP, "A-109".

- **18.6.2007.** Vijnë në Shqipëri helikopterët e parë "BO-105".

- **Viti 2008.** Shkolla e Trupës së Forcave Ajrore kaloi në varësi të KDS.

- **Dhjetor 2010.** Ministria e Mbrojtjes planifikoi shitjen e rreth 40 avionë kinezë dhe sovjetikë luftarakë të Shqipërisë dhe ofertat nisin nga 8600 dollarë. Fakt është se një MIG-19 me dy motorë konsumonte 52 litra karburant në minutë, ku në atë periudhë një pilot i

diplomuar në akademinë e Vlorës fluturonte rreth 80 orë në vit. MIG-ët ishin kryesisht avionët që dikur zhurmonin qiejt shqiptarë. Një pjesë e pilotave ushtarakë shqiptarë kanë rregjistruar nga 700 deri në 1000 orë në ajër dhe rreth 2200 deri 2500 fluturime.

- **28.7.2012.** Vjen në Shqipëri helikopteri EC-145, i versionit VIP.

- **26.7.2012.** Vjen helikopteri parë shumëfunksional "Cougar" dhe hyn në organikëtë FA.

- **Nëntor 2012.** Për herë të parë me rastin e 100 vjetorit të krijimit të Forcave të Armatosura u ngrit Muzeu Ushtarak kombëtar, ku nga 40 helikoptere që kishte Regjimenti i helikopterave me nr reparti 3780 i Farkës, i perbere nga 3 skuadrilje, u perzgjodh helikopteri "MI-4", me nr. anësor 6-54, helikopter që përfaqësohet në Muzeun Ushtarak.

- **25.4.2013.** Vjen helikopteri i dytë shumëfunksional tip "Cougar" nga Franca.

- **18.12.2013.** Vjen helikopteri i tretë shumëfunksional tip "Cougar".

- **27.10.2014.** Është futur në përdorim të Forcës Ajrore helikopteri i katërt tip "Cougar".

- **31.10.2015.** Hyjnë në përdorim në FA duke ardhur nga Franca dy helikopterë "EC-145". Gjithë zhvillimi dhe progresi është dhe ëndërra e ish-pilotave ushtarakë që shkrinë jetën e tyre në shërbim të armës së tyre të dashur aviacionit ushtarak.

- **6.4.2016.** Ranë në krye të detyrës kapiten Florian Jahja Delia dhe togër Donald Visar Hoxha në rajonin Grizhë, Malësi Madhe në Liqenin e Shkodrës me Helikopter të tipit "EC 145", që i përkiste Bazës Ushtarake Ajrore Farkë. Me Vendim të Komisionit Qendror të Statusit "Dëshmor i Atdheut" Nr.705 dhe 706 datë 6.4.2016, janë shpallur "Dëshmorë të Atdheut".

- **25.4.2016,** në Bazën Ushtarake Ajrore Kuçovë u zhvillua ceremoniali i 65 vjetorit të krijimit të Armës së Aviacionit.

Zhvillohet stërvitja e përbashkët “Vlora SAREX 16”

“Forca jonë Detare duhet të kualifikohet më tej që në çdo situatë rreziku të përgjigjet me efikasitet”

Forca Detare në bashkëpunim me institucionet që kanë interesa në det zhvilluan më 27 prill 2016 në Gjirin e Vlorës stërvitjen e përbashkët “Vlora SAREX 16”, me pjesmarrjen e personelit dhe mjeteve detare të Flotiljes Detare Pashaliman {FDP} dhe institucioneve detare që veprojnë në qarkun e Vlorës.. Efektivët, pjesëmarrës në këtë stërvitje, simuluan parandalimin e trafikut të qenieve njerëzore dhe ndalimin e trafikantëve dhe mjeteve të tyre në zonën e përgjegjesisë, si dhe simuluan një operacion kërkim-shpëtimi për mjete që mund pësojnë avari gjatë lundrimit. Stërvitja u zhvillua në zbatim të matricës kryesore të veprimtarive të Flotiljes Detare Pashaliman, si dhe planit vjetor të stërvitjeve në FDP.

Qëllimi i stërvitjes “VLORA SAREX 16” ishte rritja e mëtejshme e kapaciteteve Operacionale të shtabeve, reparteve e mjeteve detare gjatë procesit të planëzimit dhe ekzekutimit të Operacioneve të Kërkim Shpëtimit (SAR) në bashkëpunim me institucionet e tjera që kanë interesa në det. Për mëse një orë efektivat e Grupeve Patrulluese, konkretisht Anijet “ORIKU P-132” “BUTRINTI P-134”, bashkë me gomonet e tyre, nga një anije e klasit “Drini” dhe “Bora”, dy mjete detare të shpejta nga Njësia e Lëvizshme Territoriale e Kufirit dhe Migacionit (Forca Delta) dhe një mjet detar i Drejtorisë Rajonale të Kufirit & Migracionit (Policia Kufitare), demonstruan veprime të shpejta e profesionale në kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe zbatimit të ligjshmërisë Detare.

Duke folur në lidhje me stërvitjen



“Vlora SAREX 16”, zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi, e konsideroi mjaft të rëndësishme kualifikimin dhe gatishmërinë e detarëve tanë. “Forca jonë Detare duhet të kualifikohet më tej. Duhet të jetë gjithmonë e gatshme që në çdo situatë rreziku të përgjigjet me efikasitet. Ne e dimë tashmë që situata në rajon mund të sjellë edhe në hapësirën tonë detare, pse jo dhe në territorin tokësor, kalime refugjatësh apo mund të ketë siç ka pasur dhe më parë, zhvillime të tjera që kanë lidhje me veprimtarinë ilegale në hapësirën detare. Kjo kërkon patjetër stërvitje të vazhdueshme dhe natyrisht koordinim me institucionet e tjera që kanë interesa në det sepse Forca jonë Detare nuk është e vetmja forcë apo institucion që ka përgjegjësi për hapësirën detare.”-tha ai.

Interesit të mediave për sigurinë

e hapësirës detare në përgjithësi dhe Gjirit të Vlorës në veçanti, z. Koçi tha se ato janë të menaxhuara dhe të kontrolluara. “Kjo është një hapësirë që për Forcën tonë Detare krijon gjithmonë prezencë të vazhdueshme. Ne kemi personel të stërvitur, të kualifikuar, kështu që padyshim që çdo lloj situatë do t'i përgjigjemi me nivelin që e kërkon ligji.” Stërvitjen ndërinstucionale “Vlora SAREX 16” e ndoqi nga afër shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo, i cili përgëzoi efektivat pjesmarrës të kësaj stërvitje për përmbushjen me sukses të objektivave e synimeve të caktuara. Kryetari i Bashkisë Vlorë, z. Dritan Leli, Zv/Komandanti i Forcës Detare, Kapiteni i Rangut të I-rë, Adnand Agastra, etj.

Shefqet Kecelli



“West Point” hap dyert për dy kosovarë

Ato janë midis 15 të përzgjedhurve, nga 95 aplikantë të 29 shteteve

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) u mbajt ditën e martë, datë 3 maj 2016, ceremonia e dorëzimit të Certifikatave të pranimit për studime në Akademinë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës “West Point”, të dy kadetëve të FSK-së, Arelena Shala dhe Ylli Dalladaku. Më këtë rast, Ministri Haki Demolli tha se lajmi për pranimin e dy kadetëve të FSK-së në Akademinë ushtarake “West Poin”, është një prej ngjarjeve më të mira dhe shumë të rëndësishme për FSK-në dhe Ministrinë për FSK, sepse siç tha ministri Demolli bëhet fjalë për shkollimin dhe ngritjen profesionale të dy kuadrove tona në një akademi ushtarake me traditë të gjatë.

Ministri Demolli, gjatë cer-

emonisë tha gjithashtu se: “Ministria për FSK, dhe Qeveria e Kosovës falënderojnë ShBA-në për përkrahje gjithëpërfshirëse që në vazhdimësi po i ofrojnë Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë në të gjitha sferat e mundshme, që nga trajnimet, arsimimi dhe shkollimi, donacionet në pajisje dhe financa, këshillimeve profesionale e deri të stërvitjet e përbashkëta”. “Ne, kemi kadet në 6 shtete të ndryshme; Mbretëri të Bashkuar, Turqi, Gjermani, Kroaci, Maqedoni, dhe tani në SHBA”, tha komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rrahman Rama.

Nga ana e tij, Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Kosovës, Greg Delavi tha se “sot ka nderin e madh që është pjesë e historisë së Kosovës”. Më tej Ambasadori Delavi

tha: “Dëshiroj ti përgëzoj kadetët Arelena Shala dhe Ylli Dalladaku për pranimin me sukses në Akademinë Ushtarake në Shtetet e Bashkuara, për gjeneratën e vitit 2020”. Ambasadori Delavi tha gjithashtu se pranimi në Akademinë “West Point” është një privilegj i rezervuar vetëm për studentët më të mirë dhe më premtues, Arelena dhe Ylli kanë garuar me kandidatët e 29 shteteve të tjera, më 95 aplikant, dhe janë në mesin e 15 të përzgjedhurve nga ndërkombëtarët që do të studiojnë në “West Point”.

Kadetët, Arelena Shala dhe Ylli Dalladaku janë kadetët e parë të Forcës së Sigurisë së Kosovës që kanë konkurruar dhe janë pranuar në Akademinë Ushtarake Amerikane “West Point”.

Këshilltari i NATO-s Samo Smolej mbaron mandatin

Ministri i FSK, zoti Haki Demolli priti 29 prill 2016 këshilltarin e NAT-it, nënkolonelin Samo Smolej në vizitë lamtumirëse, i cili qëndroi për 6 muaj në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës në cilësinë e Ekipit Këshillues të NATO-s për MFSK. Ministri Demolli e falënderoi nënkolonelin Smolej për kontributin e tij të veçantë në FSK dhe për bashkëpunimin e tij të shkëlqyer me të gjitha departamentet në MFSK, e në veçanti për punën e palodhur në Departamentin e Operativës dhe Trajnimeve në të cilin ka shërbyer gjatë këtyre muajve. Me këtë rast, ministri Demolli në shenjë mirënjohje dhe respekti i dha një letër –falënderimi këshilltarit të NAT-it, kolonelit Smolej.



Garda Nacionale Aiovo, 5 milion USD për MFSK-vës

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli ka raportuar më 29 prill 2016, para Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, për punën dhe të arriturat e FSK-së, e në veçanti për vizitën zyrtare që pati së bashku me komandantin e FSK-së, generallejtënant Rrahman Ramën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA).

Ministri Demolli fillimisht i njoftoi deputet e Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të FSK-së, për takimet e delegacionit të FSK-së, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si në Pentagon, në Vashington, në shtetin e Aiovës së SHBA-ve, etj. Patëm takime zyrtare me personalite të larta shtetërore dhe ushtarake të SHBA-ve. Takime zhvilluam edhe me shefin e Gardës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës gjeneralin Frank Grass, me gjenerallejtënant Keneth Mekenzi Shef i J-5 (Drejtor për Politika dhe Planifikimet Strategjike) të Komandës së Bashkuar të Ushtrisë së SHBA-ve, me Guvernerin e shtetit Aiova, Terry Branstad, komandantin e Gardës Kombëtare të Aiovës, gjeneral Timothy Orr etj.

Minsitri Demolli vlerësoi se një nga takimet kryesore ishte ai me shefin e Gardës Kombëtare të shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjeneralin Frank Grass. Ai në këtë takim e kishte njoftuar gjeneralin Grass mbi



mbarëvajtjen e procesit të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për hapat, përgatitjet që janë bërë si dhe për planet për zhvillimin e saj. Gjithashtu, Demolli informoi edhe për takimet e tij me shefin e Gardës Kombëtare të Aiovës, si dhe me gjeneralin, Timothy Orr.

Ndër temat kryesore në takime ishin ato të zhvillimit të FSK-së. Demolli, ndërkaq, e njoftoi komisionin për vizionet kryesore të Ministrisë së FSK-së si, promovimin e stabilitetit në shtet dhe regjion, si dhe gatishmërinë e shtetit të Kosovës të punojë me të gjitha ministritë në regjion. Në vijim ai i njoftoi edhe për ftesën që i ishte bërë FSK-së nga NATO për pjesëmarrjen në ushtrimet të 20 kadetëve, si dhe për trajnimet e organizuara nga NATO për shtetet joanëtare. Demolli theksoi edhe partneritetin e suksesshëm me Gardën Nacionale të Aioves, dhe ndihmën e ndarë për vitin 2016 prej

rreth 5 milion dollarë nga SHBA-të për Ministrinë e FSK-së. Si suksesë të lartë, Demolli vlerësoi pranimin e dy kadetëve për shkollim në West Point. Ndërkaq, e informoi komisionin edhe për procesin e transformimit të FSK-së në FAK, për Projektligjin e përgatitur dhe amendamentet. Ai theksoi se janë bërë të gjitha përgatitjet nga ana e Ministrisë së tij, duke pohuar se pritet vetëm vendimi politik. Gjithashtu, ai i përmendi parametrat e procesit të transformimit, si: periudha (rreth dhjete vite), rritja e personelit, buxheti që përcjell procesin e transformimit, infrastruktura dhe procesi i trajnimit. Në fund, Demolli theksoi edhe vlerësimet nga ana e partnerëve amerikanë për bashkëpunimin shumë pozitiv, intensifikim të bashkëpunimit, dhe përkrahje nga ana e tyre në të gjitha proceset e Ministrisë së FSK-së.

Kroacia mbështet Maqedoninë në rrugën drejt NATO-s

Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë, Zoran Jolevski në kuadër të vizitës në Republikën e Kroacisë u takua me homologun kroat, Josip Buljeviq. Gjatë takimit ministri Jolevski theksoi se Maqedonia ka plotësuar kriteret për anëtarësim në NATO para Samitit të Bukureshtit në vitin 2008 dhe se Maqedonia meriton të bëhet pjesë e Aleancës. Dy ministrat ishin të një mendimi se integrimi i Maqedonisë, Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Malit të Zi është tepër i rëndësishëm për stabilitetin dhe prosperitetin e rajonit, por edhe të Evropës. Në takim gjithashtu u bisedua lidhur me lobimin e përbashkët nga vendet e A5 para Samitit të NATO-s në Varshavë. Kroacia është mbështetëse e fuqishme e Republikës së Maqedonisë dhe do të vazhdojë të jetë edhe në të



ardhmen. Gjatë vizitës në Republikën e Kroacisë ministri Jolevski u takua edhe me Presidenten e Republikës së Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitarović. Gjatë këtij takimi Jolevski theksoi se Republika e Maqedonisë qëndron fuqishëm prapa prioriteteve të saja të larta, e këto janë anëtarësimi në NATO dhe BE, dhe se integrimi i vendeve të rajonit do të kontribuojë në një situatë më stabile të sigurisë në Ballkan dhe më gjerë

misht do të mbështesë fuqishëm aspiratat Euro-Atlantike të Maqedonisë. „Maqedonia me aktivitetet e saja gjatë përbashkës me krizën e emigrantëve dëshmoi se është një vend që meriton anëtarësimin në NATO dhe se është një partner në të cilin mund të mbështeten Evropa dhe vendet e Rajonit”, tha presidentja e Kroacisë. Ministri Jolevski informoi lidhur me aktivitetet të cilat planifikohen deri në Samitin e NATO-s.

në Evropë. Presidentja e Kroacisë Kitarović shprehu kënaqësi për nivelin dhe intensitetin e bashkëpunimit me Maqedoninë dhe theksoi se Kroacia do të vazhdojë të mbështesë Maqedoninë në rrugën drejt BE-së dhe NATO-s. U theksua se Kroacia vazdhi-

“**J**u ushtarë bullgarë, ju drejtua me 5 prill 2016, z.Nikolai Nençev, ministër i Mbrojtjes i Bullgarisë, trupave në nisje për Afganistan, jeni pasues krenarë të sukseseve të ushtrisë së lavdishme bullgare. Ju mbron vlerat e paqes, sigurisë dhe lirisë në misionet dhe operacionet në disa kontinente dhe lavdinë e Bullgarisë në botë”. Kjo tha ministri i Mbrojtjes, Nikolai Nençev në fjalimin e tij në prani të kontingjentit të 31 të Forcave të Armatosura që u nisën për të marrë pjesë në misionin ndërkombëtar të NATO-s për trajnim, këshillim dhe ndihmë në Afganistan. Ceremonia solemne e dërgimit të kontingjentit bullgar u mbajt më, 5 prill në Karlovo. “Pjesëmarrja e kontingjenteve nga ushtria bullgare

Kontingjenti i 31-të i FA bullgare për mision në Afganistan

në misionet dhe operacionet jashtë vendit është provë se jemi të denjë dhe të përgjegjshme në përmbushje të angazhimeve të saj si një aleat të NATO-s dhe anëtare e Bashkimit Evropian”, tha ministri i Mbrojtjes.

Ai e përgëzoi komandantin e parë grua e një togë për të ruajtur përbërjen e misionit ndërkombëtar në Afganistan - lejtant Slavena Zhelyazkova e 61-të të mekanizuar Brigadës Stryamska. Ministri Nençev dorëzoi komandantin kombëtare të kontingjentit

31, Colonel Rusi Rusev icon “St. George” dhe dëshironte ushtarët të kthehen në shtëpi të sigurt dhe të shëndoshë. Ceremonia u ndoq nga Zëvendës Shefi i Mbrojtjes Gjeneral Major Plamen Atanasov, Komandant i Forcës së Komandës së Gjeneral Major Lupço Todorov dhe komandantin e forcave tokësore, Major General Andrew Botsev kryetarja e Karlovos Dr. Emil Kabaivanov. Lutje për shëndetin dhe suksesin u kremtua nga Hirësia e Tij Mitropolitit Nikollës e Plovdivit.



Franca rrit buxhetin e mbrojtjes kombëtare

Presidenti i Francës Hollande mbledhi të mërkurën, më 6 prill 2016, Këshillin e Sigurisë Kombëtare në të cilin u vendos rritja e buxhetit dhe trupave të mbrojtjes në 3 vitet e ardhshëm, me qëllim goditjen e terrorizmit. Në deklaratën për shtyp pas mbledhjes theksohet se pas sulmeve terroriste të nëntorit të kaluar, Këshilli i Sigurisë Kombëtare vendosi shtimin e 800 trupave të mbrojtjes në periudhën 2017-2019, duke e çuar në 10 mijë numrin e përgjithshëm të tyre. Shtesa në trupat e mbrojtjes do të forcojë luftën kundër terrorizmit kibernetik, thuhet në deklaratë. Pas sulmeve terroriste të 13 nëntorit të vitit të kaluar në Paris, ku humbën jetën dhe u plagosën shumë qytetarë, situata e emergjencës në vend është e lartë dhe është forcuar goditja e organizatave terroriste brenda dhe jashtë vendit.

Bullgari: 500 milionë euro për modernizimin e ushtrisë

Në mbledhjen e vet të rregullt javore, Qeveria bullgare miratoi tre projekte për blerjen e armëve të reja, vlera e të cilëve është 1 miliardë leva/500 milionë euro. Bëhet fjalë për blerjen e avionëve luftarak dhe për dy anije patrullimi, si dhe për sigurimin e afatit të fluturimit të gjuajtësve ekzistues rus MiG-29. Me realizimin e projekteve do të rriten aftësitë operative të Ushtrisë bullgare dhe do të kryen një pjesë nga angazhimet e ndërmarra ndaj mbrojtjes kolektive të NATO-s, komenton zyra e shtypit qeveritar.

Duke pasur parasysh mjedisin e ndërlikuar për siguri dhe tensionin në rritje në kontekstin e krizës së migra-



cionit dhe aktet terroriste në zemër të Evropës, modernizimi dhe përgatitja e stafit personal të Ushtrisë Bullgare për fitimin e aftësive të të domosdoshme mbrojtëse janë kyçe. Këtë e deklaroi presidenti dhe kryekomandant suprem

Rusi: Eksportet e armëve arrijnë 15 miliardë dollarë

Putin ka thënë se tregu i shitjes së armatimeve ruse është duke u zgjeruar në vendet e Afrikës, Amerikës Latine, Azisë Jugore dhe Lindjes së Mesme. Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ka deklaruar se eksporti i armatimeve gjatë vitit të kaluar ka arritur në 14.5 miliardë dollarë. Në një deklaratë me shkrim nga Kremli zyrtar thuhet se Putin këtë shifër e ka përmendur gjatë një takimi në Komisionin e Bashkëpunimit Tekniko-Ushtarak të vendit i mbledhur në qytetin Nijni Novgorod. Duke cituar se vlera e përgjithshme e eksporteve të armatimeve që nga viti 1992 ka shkuar në 56 miliardë dollarë, Putin ka thënë se vendet të cilat janë në krye të atyre që importojnë armë nga Rusia janë, India, Iraku, Egjipti, Vietnam, Kina dhe Algjeria.



i ushtrisë Bullgare Rosen Plevneliev në ceremoninë rreth dekorimit me një gradë të lartë oficeri të nëpunësve ushtarak bullgar. Presidenti nënvizoi se, jemi të drejtuar përpara mjedisit më të rëndë dhe të paparashikueshëm për siguri që nga fundi i luftës së Dytë botërore.

“Në këtë periudhë kalimtare të mos stabilitetit është e domosdoshme të forcojmë pozitat e veta në Bashkimin Evropian dhe në NATO, të përshtojmë rrugën e integritit dhe të pajtueshmërisë. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të garantojmë interesin kombëtar dhe sigurinë e qytetarëve”, deklaroi Plevneliev.

Evropa në retrospektivë

Grupet fashiste kanë zhvilluar shumë strategji të reja që nga Lufta e Dytë Botërore, por ata praktikisht nuk patën asnjë shans për të fituar kontrollin e qeverive.

MIMOZA GOLIKJA

Lufta e Parë Botërore dhe deprecioni global ekonomik i viteve 1930 destabilizoi gati të gjitha demokracitë liberale në Evropë, madje edhe ato që nuk ishin futur në luftë. Në mes të kësaj pasigurie sociale dhe politike, fashizmi fitoi popullaritet të gjerë në disa vende, por nuk arriti në mënyrë të vazhdueshme për të përmbysur çdo sistem parlamentar jashtë Italisë dhe Gjermanisë. Prapa paraqitjes ushtarake dhe demonstrimit publik që krijuan imazhin zyrtar të regjimeve të reja të Italisë dhe Gjermanisë, qëndronte dekompozimi i liberalizmit të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Grupe të ndryshme të vlerave dhe qëllimeve themeluan "urdhra të reja". Ishte diktatura ajo që u diktua nga lart dhe që nuk u pëlqye nga poshtë. Institucionalisht u praktikua shtypja e të drejtave të qytetarit dhe mos respektimi i tyre.

Ashtu si Benito Musolini (1883-1945), në krye të Italisë dhe Adolf Hitler (1889-1945), Fuhrer në krye të Gjermanisë, trumbetuan se do të ofrojnë forcën mbi dobësinë që

kishte mbizotëruar më parë. Mendimet antidemokratike të paraluftës, pakënaqësitë, elita intelektuale tani u bënë pjesë e një ideologjie popullore e forcës brutale. Musolini dha përkufizimin se "Shteti fashist është vullneti për pushtet dhe dominim". Një mendim si ky tregonte se sa poshtë kishin rënë konsideratat politike evropiane nga parimet liberale të shekullit të tetëmbëdhjetë. Ky zhvillim, kontradikta e tendencave sociale dhe ideologjia popullore e shekullit të nëntëmbëdhjetë, kanë provokuar një koleksion të mahnitshëm të interpretimeve historike. Megjithatë, faktorët kryesor ose kushtet të cilat shpjegojnë fenomenin e ri të diktaturës mund të jenë mbledhur shkurtimisht. Fashizmi përfaqësonte një lëvizje të rëndësishme në një pjesë të vogël të vendeve evropiane. Edhe në ato vende ku fashizmi pati disa suksese më në fund ato dështun dhe kjo shpjegon dështimin e përgjithshëm të fashizmit. Grupet fashiste kanë zhvilluar shumë strategji të reja që nga Lufta e Dytë Botërore, por ata praktikisht nuk patën asnjë shans për të fituar kontrollin e qeverive. Qytetarët në të gjitha vendet shpresojnë për stabilitet politik dhe prosperitet ekonomik



dhe nuk e shohin fashizmin si një mënyrë realiste për arritjen e qëllimeve, madje as edhe në vendet ku tensionet etnike janë të forta. Në shumë vende fashizmi tërhoqi vëmendje të konsiderueshme në raportet e gazetave dhe të radios. Adolf Hitleri u bë kancelar i Gjermanisë në janar 1933 gjë që tregoi se Musolini kishte mbështetjen e një aleati të fuqishëm fashist. Italia pushtoi Etiopinë në tetor 1935 (sipas Itali: Fushata etiopiane) dhe armiqësia ndërkombëtare e pushimit të Italisë çoi Musolinin në krijimin e lidhjeve më të ngushta me Hitlerin. Hitleri dhe Musolini u bënë rivalë dhe aleatë. Fashizmi italian ishte i lidhur fatalisht me planet e guximshme të Hitlerit për të marrë kontrollin e shumë vendeve të Evropës dhe Rusisë. Madje edhe pse fashistët italianë kishin deklaruar se Italia nuk kishte asnjë "problem hebraik", në vitin 1938 qeveria lëshoi papritmas "Nazi style", ligjet anti semite, gjë që tregoi se kjo politikë u vendos përfundimisht kur ata dërguan 8.000 hebrenj italiane drejt vdekjes në kampet e shfarosjes në vjeshtën e vitit 1943.



Idea e një kombi në krizë

Fashizmi kundërshtoi idetë liberale si liria dhe të drejtat individuale, shkatërrimin e zgjedhjeve legjislativat si dhe elemente të tjera të demokracisë. Pavarësisht qëllimeve idealiste të fashizmit, përpjekjet për të ndërtuar shoqëri fashiste i kanë hapur rrugë luftërave dhe përndjekjeve që kanë shkakuar miliona vdekje, nëpërmjet racizmit totalitarizmit dhe dhunës. Referuar Roger D. Griffin B.A, Ph.D. Profesor në Departamentin e Historisë të Universitetit Oxford Brookes, termi "fashizëm" ishte përdorur më parë nga diktatori italian Benito Musolinin në 1919, sipas fjalës "fascio" që në italisht do të thotë "bashkim" ose "ligë". Lëvizjet fashiste u shfaqën në fillim të shekullit të 20-të, në shumicën e vendeve evropiane dhe në disa ish koloni evropiane, si një përgjigje e pasigurisë shoqërore dhe politike të pas Luftës së Parë Botërore (1914-1918) dhe Revolucionit rus të vitit 1917. Por me përjashtim të Italisë dhe Gjermanisë, lëvizjet fashiste dështuan në përpjekjet e tyre për të kapur pushtetin politik.

Në Itali dhe Gjermani pas Luftës së Parë Botërore, fashistët arritën të fitojnë kontrollin e shtetit dhe u përpoqën për të dominuar të gjithë Evropën, duke rezultuar në miliona vdekje të holokaustit dhe Luftës së Dytë Botërore 1939-1945. Për shkak se fashizmi kishte një ndikim vendimtar në historinë evropiane nga fundi i Luftës së Parë Botërore deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, periudha 1918-1945, nganjëherë është quajtur epoka fashiste. Fashizmi u diskretitua gjerësisht pasi Italia dhe Gjermania humbi Luftën e

Dytë Botërore, por vazhdon ende sot në forma të reja. Një lëvizje fashiste pothuajse gjithmonë pohon se vendi përballet me një krizë të thellë. Në periudhën midis Luftës së Parë dhe të Luftës së Dytë Botërore lëvizjet fashiste dhe partitë në gjithë Evropën imituan fashizmin italian dhe nazizmin gjerman. Ultranasionalizmi dhe etnocentrizmi i ideologjive fashiste i bënë të gjitha ato raciste. Që nga viti 1945 shumë organizata me prirje racore fashiste janë frymëzuar nga nazizmi. Këto lëvizje të reja naziste janë referuara si neonaziste, sepse ato modifikojnë doktrinën naziste dhe për shkak se lëvizja origjinale naziste i frymëzon ato. Forma të fashizmit kundërshtojnë fuqishëm emigracionin për të ruajtur pastërtinë e kombit, por nga ana tjetër shumë lëvizje të hershme fashiste kanë kërkuar për të zgjeruar territorin nën kontrollin e tyre dhe disa lëvizje moderne fashiste tentojnë ta marrin këtë pozicion. Nazizmi ishte përgjithësisht

armiqësor ndaj fesë të organizuar dhe qeveria e Hitlerit, arrestoi qindra priftërinj në fund të viteve 1930, por disa lëvizje të tjera të hershme fashiste, u përpoqën për të identifikuar veten me një kishë kombëtare. Në Itali për shembull, fashistët në vitin 1930 u përpoqën për të fituar legjitimitet duke e lidhur veten me Kishën Katolike. Por në të gjitha rastet lëvizjet fashiste kanë hedhur poshtë frymën origjinale të krishterimit duke manifestuar dhunën dhe pastërtinë racore. Në vitet 1990 disa fraksione kombëtare në Bosnje-Hercegovinë të angazhuar në spastrimin etnik, kanë pasur në shënjestër largimin e dhunshëm të grupeve etnike, në qëllim të krijimit të një territori etnikisht të pastër. Në vitin 1999 Insistimi i qeverisë serbe mbi ndjekjen e kësaj politike kundër shqiptarëve etnikë në krahinën e Kosovës çoi në ndërhyrjen ushtarake nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Përpjekjet naziste për të ndërtuar një perandori të re gjermane çoi në vrasjen sistematike të rreth gjashtë milionë civilëve gjatë vitit 1940, dhe vdekjen e miliona të tjerëve si rezultat i pushimit nazist dhe më vonë horrorin e rivalizuar vetem nga sundimi i Josef Stalinit në Bashkimin Sovjetik. Nazistët kryesisht vranë çifutët, por në shënjestër patën edhe homoseksualët, personat me aftësi të kufizuara dhe anëtarët e pakicave fetare.

Nazistët, inkurajim e zhvillim i një teorie të re të gjeopolitikës

Qëndrimet publike u prekën nga problemi në dukje i përgjegjesisë shtypëse personale dhe i lirisë individuale në një botë të pasigurisë ekonomike. Iluminizmi ideal i njeriut të vetëmjaftueshëm, të aftë për të përcaktuar fatin e tij, tani dukej mashtrues, në kundërshtim të plotë me kushtet bashkëkohore sociale dhe ekonomike. Liria rezultonte në një luftë të pakuptimtë jo vetë-

përmirësimi. Për më tepër, individi ishte një viktimitë e shumë pasojave të krijuara nga një ekonomi në masë e prodhimit brenda një rendi shoqëror të përbërë nga masa e popullsisë. Fashizmi dhe nazizmi janë parë dhe kanë fituar popullaritet si mbrojtës kundër kërcënimeve të imponuara komuniste. Të dy Musolini dhe Hitleri e kishin komunizmin kundërshtar të ideologjive të tyre. Për Hitlerin, komunizmi dhe nazizmi konkurronin për sistemet botërore në një betejë të përgjakshme. Sipas tij në fjalën përmbyllëse për tubim të partisë naziste në Nuremberg në shtator 1936, ai tha se "Bolshevizmi ka sulmuar bazat e tërë rendit tonë njerëzor, themelet e konceptit tonë të qytetërimit, të besimit tonë dhe të moralit tonë." Si garantues të rendit dhe sigurisë ekonomike, si mbrojtës kundër kërcënimit të një bolshevizmi të afërt, si mbështetësit e qëllimit të shenjtë kombëtar, Italia fashiste dhe Gjermania naziste ofruan një alternativë për pavendosmërinë e supozuar dhe paefektshmërinë e menjëhershme të demokracisë parlamentare. Kjo alternativë provoi të ishte si false dhe e tmerrshme dhe nuk u kuptua nga shumë prej atyre që i pasuan flamujt e këtyre sistemeve të reja. Historikisht, dy diktatorët janë shtirur si mbështetës të shkëlqyer të traditës dhe pasues të fatit kombëtar. Musolini si kolos stoik i Romës së Re, dhe Hitleri me armaturën e një kalorësi gjermanik. Që të dy i bënë thirrje popullit duke premtuar shpresë të re kombëtare dhe lavdi. Nazistët madje inkurajuan zhvillimin e një teorie të gjeopolitikës, në të cilën Gjermania u konsiderua si zemra e madhe e "ishullit botëror", për këtë arsye është e destinuar që të jetë sundimtari i saj dhe në jug, Musolini me "shkëlqimin perandorak të Romës që kërkonte edhe një herët të bëhej zgjidhja e shkëlqyer e Mesdheut, "deti ynë".



mbikëqyrja e rreptë e edukimit të të rinjve si dhe ngritja e propagandës në një formë të re. Forcat e policisë u përdorën, jo për ruajtjen e rendit publik, por për shkatërrimin e tij. Nëse këto karakteristika të përgjithshme u shfaqën në shkallë e intensitet të ndryshëm në të gjitha vendet ku u vendosën diktaturat në vitet 1920 dhe 1930, ato ishin më të theksuara në Itali dhe Gjermani. Fashizmi italian për disa studjues "prodhoi një "rend të ri" më pak efektiv, më pak represiv dhe rrjedhimisht më pak shkatërrimtar shoqëror se sa nazizmi", si dhe italianët nuk gjeneruan një frymë racizmi si ajo që ishte thellësisht e rëndësishme në ideologjinë dhe praktikën e Gjermanisë naziste. Megjithatë Hitleri kishte deklaruar se Musolini ishte modeli i tij, idhulli i tij në fillimet politike. Musolini ishte i pari që bëri diktaturë të suksesshme në një shtet modern, në shkallë të gjerë evropiane. Duke përfutur nga kriza parlamentare që kishte prekur Italinë në epokën e menjëhershme të pasluftës, krizë që solli zhgënjim dhe papunësi. Ndryshimet e propozuara nga fashistët asnjëherë nuk u realizuan plotësisht dhe rendi i ri ekzistonte në letër shumë më shumë se sa në realitet. Nazizmi në Gjermani ishte i një mënyrë krejt tjetër. Regjimi ishte i pamëshirshëm, efektet e aktiviteteve të tij ishin çnjerëzore dhe shkatërruese. Ky degradim ishte i tmerrshëm. Kundërshtarët politikë, pavarësisht nga përkatësia fetare ose etnike, u torturuan dhe u vranë. Terrori u institucionalizua, dhe shprehja e tmerrshme publike më famëkeqe e "Crystal Night" (nëntor 1938), ishte kur sinagogat çifute dhe dyqanet u sulmuan nga nazistët dhe i dhanë kështu, emrin ngjarjes. Kultura u përbuz barbarisht, që u pasuan me libra të djegur dhe censura të imponuar pa mëshirë dhe krijimi i doktrinës dhe politikave raciste. Në shumë analiza të Evropës, depresioni ishte jo vetëm ekonomik, por edhe psikologjik shoqëria evropiane kishte humbur besimin e saj, situata e brendshme e konfuzionit dhe dëshpërimit që karakterizoi dy breza pas Luftës së Parë Botërore kishte paralele ndërkombëtare.

Prodhimi i "Rendit të ri social"

Ata që kanë vizituar Italinë pas 1922, kur fashistët erdhën në pushtet, kanë treguar që Musolini i kishte drenazhuar kënetat si dhe ndërtesat publike që ai kishte urdhëruar të ndërtoheshin. Edhe ata që kanë vizituar Gjermaninë pas vitit 1933, kur nazistët erdhën në pushtet, kanë komentuar shpesh për pastërtinë e rrugët e qytetit. Shfaqja e pamjes së jashtme e "sistemeve efikase", sipas "urdhrave të reja" komentohej nga kritikët, "trenat janë drejtuar në kohë". Nëse kishte shumë njerëz që ekspozonin këmishat e zeza dhe kafe dhe në qoftë se shahej profili i jashtëm i Duçes të Italisë apo mustaqet e Fyhrerit të Gjermanisë, që u shfaqën me bollëk pa shije fotografike, këto ishin çështjet pa pasoja të mëdha. Edhe Winston Churchill ka vërejtur në mesin e viteve 1920 se "nëse ai do të kishte qenë një italian, do të ishte një fashist". Fillimisht pati një mendim të gjerë popullor se diktatorët do të merrnin atë që merrtonin dhe popujt që vuajtën do të ishin të gjithë më mirë pas sundimit të tyre të shkurtër. E vërteta ishte ndryshe. Opozitarët politikë u vranë ose burgosën, çensura u bë e dukshme, imponimi i të fortit, kontrolli i mendimit dhe

Evropa e pas luftës, dekada e rimëkëmbjes evropiane

Statistikat treguan një histori të përmasave të tmerrshme. Njëzetepesë milionë rusë ishin të pastrehë. Të gjitha qytetet e mëdha gjermane kishin rreth 80 për qind të shtëpive të tyre të shkatërruara gjatë luftës. Gjysma e Francës dhe sistemi hekurudhor i Italisë u

shkatërruan. Anglia kishte përdorur çerekun e investimeve të saj të huaja për të financuar luftën. Zhvendosje e popullsisë gjermane. Katër milion polakë dhe qytetarë sovjetike u zhvendosën në zonat e reja. Miliona të tjerët të emigruar. Në çdo kuptim të fjalës jeta evropiane ishte e pazgjidhur. Por në mënyrë retrospektive mund të shihet se ndryshimet më të rëndësishme nuk erdhën nga shërimi, por nga rindërtimi. Efektet e këqija të luftës u tejkaluan më shpejt dhe mori formë një Evropë e re. Viti i parë i epokës së pasluftës ishte një vit i zyrtë, vit i "të korrave" të këqija, dimër shumë i ftohtë, mungesë e fondeve kapitale dhe një peizazh ende urban i ndërtesave të rrënuara. Termi "shërim" tashmë i përdorur gjerësisht si përshkrues i rendit dukej si një tallje. Viti 1946, si vit i paqes ishte vetëm mungesa e luftës. Megjithatë brenda dy dekadave Evropa do të transformohej dhe do të kthehej në një nga qendrat më të rëndësishme të botës industriale, duke gëzuar një nga standardet më të larta të jetesës, si dhe e pastruar nga plagët më të rënda të luftës. Në vitet 1970 nxënësit gjermanë e dinin se kush ishte Hitleri dhe emri i "Porsche" i lidhur më parë me tanket "Royal Tiger", tashmë u vendos në një nga makinat më të njohura sportive në botë. Zhvillimi ekonomik i kohës së pasluftës është quajtur një "mrekulli", jo për shkak se ajo ka ndodhur në mënyrë misterioze, por për shkak se ajo ndodhi me një shpejtësi të paparashikuar. Mrekullia ekonomike ishte baza për një numër të ndryshimeve të tjera mjaft të dukshme, por krahas përparimit ekonomik ishte zhvillimi i pazakontë social në demografinë e përgjithshme. Popullsia evropiane u rrit në numër në mënyrë që kontinenti i vjetër u bë i ri në aspektin e popullsisë në moshë mesatare. Shumëllojshmëria e aktiviteteve ekonomike, rishpërndarja e pasurisë dhe mobiliteti social karakteristikë e Europës bashkëkohore, kanë ndryshuar dy kushtet dhe perceptimet e strukturës shoqërore. Evropa e ka lënë pas të kaluarën e saj. Ajo ka hyrë në një sistem global politik dhe në një ekonomi globale.



Riorganizimi ekonomik, plani Marshall, dimensionet e reja ekonomike

Të gjithë kritikët pajtohen se ekonomia evropiane jo vetëm që ishte rrënuar nga lufta, por ajo gjithashtu u pengua rëndë prej saj. Pas një serie të kredive emergjente në vitin 1946, Shtetet e Bashkuara hynë në një sipërmarrje të rëndësishme financiare. Në qershor të vitit 1947, gjeneral George Marshall, mbajti një fjalim të pazakontë para studentëve të Harvardit. Ai përdori rastin për të përshkruar një program të ri të ndihmës së huaj për Evropën e shkatërruar nga lufta. I autorizuar nga Kongresi i Shteteve të Bashkuara në vitin 1948, Plani Marshall, dha kredi për shtete të veçanta evropiane dhe derdhi një vlerë 12000000000 \$ të ndihmës në Evropë në periudhën e parë katër vjeçare, që ishte koha dhe hapësira më e rëndësishme, në të cilën u realizua Plani Marshall. Si rezultat i kësaj ndihme financiare, ekonomitë e Europës bënë një përparim të dukshëm, plani ishte ekonomikisht i rëndësishëm pasi ai ndihmoi për stimulimin e tregtisë shumëpalëshe, e cila kishte pësuar rënie në periudhën e Depresionit. Plani Marshall i bëri Shtetet e Bashkuara një faktor kryesor financiar në ekonominë evropiane. Investimet amerikane u rritën me dekadën e dytë të rimëkëmbjes, produktet evropiane filluan të gjejnë një treg të madh në Shtetet e Bashkuara, si dhe ndërmarrja e hapave të tjerë menjëherë pas luftës me qëllim konsultimin dhe bashkëpunimin. Plani Marshall më 1948 lindi nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik Evropian (OEEC), e cila kërkonte rrugët për zgjerimin e bashkëpunimit tregtar, si dhe mjetet më të efektshme për të shfrytëzuar ndihmën amerikane. Hap i madh për të ecur përpara erdhi me shpalljen e Qymyrit dhe Çelikut në Komunitetin Evropian, nga Franca dhe Gjermania e më vonë në bashkimin e shteteve të tjera evropiane. Pra ky ishte dhe guri i themelit për krijimin e Bashkimit Evropian që u vendos nga Ministri i Jashtëm Francez, Robert Schuman, në deklaratën e tij të 9 majit të vitit 1950, në të cilën ai parashtroi idenë e përpunuar më parë me Jean Monnet për bashkimin e industrive evropiane të qymyrit dhe çelikut. Sipas tij, kjo do të përbënte një nismë historike për ndërtimin e një "Evrope të organizuar dhe vitale", pa të cilën paqja në botë do të ishte e pamundur. Plani Schuman u bë realitet me nënshkrimin në Paris të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut më 18 prill të vitit 1951. Instrumenti administrativ i krijuar për të siguruar një treg të lirë apo të përbashkët në kuadër të shteteve pjesëmarrëse për këto mallra bazë ku efikasiteti i zhvillimit dhe shpërndarjes ka qenë koncepti kyç dhe rezultati ishte suksesi. Miratuar nga Traktati i Romës në vitin 1957, Komuniteti Ekonomik Evropian i njohur nën titullin "tregu i përbashkët" zgjeruoi fushëveprimin e integritit ekonomik. Raymond Aron, një nga analistët e njohur francez, shpiku frazën "lapidar kontinental" për të përshkruar superfuqinë e kohës së pasluftës. Në një integrit të tillë ekonomik Evropa eci si një forcë e tretë industriale krahas Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik, duke fituar objektiv politik dhe kulturor atë të sigurimit të vendit, si një Evropë tashmë e ndryshuar.

NË 100 VJETORIN E LINDJES

Elez Braha, hero i luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare



SALI ONUZI

KRONIKA E NJË SESIONI JUBILAR

Më 9 prill 2016 u përkujtua në Kukës 100 vjetori i lindjes së Dëshmorit të Atdheut dhe heroit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, Elez Braha. Në një sesion jubilar studiues lumjan: Isa Halilaj foli për kohën e luftës, si nënkomandant i batalionit “Shqiponja” të Korçës dhe rënien e tij heroike në betejën e Gurit të Kamjes (Sali Onuzi), Shefqet Hoxha referoi për veprën e tij letrare, për poezinë e tij referoi Izet Duraku, kurse për studimin e tij etnografik” Darsma në Lumë” referoi Fejzulla Gjabri. Po atë ditë u bë edhe promovimi i librit “Elez Braha. Vepra”, përgatitur për botim nga profesor. as.dr. Shefqet Hoxha, rreth të cilit foli shkrimtari Petrit Palushi.

Elez Braha lindi në Bice (Bicaj) të Lumës më 9 prill 1916. Pasi mbaroi në vendlindje shkollën fillore, gjimnazin e kreu në Shkodër. Aty ai u njoh dhe u miqësua me Migjenin dhe Qemal Stafën, të cilin e kishte shok klase. Duket se për shkak të lidhjeve me grupin komunist të Shkodrës, e arrestojnë, por e lirojnë për arsye moshe. Është kjo kohë kur ai shkruan poezi e prozë, dhe boton një studim etnografik.

Më 1938-1940 mbaron studimet për itendencë (logjistikë) në Akademinë ushtarake të Modenas (Itali) dhe shërben si oficer në ushtrinë italiane, në Shijak, Jergucat, Tepelenë dhe së fundi në Korçë. Ndërkohë Elez Braha, para 10 korrikut 1943, kish vendosur lidhje me lëvizjen antifashiste nacionalçlirimtare, mes tjerash që në maj 1943 ai kish ardhur në Lumë dhe kish shprehur mendime rreth gjallërimit të Levizjes dhe krijimit të Çetës partizane, (Maket i historikut të LANC në Lumë) kurse në Korçë kish ndihmuar për ngritjen e Spitalit partizan në Voskopojë. Me 5 tetor 1943 emrohet nënkomandant i batalionit “Shqiponja” të Korçës ku bashkë me disa bataliona të tjera ishin baza e krijimit të Brigadës së IV-të Sulmuese më 28 dhjetor 1943. Me 14 dhjetor 1943 vritet duke luftuar në vijën e parë të zjarrit kundër pushtuesve gjermanë dhe bashkëpunëtorëve të tyre në betejën e Gurit të

Kamjes.

Rënien e Elez Brahës e ka dokumentuar për herë të parë, siç dhe i takonte, Komanda e Shtabit të qarkut të Korçës në komunikatën e saj të datës 20 dhjetor



1943. (6 ditë pas rënies së tij). Këtë komunikatë e ka botuar të plotë gazeta "Bashkimi" ("Bashkimi dhe buletinet e tij" v. 2, f. 392-395). Edhe "Zeri i Popullit" në buletin e tij të datës 16 janar 1944 botonte një kronikë të luftimeve të dhjetorit nga qarku i Korçës, mes tyre ato që u bënë në Gurin e Kamjes me 14 dhjetor dhe rënien aty dëshmor "të nënkomandantit trim Elez Braho, duke luftuar në vijën e parë të zjarrit."

Si "Bashkimi" dhe "Zëri i popullit" japin mbiemrin "Braho" për Braha. Por ne jemi të sigurtë se nënkomandanti i batalionit "Shqiponja" është pikërisht lumjani Elez Braha. Këtë e dokumenton më së miri organika e batalionit e hartuar nga mezi i nëntorit 1943, që ruhet në Arkivin e shtetit dhe që në fillim të saj në strukturën "Komanda e batalionit" ka vënë pas komandantit, funksionin e nënkomandantit dhe emrin e tij të saktë: Elez Braha.

Brethanat e rënies:

Në kuadrin e një operacioni të madh që synonte likuidimin e ushtrisë nacionalçlirimtare, pushtuesit gjermanë kishin nisur që në nëntor 1943 sulme kundër batalionit "Reshit Çollaku" të Mokrës, të cilit i kishin shkaktuar jo pak humbje. Fushata e forcave gjermane, "që nuk kish të krahasuar me ato të përdorura më parë prej forcave pushtuese italiane në Shqipëri (M. Kasm) kishte këndellur forcat balliste, sidomos në Pogradec dhe në Korçë të cilat qenë bërë bashkëpunuese me forcat gjermane. Nga mesi i nëntorit forca të shumta gjermano-balliste u hodhën në sulm në zonën e Mokrës, të cilën e përshkuan me zjarr e terror, vranë banorë, dogjën fshatra dhe në Llëngë masakruan 60 burra e gra.

Më 24 nëntor komanda e batalionit "Shqiponja" kish informacion se nga qafa e Thanës në Pogradec kishin hyrë 28 makina me gjermanë dhe se po përgatiteshin për një operacion tjetër në Mokër. (AQSH.f.42.d.5f123)

Për të rivendosur situatën dhe spastruar Gorën e Mokrën nga pushtuesit dhe ballistët, batalioni "Shqiponja", (nënkomandant i të cilit ishte heroi i ynë, Elez Braha), sipas urdhërit të komandës së shtabit të qarkut të Korçës kishte lëvizuar nga Fusha e Korçës (mezi i nëntorit) drejt Voskopojës, ku ishte pajisur disi me municion dhe kishte arritur në Gorë, ku ishte takuar me batalionin "Reshit Çollaku", bashkë me të cilin,

për 4 ditë rresht, kishin thyer sulmet e armikut dhe çliruar Gorën.

Me 10 dhjetor përkrah tyre rreshtohen edhe batalioni "Gorë-Opar" dhe një kompani e batalionit "Fuat Babani". Këto forca u hodhën në mësymje drejt Mokrës dhe afër drekës së 13 dhjetorit zunë Gurin e Kamjes, lartësia dominuese në zonën përrreth (1462 m, 18 km larg Pogradecit).

Të nesërmen në mëngjez, (është dimër dhe malet e kodrat janë veshur me borë) me 14 dhjetor, grupe ushtarësh gjermanë dhe forca të shumta balliste u hodhën në sulm për të zënë me çdo kusht lartësitë e Kamjes. "Kur forcat armike sulmuan dhe gati dolën në qafën e Gurit të Kamjes, luftimet u zhvilluan trup me trup. Dhjetra nazistë dhe tradhëtarë gjetën vdekjen në këtë përleshje të përgjakëshme." (Historia e Luftes ANÇL.V.3 f 497)

Duke zotëruar Gurin e Kamjes dhe lartësitë dominuese djathtas e majtas, grupimi operativ i forcave partizane (Batalioni "Shqiponja" në krahun e djathtë nga Guri i Kamjes në lartësitë e bregut të Prenishtit) rreth orës 14.00 të datës 14 dhjetor, hidhen në sulm për herë të tretë. "Duke zbritur dhe duke u mbrojtur prapa drurëve, partizanët e "Shqiponjës", kaluan me


shpejtësi pyllin, duke e detyruar armikun të tërhiqej prapa. Por kur dolën në vendin me drurë të rrallë, sulmi i mëtejshëm i forcave partizane u ndal përballë zjarrit të pandërprerë të forcave gjermano-balliste." Pikërisht në këtë moment, në sulm vritet Elez Braha, nënkomandant i batalionit "Shqiponja." Në këto luftime u vranë dhe 6 partizanë. Por edhe armikut kjo i kushtoi rreth 50 të vranë e mjaft të plagosur". Mbas mbarimit të luftimeve Elez Braha dhe 6 partizanët e tjerë u varrosën me nderime ushtarake në vendin ku ai ra dëshmor, në Prenisht (Dhimitër Ristani, kujtime).

Pas Çlirimit, aty pranë Gurit të Kamjes u ngrit një lapidar që kujton rënjen heroike të Elez Brahës dhe 6 dëshmorëve të tjerë.

Situata e rënjes dhe data 14 dhjetor, janë dhënë saktë, në komunikatën



Elez Braha - Niko Ceta



e LANÇ-it të Korçës të cilën e botuan në janar 1944 buletinet e "Bashkimit" e të "Zërit të Popullit". Data 20 nëntor që është dhënë në kujtimet e ish komandantit të batalionit ose "tetor nëntor 1943" në kujtimet e ish komisarit të tij, shkruar më 19.04.1971, ("Elez

Braha Vepra, 2016) nuk janë të sakta.


Dokumentet e Arkivit të Shtetit na ndihmojnë të qartësojme këtë moment. Në dosjet e komandës së shtabit të qarkut të Korçës ruhet, edhe një proces-verbal, në të cilin Elez Braha është një nga firmëtarët. Procesverbali është mbajtur me datë 5 dhjetor (9 ditë para rënies së tij, dhe ndofta mund të jetë nga firmat e fundit që ai të ketë hedhur) për marrjen në dorëzim të një sasive municioni luftarak. Firma e Elezit paraqet emrin e tij të plotë dhe është po ajo që njohim nga letrat e tij.

Ngurime për njohjen e statusit të Dëshmorit të LANÇ!

Adem Ballhysa, shok dhe bashkstudent me Elezin në Modena të Italisë, në "disa kujtime nga jeta e shokut Elez Braha", shkruar më 31 gusht 1968 ("Elez Braha, Vepra", f. 218), shënon: "...kur u ndodha në Tiranë nga disa shokë u furnizova me disa komunikata të shaptilografuara që partia jonë lëshonte në ilegalitet; aty mësova se në përpjekje me ballistët në Mokër, Elezi kishte mbetur i vrarë. Këtë komunikatë unë ia dhashë të vëllait të tij, i cili në atë kohë ndodhej në Tiranë."

Nuk ka sesi këtë komunikatë i vëllai i Elezit, Qazim Braha, patriot dhe burrë trim, të mos e ketë përdorur për të ndriçuar të vërtetën e vëllait të tij në Kukës në mesin e politikanëve që drejtonin qarkun, nënprefekturën apo rrethin. Duket se këtë njoftim të Adem Ballhysës e konfirmon indirekt një burim tjetër sipas të cilit, i vëllai i Elez Brahës, Qazimi, më 30 maj 1945 kur ishte me shërbim në Delvinë, e ka shënuar (diku në bllokun e tij) 14 dhjetorin datën e rënjes dhe varrin në Prenisht, (Rustem Braha: "Monografi për Dëshmorët", Tiranë 2007, f.40).

Në fondin e Komandës së Qarkut të Kukësit te vitit 1944 dosja 5 (AQ i FA) në Listën e dëshmorëve të nën prefekturës së Lumës, me numër 4 shënohet "Elez Braha, partizan në njësit, vra kundra okupatorit gjerman, në dimnin 1943-1944, në qarkun e Korçës, vjeç 28." Informacioni ka dhënë saktë emrin, qarkun e Korçës si territor, rreshtimin e tij në rradhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Por ai ka disa mangësi karakteristike, së pari, shënohet se ishte "partizan në njësit", kur Elez Braha ishte nënkomandat batalioni; nuk shënohet data e rënies së tij më 14 dhjetor, por



stina, "dimni 1943-1944". Kjo na bën të mendojmë se komanda e qarkut të Lumës edhe një vit e ca pas çlirimit të Shqipërisë, më 1946, (kur në fakt mund të jetë hartuar kjo listë, ende nuk kishte informacion të plotë e të saktë për Elez Brahën. Informacioni duket se vinte nga burime gojore.

Por duket se edhe ky informacion ishte arkivuar dhe "harruar". Profesor Shefqet Hoxha më 2015 shkruan se "deri në vitin 1952 për fatin e tij familja nuk dinte gjë, madje përflitej se ishte vrarë në rradhët e armikut. (E. Braha. Vepra, botim 2016. f.) Ndofta me këtë shpjegohet që edhe tetë vjet pas Çlirimit, ende eshtrat e tij nuk ishin sjellë në vendlindje! Ngaqë, siç duket, Elez Braha nuk ishte njëkohësisht edhe në listat e komandës politike të qarkut, a të rrethit të Kukësit.

Por në vitin 1952 do të kishte një kthesë në njohjen publike të rënjes dëshmor të Elez Brahës. Enver Hoxha, në fjalën e tij para popullit të Lumës, më 9 shtator 1952 e përmend Elez Brahën të parin nga dëshmorët e Kukësit, bën të njohur detyrën e tij si "nenkomandant i batalionit "Shqiponja" i rrethit të Korçës "dhe bën edhe vlerësimin: "që u bë tmerr për armikun "... (Vepra 10.f.31). Dhe vetëm pastaj u tërhoqën eshtrat e tij dhe u sollën në Kukës ku prehen edhe sot në varrezat e "Dëshmorëve të Atdheut" të Bashkisë së Kukësit. Me 13 nëntor 1969, në prag të 25 vjetorit të Çlirimit të Atdheut, me Vendimin nr 104 të Komitetit Ekzekutiv të rrethit të Kukësit, Elez Brahës i është (ri)njoht Statusi i Dëshmorit të Atdheut, bazuar në Ligjin që u miratua aso kohe, rinjohje që është bërë në atë vit, më pas, për të gjithë dëshmorët e Atdheut. Emrin e Elez Brahës e mban Shtëpia e Kulturës në Bice dhe e kanë mbajtur atë me nder në flamurin e tyre disa Brigada vullnetare të Rinisë në aksionet kombëtare në vitet 1980. Por, ndërkohë, një studim dhe vlerësim i plotë dhe i merituar për Elez Brahën, siç e dijmë nuk u bë, dhe është edhe sot e kësaj dite një nga mëkatet e institucioneve përgjegjëse të Kukësit, (si para e pas 1991) po pse jo edhe të Pogradecit, të Korçës e më lart.

Elez Braha, "Dëshmor i atdheut"-në të vërtetë një Hero i LANÇ

1. Elez Braha kishte një shkallë të lartë motivimi dhe vetëdijësimi. Që student në vitin e pestë të gjimnazit

në hartimin e tij me temë "Kohët ndryshojnë, e vjetra shembet ..." shprehet kundër psikologjisë dhe filozofisë fataliste, ai është për një psikologji veprimi dhe ndryshimi, që e formulonte më fjalët: "ne do të jemi dhe do të bajmë". Ky botkuptim revolucionar bëhet edhe më i kuptueshëm për Elezin si mik i Migjenit, shok klase i Qemal Stafës (Elez Braha "Vepra", Tiranë, 2016.) dhe i ndikuar nga grupit komunist të Shkodrës.(shih AQSH, fondi nr 346, Prefektura e Shkodrës, viti 1941, dosja 194 fl.12).

Elez Braha dëshmon që herët një shkallë të lartë gatishmërie për sakrificë. Student ne Modena të Italisë ai i shkruan nënës së tij: "Do të mundohem, me sa të jetë e mundun, mos të korris vedin si njeri e si shqiptar" ("Vepra", f.18). Me seriozitetin që e karakterizonte ai do t'i përgjigjej shpotisë së disa shokëve te tij në Shkodër për uniformën e oficerit të ushtrisë italiane që kish veshur: "Do ta shikoni dhe do të bindeni se unë nuk jam tradhëtar" (Vepra, f.21).

2. Elez Braha ka rënë heroikisht, në vijën e zjarrit, në sulm, "tek luftonte më këmbë si trim i vërtetë", shkruante komunikata e LANÇ e Korçës e botuar në Buletinin e gazetës "Bashkimi" ato ditë lufte. "E takova Elezin pikërisht atë ditë kur u largua nga Korça dhe erdhi në katundin Vinçan, i veshur me uniformë sikundër ishte. Në bisedën që pata me të çfaqti dëshirën që të qëndronte në repartet partizane në vijën e parë të luftës, ndërsa shokët e tij (dy oficera, emrat e të cilëve nuk më kujtohen) çfaqën dëshirën të punonin në entet e prapavijave mbasi ata kishin punuar në këta sektorë.", shkruante gjeneral-major Spiro Shalësi, (Stajo) ish komandanti i batalionit "Shqiponja". (Elez Braha. Vepra, f.210).

Edhe Elez Braha ishte diplomuar për itendencë në Akademinë e njohur të Modenas në Itali dhe kishte punuar në këtë sektor, (në prapavija), dhe, po të donte edhe ai mund të inkuadrohej në këto struktura, ku rreziku i jetës ishte më i vogël. Por ai kërkoi të inkuadrohej në vijën e parë të reparteve partizane. Kjo sepse Elez Braha, siç e

pohojnë bashkëluftëtarët e tij, kishte një shkallë të lartë urrejtjeje për armiqtë e tradhëtarët. "Ay ishte trim i patrembur, bile në disa raste i papërmbajtur, ushqente një urrejtje të madhe kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve, ruante në veten e vet cilësitë më të mira të popullit të krahinës së vet... Elezin e gjetëm të vranë mbi pozicionet e gjermanëve, plumbi e kishte goditur në ballë", kujton ish komandanti i batalionit. (po aty, f 210.)

Është vendi të kujtojmë se komanda e shtabit të qarkut të Korçës disa ditë më parë "ngarkonte më përgjegjësi veçanërisht komandantë e komisarë të batalioneve "Reshit Çollaku" e "Shqiponja" që nuk kishin kontrolluar frontin, por rrinin larg si në Zvarisht e gjetkë dhe u kërkonte të largoheshin nga prapavijat e të kalonin në ofensivë, duke qenë komandantë e komisarë në vijë të parë". (AQSH. F. 42, d. 3. fl56). Heroi ynë, Elez Braha nuk kish pasur nevojë për hostenë të tillë, ai kish qenë gjithnjë tok me partizanët në vijën e parë të zjarrit, Madje kish ndodhur edhe të qe plagosur dhe të mos kish pranuar të mënjanohej nga aksioni. Këso shqiponje ishte Elez Braha!


3. Elez Braha që më 5 tetor 1943, ditën kur u formua batalioni "Shqiponja" ishte caktuar zv/komandant i tij, post i lartë në kohën e Luftës ANÇ, që emërohej nga Shtabi i Përgjithshëm, me propozim të komandës së shtabit të qarkut. Madje me 29 nëntor 1943, Elez Braha ishte caktuar anëtar i Shtabit operativ që do të drejtonte veprimet luftarake të dy batalioneve, "Shqiponja" dhe "Reshit Çollaku".

4. Elez Braha ka udhëhequr batalionin "Shqiponja" me trimëri dhe zgjuarësi, në dy beteja (3-4 nëntor dhe 10-14

dhjetor 1943), dhe në të gjitha luftimet e tjera. Ishte ky batalioni, ""Shqiponja" që i kish futur tmerrin armikut" dhe një vlerësim i tillë nga Shtabi i Përgjithshëm ishte bërë vetëm për Brigadën I-rë sulmuese të UN-



Rënien e Elez Brahës e ka dokumentuar për herë të parë, siç dhe i takonte, Komanda e Shtabit të qarkut të Korçës në komunikatën e saj të datës 20 dhjetor 1943. (6 ditë pas rënies së tij). Këtë komunikatë e ka botuar të plotë gazeta "Bashkimi" ("Bashkimi dhe buletinet e tij" v. 2, f 392-395). Edhe "Zeri i Popullit" në buletinin e tij të datës 16 janar 1944 botonte një kronikë të luftimeve të dhjetorit nga qarku i Korçës, mes tyre ato që u bënë në Gurin e Kamjes me 14 dhjetor dhe rënien aty dëshmor "të nënkomandatit trim Elez Braho, duke luftuar në vijën e parë të zjarrit."



ÇSH. Pra, "Shqiponja" ishte një batalion elitë i sajë.

Për betejën dy ditore të 3-4 nëntorit në Gjonomadh e Goskovë, Buletini i gazetës "Bashkimi" botonte komunikatën e komandës së shtabit të qarkut të Korçës, në të cilën shkruhej: "...Ndërkohë arrijnë me vrap dhe dy kompani të Batalionit ("Shqiponja" ne fakt, është dhënë gabim: Gorë-Opar), me nënkomandant Elez Brahon, të cilat muarrën krahun e majtë dhe u vëndosën mbi Gjonomadh deri në kodrat e Goskovës. Aty edhe me kalimin në sulm të kompanisë së 1-rë të batalionit "Shqiponja" ("Gjashtë dëshmorët-Kelmendi- Gërmenji", emërtimi fillestar i batalionit) filloi një zjarr i shkurtër, por i fuqishëm... Armiku u shtrëngua të shkulet nga pozicionet e të vendoset në një vend të zhveshur. Aty skuadra e mitralozit të rëndë hapi zjarr të fortë për një çerek ore dhe i griu gjermanët, duke vrarë disa prej tyre e të tjerët ikën të çakërdisur".

Në këtë luftë të vështirë dhe të pargjakshme që vazhdoi dy ditë me rradhë. Ushtria Naçionalçlirimtare (vini re, e konsideron batalionin "Shqiponja" përfaqësues e simbol të UNÇ) korri me të vërtetë një fitore të mirë. Nga forcat partizane pati vetëm tri të plagosur. Kjo luftë ishte një provë e fortë për partizanët që treguan se dinë të jenë jo vetëm atje ku nrëziku është më i madh, por edhe të luftojnë me taktikë të përsosur luftarake. Po duket qartë se kemi një ushtri të rregullt, të organizuar, që po na e zbardh faqen dhe po e shpëton popullin" ("Bashkimi dhe buletinet e

tij. 1942-4.", Tiranë, 1986, f.55-56).

5. Elez Braha drejtonte në një batalion të shquar në qarkun e Korçës. Batalioni "Shqiponja" ishte një repart partizan territorial i krijuar në qarkun e Korçës me 184 partizanë vullnetarë, me 5 tetor 1943 në Voskopojë, kryesisht nga Rrëza e Fushës së Korçës, i ndarë në tri kompani. Të farkëtoje një repart partizan dhe t'i jepje atij shpirtin sulmues dhe qëndrueshmërinë që kërkonte lufta kundër pushtuesit të ri gjerman, duhej aftësi ushtarake, edhe sidomos shembull vetjak, të cilat i kishte komanda e batalionit, e në vaçanti, Elez Braha. Ky batalion kaloi i tërë si efektiv, në përbërje të Brigadës së IV S më 28 dhjetor 1944. Partizanët e këtij batalioni që mbante emrin e bukur "Shqiponja" ishin me të vërtetë shqiponja, dhe Elez Braha, zv/komandanti i tyre, ishte një kryeshqiponjë! Ky batalion shqiponjë i kryente detyrat në kushtet e mungesave të mëdha të municionit, të armatimit dhe veshmbathjes. Kjo e bënte edhe më heroike veprimtarinë e tij luftarake. Me 17 nëntor 1943, 30 partizanë të batalionit ishin pa armë. Batalioni hidhej në sulm pa pasur madje asnjë automatik. Municioni është pakësuar shumë", informonte komanda e batalionit me datë 22 nëntor, "municioni po na mbarohet krejt" (AQSH.f.42,d.5 fl23;d.11,f26). E tillë ishte gjendja edhe për veshmbathjen e partizanëve, shumë prej të cilëve "janë fare të zbathur" (AQSH.f.42.d.5f.18 dhe 22). Edhe në këto kushte të mungesave të mëdha Batalioni "Shqiponja" kish guxim të përballej me gjermanë e ballistë, të cilët në rrethin e Korçës dhe të Pogradecit qenë jo të paktë dhe të mirëorganizuar.

6. Elez Braha është dekoruar më 1961 me medaljen e Kujtimit, të Trimërisë dhe të Çlirimit. Dekorimi me të tri medaljet nuk është një rast i zakonshëm. Pastaj medalja e Kujtimit u jepej vetëm atyre që ishin pjesëmarrës në Luftë ose në Lëvizje para 10 korrikut 1943. Kjo e zgjidh përfundimisht dhe saktë faktin e angazhimit të tij që heret në krah të Luftës ANÇ.

Pse nuk është shpallur si "Hero i Popullit", kjo ska të bëjë me të vërtetën: jo të gjithë heronjëve të Luftës ANÇ u është njohur ky titull para vitit 1991. Tani nuk jepet më. Por hero nuk të bën dekorata, të bën vepra, të cilën është detyra e historiografisë ta njohë e shkruaj, dhe e politikës që ta korrigjojë padrejtësinë (ka edhe sot dekorata të tjera të larta me të cilat mund të vlerësohej dhe nderohej).

BURIME

- 1-Arkivi Qëndror i Shtetit, Fondi nr 41, 42 ,346
- 2-Arkivi Qëndror i Forcave të Armatosura, Komanda e qarkut: Kukës.viti 1944.
- 3-Bashkimi dhe Buletinet e tij (1942-1944) .v.2.Tiranë, 1988.
- 4-Buletine "Zërit të Popullit" vëllimi III, Tiranë, 1986
- 5- Elez Braha " Vepra" Tiranë, 2016
- 6-Historia e LANÇ të popullit shqiptar.3.Tiranë,1988
- 7-Shaban Braha: "Mes jetes dhe vdekjes", 2015.
- 8-Rustem Braha: "Monografi për dëshmorët.", Tiranë, 2007
- 9- "Në flakë e zjarr, me pushkë në dorë",Kukës 1974
- 10-"Maket i Historikut te LANÇ në Lumë.vitet 1980"
- 11-Kopje të hartave të terrenit të Korçës e Pogradecit, marrë nga Instituti i Gjeografisë ushtarake, Tiranë.

Shqiptarët e Mesjetës drejtonin botën

DR. ALEKSANDRE LAMBERT

Dr. Aleksandre Lambert, historian, drejtor akademik i "School of International Training" në Gjenevë, është autor i disa librave dhe artikujve në fushën e relacioneve ndërkombëtare të filozofisë politike, të politikës së sigurisë dhe lidhjeve civile-ushtarake. Lambert ka vizituar Shqipërinë dhe ka filluar të njohë çështjen shqiptare që në rini të tij me kërkimet e bëra në Arkivin e Lidhjes së Kombeve Gjenevë, kur njohu mirë edhe çështjen çame.

Historiani zviceran Dr. Aleksandre Lambert këmbëngul se nuk është e rastit që shqiptarët në asnjë moment të historisë nuk njihen si komb që ka sulmuar kombet e tjerë dhe se shumë shqiptarë kanë shkëlqyer duke drejtuar qoftë perandori, qoftë shtete të tjera.

Po kështu, sipas tij, të tjerë shqiptarë kanë lënë emrin e tyre në fusha të ndryshme të shkencave në shtete të ndryshme të botës. Më tej historiani ndalet në zhvillimet pas Luftës së Dytë Botërore, duke shprehur bindjen se ajo që ndodhi me Shqipërinë, me lënien e saj në Bllokun e Lindjes ishte një llogari e bërë nga aleatët që fituan luftën. Në fund edhe disa këshilla se si duhet të veprojnë shqiptarët për t'u ngjitur pranë shumicës, aty ku ata tentojnë.

Ja ç'thotë ai për shqiptarët në kohën e Mesjetës:

"Në Mesjetë shqiptarët i kanë dhënë udhëheqës botës, udhëheqës laikë ose fetarë dhe personalitete kulturore që i kalojnë kufijtë e Evropës. Disa Papë kanë qenë shqiptarë, për shembull, – Klementi i XI-të më i dalluari prej tyre. Por shqiptarët kanë qenë në krye të feve më rëndësi botërore, si në krye të fesë ortodokse, ashtu edhe të asaj myslimane.

Në histori gjejmë udhëheqës të shquar shqiptarë në shumë vende të Evropës, madje edhe prej atyre që ngandonjëherë kanë përcaktuar fatin

e shumë betejave historike (në vitin 1515 qe Merkur Bua me kalorësinë e lehtë të Venedikut, e përbërë e gjithë nga shqiptarë që përcaktoi fitoren e betejës së Marinjanit, që historia e emëroi beteja e gjigandëve dhe jo Françesku i I-rë i Francës, 19 vjeç, që ato dy ditë beteje mësoi se si luftohet).

Shqiptarët i kanë dhënë shumë kryeministra dhe gjeneralë të shquar Perandorisë Otomane (vetëm familja Qyprili i dha 5 kryeministra Perandorisë). Shqiptarët i kanë dhënë shumë heronj të pavarësisë greke, prej të cilëve po përmend Kundurjotis, Marco Boçari, Kanaris, Kolokotroni, Karaiskaqis, Bubulina. Që ishin në udhëheqje të revolucionit grek, prej të cilëve edhe disa kryeministra të shtetit të ri të



pavarur grek.

Rumania gjithashtu ka pasur një familje princore me origjinë shqiptare (Aleksandër dhe Vladimir Gjika si dhe princesha Eleonora e njohur me emrin Dora Distria).

Françesko Crispi, shok i Garibaldi, Kavuri e Macinit që ka qenë një kryeministër i madh Italisë, ishte me origjinë shqiptare.

Piktorë si Carpaçi, Albani etj., humanisti Leonice Tome, profesori i Kopernikut dhe shumë personalitete shqiptare, janë nderuar nga historia e Italisë.

Muhamet Aliu, reformatori i Egjiptit Modern, që historia franceze e ka quajtur "Napoleon i Lindjes së Afërt" qe shqiptari që themeloi dinastinë mbretërore të Egjiptit që mbretëroi

gati 150 vjet.

Arkitekti i "Taxhmahallit" në Agra të Indisë, kryevepra e arkitekturës islamike, ishte vepër e një shqiptari ashtu sikurse edhe "Xhamia Blu" e shumë xhami të rëndësishme të Stambollit.

Dhe më në fund Heroi Kombëtar i shqiptarëve, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, një shembull gati universal i luftëtarit të lirisë, i nderuar në botën mbarë me përmendore jo vetëm në Tiranë, Prishtinë e Shkup, po gjithashtu në Romë, Bruksel, Gjenevë, Detroit, Buenos Aires. Të tjera përmendore për Skënderbeun janë projektuar të ngrihen në Londër, Varshavë, Melburn, Manila etj.

Kur shqiptarët kanë kontribuar kaq shumë për qytetërimin e njerëzimit, përse pak njerëz në botë janë të ndërgjegjshëm për këtë, përkundrazi shumë as nuk kanë dashur ta pranojnë këtë realitet?

Duhet thënë se një gjë e tillë shpjegohet edhe nga izolimi relativ jo pa qëllim i shqiptarëve nga komuniteti ndërkombëtar, dhe në mënyrë të veçantë nga ai evropian, që nga Kongresi i Berlinit e këtej (1878).

Në të vërtetë pas mundjes së turqve në luftën ruso-turke, shtypi ndërkombëtar filloi punën për të injoruar shqiptarët duke i ndërruar emrin gadishullit të dikurshëm të Ilirisë të banuar që nga kohët parahistorike dhe deri në ditët e sotme nga ilirianët-shqiptarët.

Atë e pagëzuan me emrin e ri që ka edhe sot, Gadishulli i Ballkanit, vetëm duke u nisur nga vargu i maleve Ballkan. Përse iu vërsulën shqiptarëve? Pjesa më e madhe e diplomacisë konservatore evropiane ka përdorur termin pexhoratif "turq" për t'i cilësuar si turq të gjitha komunitetet myslimane në Ballkan, edhe pse shumica prej tyre nuk janë aspak turq. Evropa ka mbështetur dhe ka zmadhuar tokat e Greqisë, të Serbisë dhe të Malit të Zi, në kurriz të shqiptarëve. Asnjëra nga fuqitë e mëdha evropiane nuk e ka mbështetur çështjen shqiptare, kur shqiptarët krijuan Lidhjen e Prizrenit për të mbrojtur çështjen e tyre të drejtë kundër vendimeve të Kongresit të Berlinit. Ata u lanë në baltë nga të gjithë".

27 PRILL 2016
Stërvitja e përbashkët
“VLORA SAREX 16”

